rive të kuptuara, kah vendosja e punës njerëzore historikisht prodhuese në kënaqje të plotë me prodhimin e vet dhe në të drejta të veta të pareifikuara. Fundja, kjo do të thotë »kërcim prej domosdosisë në liri«, përkatësisht në liri e cila lind nga domosdoshia e përsunduar nëse jo e minuar e raporteve. Nga domosdoshia e minuar do të thotë: nga aktiviteti aq i fuqishëm i faktorit subjektiv të lëvizjes saqë në histori e në shoqëri nuk u rritet më mbi koka kurrfarë raporti objektiv dhe pushon fuqia e të ashtuquajturit fat. E mandej, pas asaj *veprimtarie të lirë*, edhe e godet shtresën e fundit imamente të asaj »të jesh i pavarur«: e ashtuquajtura *liri etike*. Duke u kthyer më shpesh prapa kah ajo brendia e thjeshtë, kjo liri etike sërish shfaqet si mbizotërim i »njeriut të fuqishëm e të pjekur mbi të gjitha shtytjet që nuk janë adekuate për të. Edhe atëherë kur ato pengojnë si pasione të llojit të veçantë, edhe atëherë kur si kërkesa që vijnë nga jashtë, ato detyrojnë, shtyjnë, ndërrojnë drejtimin. Ai që është etikisht i lirë dëshmohet si zotërues mbi atë dhe beson se këtë e vërteton vetë fakti se ai nuk dëshiron të pranojë kurrfarë përfytyrimesh të paqarta. Asaj lartësie komanduese të vullnetit etik të Sokrati dhe Spinoza, veç kësaj, i përket edhe një intelektualizëm i caktuar: njohja e virtytit, ihotë Sokrati, e bën njeriun të lirë ndaj tij; »vullneti dhe arsyeja janë e njëjta gjë«, mëson Spinoza mu në atë pikëpamje (*Etika* II, 49, teza, prova). Vetëm idetë adekuate duhet të të çlirojnë nga robëria e shtytjeve joadekuate, por edhe nga rrethanat joadekuate, si garancë etike për njeriun e lirë. Kështu tashti — në rajonë më të vogla — gjithsesi është e pranishme sjellja kvijetiste-kontemplative; forca personale zëvendësohet atëherë me kultivimin e personit. Pengesat afektive, të jashtme, reale, që e bëjnë njeriun jo të lirë ekzistojnë njëmend e jo vetëm nga mosdija të cilën më vonë e zotëron shpirti i fortë. Pra shihet se: liria etike si ajo që realisht i mënjanon pengesat, i takon lirisë së veprimit; — ndoshta si kokë e saj e karakterit, por atëherë gjithnjë aktive. Është fjala këtu për një qëndrim të pakorruptueshëm; por ai gjendet vetëm në rajonet përtej brendisë së thjeshtë; në rajonet e Spinozës, të cilat janë aq larg shpirtit të bukur, mungon plotësisht rrjedha e mjerrë kvijestiste. *Homo liber* i Spinozës, i cili shqyrton në mënyrë krejt teologjike-politike, e ka realizuar atë që është e kundërt me sferën private në saje të vendosmërisë publike, pra, fundja, me arsyen si vullnet, e jo vetëm anasjelltas. Liria etike nuk formohet aty ku ndalet, në heshtje, por pikërisht si karakter në rrjedhën e bo-

tës. E karakteri në të formohet sipas masës sikurse vetë ai ndërton në të në mënyrë që ajo doemos të mund ta zhvillonte njeriun e lirë pa dhunë.

Thuhet se njerëzit kurrë nuk do të mund ta duronin një kohë të gjatë shtypjen. Kjo mund të jetë ashtu, por edhe vështirë mund të heqë dorë nga dëshira fetare që të jetë qen. Pra, pranë problemit të lirisë etike çdo herë sërish rri problemi i lirisë fetare. Edhe parakrishtërimi buron nga themeli kombëtar-revolucionar, ai nuk kishte kuptim servil. Mungonin miliona predikues të përvujtërisë, të cilët më vonë u autorizuan që ta vendosin moralin e robërisë. Narisht, edhe brenda parakrishtërimit po ashtu gati dukej se shtrohej kërkesa jo vetëm për flakjen e sundimit të huaj romak dhe të mbretërisë romake, por edhe të lirisë së thjeshtë kombëtare-revolucionare si shumë të ngushtë dhe shumë të lidhur me botën e vjetër. Shoqëria, puna, prona u bënë të barabarta para rendit të pritur apo mbibotëror i cili në fe tashmë brenda rritej. U bë vendimtar shpëtimi i shpirtërave, përkatësisht liria nga shtytjet dhe veprimet mëkatore, liria kah mbretëria e zotit. Kështu, pra, dëshmimit etiko-imanent ju shtua edhe një dëshmim po ashtu i brendshëm dhe i tejdukshëm: u paraqit ultimatum i për liri *krishtere*-fetare. Derisa krijesën krishtërimi e bëri djallëzore (shtytjet e saj stoikët i shikonin vetëm si pengesa për pavarësi), ai me këtë botën ekzistuese nuk arriti ta bënte hyjnore. Ai nuk kërkonte kurrfarë integrimi brenda rrjedhës së harmonishme të natyrës, ai nxiste që shpëtimi të gjendej në ndonjë botë më të mirë mbinatyrore. S'ka fije dyshimi se edhe shpëtimi te i cili synohej në këtë mënyrë ka qenë i kuptuar si liri, si emancipim nga shtytjet e epsheve, si depërtim para së gjithash brenda gëzimit. Të lidhurit duhej të zgjidheshin me ndihmën e Jezusë, të shtypurit duhej të ngriheshin — »aty ku është fryma e zotit, aty është liria« (2. Kor. 3, 17) Se kjo nuk zbatohet në mënyrë objektive-reale, shihet qartë edhe nga letra e Petrit: »jo thuajse lirinë e keni për ta fshehur ligësinë, por si shërbëtorë të zotit« (1. Petr. 2, 16); prej Palit e këtej komuna parimisht lëviz rrugëve sociale-konservative. Nëse në këtë mënyrë çdo rebelim mënjanohet dhe flaket në epshe, për më tepër futet në radhën e atyre më të këqijave: Luciferi dhe gjarpëri në parajs, megjithatë mungon bashkimi me fatin si të tillë, atëherë këtu t'i dorëzohesh vullnetit të zotit nuk do të thotë fare t'i dorëzohesh rrjedhës së botës dhe sundimtarëve të saj. Bota ekzistuese është dajllëzore pikërisht për shkak të planetëve të fatit që sundojnë me të; yjtë, që për stoikët ishin garantues të rendit, në gnozen krishtere quhen »tiranë«. Sepse për fenë e re ata u bënë udhëheqës të fatit të keq, ata ishin

»arkontë«, »anankë«, të cilën më nuk e donin, »heimarmene« e cila tashti paraqitej vetëm si burg. I njëjti Pal, i cili lidhi paqë me Cezarin, megjithatë ia mori mbështetjen kosmike, përkatësisht përputhjen me diellin, planetet, rendi qiellor; Pali e mallkoi atë rend. Plotësisht në pajtim me gnozën e mëvonshme krishtere, apostulli i paralajmëron luftë refleksit të tiranisë i cili iu paraqit si prototip i kësaj: »Sepse ne nuk kemi nevojë të luftojmë kundër mishit e gjakut por kundër princërve e pushtetmbajtësve, përkatësisht me sundimtarët e botës, me shpirtërat e këqij nën qiell« (Efezasve 6,12). Ata sundimtarë të botës, ndërkaq, (»kozmodokratë«) nuk janë asgjë tjetër veçse zotër të fatit, fuqi qiellore të despotizmit oriental dhe të besimit astral prej të cilave i çliroi biri i zotit. Si bazë e asaj qenieje të fatit lajmërohej Egjipti; prandaj gnoza krishtere e shikonte nëpërmjet një alegorie të veçantë shpërnguljen nga Egjipti dhe sipas tregimit të urtë të cilin pastaj e dha edhe Izaiu: »Po ku janë, Egjipt, shpjeguesit e tu të yjve? Lejo që të të paraqiten gjërat të cilat do t'i bëjë zoti Sabaot« (zoti i ushtrive) (Izaiu 19,12). Mirëpo, ato gjëra të rendit të ri të dëshirave ishin të tilla sa ndikoni që shikimi i kozmodokratëve të kthehej prej tokës kah qielli dhe të mos u bënin më dëm njerëzve. Ky theks i egër duke pasur karakter thjesht fantastik e mitologjik, fare nuk u bëri dëm sunduesve të botës së vërtetë: ai megjithatë ia mori regjimit të tyre ideologjinë astrale. Edhe në një tekst aq të butë të *Dhjatës së re* qyteti botëror u rrënuar: Apokalipsa është revolucion si dhurata më e fortë nga lart. Ajo i dha lirisë fetare karakter fantazmagorik dhe e shndërroi në liri fiziko-metafizike, ajo e varfëroi, sado që transcendenca ishte bërë më e theksuar, brendinë e thënies së Palit: »Jerusalemi që është lart, është liri e cila është nënë e të gjithë neve« (Gal. 4,26.) Ajo e rrënoi plotësisht mitin astral, në vend të tij e vuri ambientin nga i cili u zhduk »anankë« e qiellit të moçëm dhe tokës së moçme. »Sepse edhe krijesa do të çlirohet nga shërbimi që i bën qenies së vdekur dhe do të kalojë në lirinë madhështore të fëmijëve të zotit« (Rom., 8,21) — kjo është përmbajtje fetare, e cila, siç shihet, shumë pak i përket moralit të robërisë dhe e cila përkundër Kishës, përkundër brendisë, përkundër transcendencës e dëshmoi këtë në të gjitha lëvizjet krishtere-revolucionare të heretikëve. Kisha natyrisht, e cila i vuri vetes për detyrë ta përpunonte krishtërimin në vegël të shtypjes, pikërisht lirinë e fëmijëve të zotit e bëri një fantazëm; kisha protestane, e cila u konsolidua në saje të kontra-revolucionit, arrin edhe më larg se kisha katolike. Që të dy teologjitë janë marrë me dallimin ndërmjet lirisë nga diçka dhe lirisë për diçka, me ç'rast e kanë thek-

suar sidomos të parën si liri të thjeshtë negative. U bë e ditur se liria nga diçka, nëse *veçohet* deri në atë masë, mund të jetë vërtetë negative: si braktisje e thjeshtë, si zbrazëti pa përmbajtje, e cila kështu do të mund të ishte më tepër ferr sesa dritë. Por pikërisht me atë veçim, për qëllimin e synuar, në mënyrë që çdo konservimi, pra edhe konservimit të varësisë së vjetër e varësisë së re, t'i jepet përparësi para asaj zhveshjeje radikale, gjëja përfundimtare. Duke u frikësuar se liria të mos bëhet bartëse e ndryshimit të botës, kisha e përpunoi në liri thjeshtë të brendshme. »Liria e njeriut të krishterë« e Luterit, në saje të genitivus subiectivus të njeriut të krishterë, siç e kuptonte Luteri, i vuri lirisë kufizimet më energjike. Sepse njeriu i krishterë i Luterit nuk ka kurrfarë lirie të vullnetit e lire të zgjedhjes, ai jeton jo vetëm si shërbëtor i mëkatit që nga fillimi: as liria fetare, e cila te ai reduktohet në besim në Krish-tin, po ashtu nuk ishte kurrfarë lirie, por vetëm skllavëri e ndryshuar. »Shërbëtor i zotit« është po ashtu shprehje e shpeshtë biblike (sado që nuk e gjejmë në Ungji), e edhe luftëtari më i shquar i krishterë për liri, Toma Mynceri, e përdor po ashtu për vete; mirëpo të shërbyerit e zotit, të cilin Luteri e paraqet si liri fetare, madje edhe si vetëpërcaktim, është vetëm një liri tokësore në një sferë më të lartë. Kjo liri sipas Luterit është e tillë që krishteri i fortë nga dashuria ndaj zotit do të mund të ishte i gatshëm që me gëzim të shkonte në ferr, po të jetë kjo dëshirë e zotit. Luteri nuk e shtron atë krenari burrërore para fronit mbretëror si ndonjë paradoks, por e sheh në raport të drejtpërdrejtë me »madhështinë« e zotit. Ç'është e vërteta, ndjenja të ngjashme hasen edhe te mistikët mesjetarë, veçanërisht te Tauleri, si »dorëzim mallkimit«, e më vonë edhe si »amour desin-teresée« (dashuri pa interes), në rrethin e kvijetistëve francezë të tubuar rreth zonjës dë Gijon (Guyon). Por këtu është fjala pikërisht për depërtimin e paradoksit të krishterë, për sprovimet e ndryshme e jo për nënshtrimin më të ulët të robërve. Çlirimi te Luteri do të thotë në instancë të fundit falje, ai do të thotë »të gjejsh për vete te zoti zotëriu e mëshirshëm«, ai do të thotë »fshehje para zemërimit të zotit nën krahët e pulave të Krish-tit«. Çlirimi nuk ka çka të kërkojë në tokë, në rendet e pushtetit, ai është i pranishëm vetëm në besim, ai është brenda saj edhe pesim i vuajtjeve dhe i takon kishës së padukshme të dëshmimit, jo në veprat ku është mëkati. Është fjala këtu për një paralelizëm ndërmjet botës e brendisë. Ai paralelizëm e ideologjizoi më vonë politikën prusiane për pushtetin dhe mbylljen e plotë të ungjillit të lirisë brenda sferës private, për më tepër në një apati. Madje edhe Kanti, etika e të cilit zhvillo-

het plotësisht si autonome e vullnetit njerëzor, e spontanitetit njerëzor, e vë lirinë jashtë të shfaqurit empirik dhe jashtë natyrës-domosdosisë së saj rreptësisht të determinuar. Liria i takon vetëm »karakterit inteligibil«, përkatësisht njeriut si »qytetar i botërave inteligibile« dhe ajo — si kusht i mënyrës morale të veprimit, si aftësi që ligji moral të ndjeket në të gjitha rrethanat — nuk është objekt i diturisë empirike por postulat i besimit transcendent. Atje e vendosi Kanti lirinë, në mbretërinë e mosnjohjes së gjësë në vete; ajo paraqitet vetëm si ide e jo si përvojë. Liria është sundim i ndërgjegjes; mu për këtë ajo gjendet në pjesën tonë mbinatyrore dhe prandaj koncepti inteligibil për lirinë e Kantit është po ashtu koncept fetar. Ajo vendosje inteligibile nuk e pengoi Kantin që të lejonte që ideja e lirisë megjithatë të paraqitet në një lloj të veçantë të përvojës, jo vetëm në mënyrë subjektive-etike si ndërgjegje, por edhe në mënyrë objektive-etike si ajo përhapje e lirisë morale, e cila në një rast të caktuar lejon që të konstatohet përparimi në histori. Kthesa specifike e Kantit, ndërkaq, para së gjithash do të thotë se në liri shfaqet gjëja në vete, jo vetëm ikje nga përvoja (realiteti) në atë inteligibilen, por lëvizje kah ajo pikë burimore e cila te Kanti e afron jo vetëm përvojën teorike por edhe botën morale të postulateve: kah pika burimore e spontanitetit. Idealizmi transcendent i Kantit lejoi që brenda fuqisë së lirisë inteligibile të paraqitet jo vetëm ai rend mbinatyor, i cili nuk ka kurrfarë rendi brenda asaj natyrores dhe kurrë nuk mund të bëhet natyror, por përkundër asaj transcendence të dëshmimit, që ta përkujton Luterin, gjendet edhe imanenca më intensive e lirisë, mu në atë mënyrë që brenda spontanitetit moral dhe veprimeve të tij duhej të paraqitej ajo pikë burimore e cila është shfaqur në realitetin e formuar të përvojës dhe si gjë në vete është të thuash më reale se i tërë ai realitet i formuar. »Epërsia e mendjes praktike« e tillë për Kantin është natyrisht vetëm e posteluar, e jo epërsi reale vepruese, sepse Kanti i mungonte koncepti i historisë për ta tejkaluar aktivisht dualizmin midis përvojës dhe postulateve, »mbretërisë së domosdosisë« dhe »mbretërisë së lirisë«. Atë koncept të historisë e krijoi Hegeli në *Fenomenologjinë e frymës*: si »shfaqje e thellësisë«, e cila dialektikisht përparon, si ajo thellësi që është vetë spontaniteti që nuk qetësohet në shfaqjen e vet të thjeshtë apo në realitetin e vet dualist të përvojës. Për më tepër edhe ajo shfaqje del si pjesë e historisë, e historisë së ndërmjetësimit të mëvetësisë me përmbajtjen; »liria e fëmijëve të zotit« ndërkaq: qeniesimi i mëvetësisë për vete paraqitet si qëllim i cili bëhet. Këtu është prapë liria fetare, si tejkalim i objektit të huaj të qëllimit, natyrisht ve-

tëm në qëllimin i cili mbetet seditës. Ajo përputhet me vatrën e të vërtetës: »Sepse, e vërteta është të mos ve-prosh ndaj asaj objektives si ndaj diçkafes të huaj. Liria shpreh po atë që është e vërteta, me përcaktimin e mohimit« (Werkw XII, fq. 167). Qeniesimi për vete hyn në këtë mënyrë brenda përfytyrimit kryesor pikë-rishtë të lirisë krishtere-fetare: zoti u bë njeri. Substanca nuk është kurrfarë objekti që rri lart e as nuk është e huaj nga e cila dalin frika dhe fati, por substanca është subjekt. Natyrisht në atë mënyrë që ajo shfaqje prej gjithë shfaqjes këtu është vetëm shfaqje e menduar dhe nuk ndodh brenda punës reale, e për më tepër në të ardhmen nuk ka për të ndodhur, e as si subjekt nuk do të thotë akt i vetçlirimit, përmbajtje e vetçlirimit të njerëzve të gjallë, realë, konkret — kundër fatit, për mbretërinë njerëzore. Ajo liri — gjë që fare nuk ka qenë e sqaruar te asnjë koncept i deritashëm i lirisë — në çdo shtresë mund të bazohet si liri e zgjedhjes, si liri e veprimit, si liri etike e fetare, në përgjithësi vetëm kundër fatit, pra në aspektin e *botës ende të hapur, botës e cila ende nuk është determinuar deri në fund*. Së këndejmi edhe theksi vazhdimisht revolucionar në liri, së këndejmi mospërputhja e saj esenciale me deter-minimin *e mbyllur* (të të cilin po ashtu nuk do të mund të ekzistonin as determinantet subjektive-depërtuese, e as liria e zgjedhjes, sidomos jo liria e veprimit). Vetëm determinimi *parcial* i botës, pra mundësia ende jo e mbyllur, e bën lirinë brenda vet botës të mundshme. Kaq këtu për ngjyrën e parë, më të fuqishme në tri-ngjyrshin e të drejtës natyrore dhe për vendin e saj të vërtetë; liria është mënyrë e sjelljes njerëzore ndaj mu-ndësisë objektive-reale. Vetëm në atë mënyrë qëllimi i saj ka hapësirë për lëvizje, në rrugën kah *përmbajtja e lirisë: humanumi i patjetërsuar*.

Nga serbokroatishtja përktheu: M. Kullashi

**gjergj
lukaq**

**ROZA
LUKSEMBURGU
SI MARKSISTE**

Ekonomistët na shpjegojnë sesi prodhohet brenda raporteve të caktuara, por nuk na shpjegojnë si prodhohen vetë ato raporte, përkatësisht, lëvizja historike që i lind.

*K. Marks:
»Mjerimi i filozofisë«*

Dallimi midis marksizmit dhe shkencës borgjeze nuk konsiston në dominimin e motiveve ekonomike në shpjegimin e historisë, por në pikëpamjen e totalitetit. Kategoria e totalitetit, sundimi i gjithanshëm dhe përcaktues i tërësisë mbi pjesët, përbën esencën e metodës të cilën Marksi e mori nga Hegeli dhe e riformuloi në mënyrë origjinale, në bazë të një shkence të re. Ndarja që i bën kapitalizmi prodhuesit nga procesi i tërësishëm i prodhimit, copëtimi i procesit të punës në pjesë dhe moskujdesi ndaj specifikës njerëzore të punëtorit, atomizimi i shoqërisë në individë që prodhojnë pa plan dhe në mënyrë të shkëputur etj., është dashur të ndikonte patjetër edhe në mendimin, në shkencën dhe në filozofinë e kapitalizmit. Ndërkaq, revolucionariteti i shkencës proletare nuk konsiston vetëm në faktin se ajo shoqërisë qytetare ia kundërvë përmbajtjet revolucionare, por, në radhë të parë, në esencën revolucionare të vetë metodës. Dominimi i kategorisë së totalitetit është bartës i parimit revolucionar në shkencë. Ky parim revolucionar i dijalektikës së Hegelit — po t'i lëmë anash të gjitha përmbajtjet konservative të Hegelit — ishte shumëfish i njohur edhe para Marksit, por

nga ajo njohuri nuk mundi të zhvillohej një shkencë revolucionare. Vetëm me Marks, dialektika e Hegelit, sipas fjalëve të Hecenit, u bë vërtet »algjebër e revolucionit«. Ajo nuk u bë e tillë thjesht në sajë të rrotullimit materialist. Përkundrazi, ky parim revolucionar i dialektikës së Hegelit në këtë përmbysje dhe me ndihmën e tij ka mundur të sqarohej vetëm në sajë të ruajtjes së thelbit të metodës, pikëpamjes së totalitetit, trajtimin të të gjitha shfaqjeve të pjesshme si momente të tërësisë, të procesit dialektik, i cili është kuptuar si unitet i mendimit dhe i historisë. Te Marks metoda dialektike mëton ta njohë shoqërinë si totalitet. Ndërkaq, shkenca borgjeze, të njohë apstraksione të dobishme dhe metodologjikisht të domosdoshme për shkençat e veçanta, abstraksione këto që zënë fill, nga një anë, për shkak të veçimit të objektit të hulumtimit, e nga ana tjetër, për shkak të ndarjes së punës dhe të specializimit që ose i përshkruan naivisht-realisht një »realitet«, ose »në mënyrë kritike« një autonomi, ndërkaq marksizmi i eliminon këto ndasi dhe i ngrit e i redukton në momente dialektike. Natyrisht apstraktimi dhe izolimi i elementeve është i domosdoshëm si në tërë një fushë hulumtimi, ashtu edhe te komplekset e veçanta të problemeve dhe të nocioneve brenda një fushe të hulumtimit. Por është me rëndësi të madhe fakti se a është kjo ecuri vetëm mjet për njohjen e tërësisë, apo kjo njohje abstrakte e fushës së izoluar e të pjesëshme ruan »autonominë« dhe mbetet qëllim në vehte. Për marksizmin pra, në fund të fundit nuk ekziston kurrfarë shkence e pavarur juridike, ekonomia nacionale, historia e t.j., po vetëm një shkencë e vetme unike, historiko-dialektike, shkencë mbi zhvillimin e shoqërisë si totalitet.

Pikëpamja e totalitetit nuk e përcakton megjithatë vetëm objektin por edhe subjektin e të njohurit. Shkenca borgjeze i trajton fenomenet shoqërore me vetëdije apo pa vetëdije, naivisht apo në mënyrë të sublimuar, gjithnjë nga aspekti i individit.¹ Nga ky aspekt nuk mund të dalë kurrfarë totaliteti, por më së shumti aspektet e një fushe të caktuar, madje më së shpeshti vetëm fragmentare: »faktet« e palidhura ose ligjet abstrakte të pjesërishme. Totaliteti i lëndës mund të shtrohet vetëm atëherë kur subjekti që e shtron është totalitet. Nëse ai rrjedhimisht, për ta menduar vetveten, është i detyruar ta mendojë lëndën si totalitet. Këtë pikëpamje mbi totalitetin si subjekt në shoqërinë mo-

¹ Se kjo nuk është e rastit, por rrjedh nga esenca e shoqërisë borgjeze e ka vërtetuar me saktësi Marks, në raport me robinsoniadat ekonomike *Kontribut kritikës së ekonomisë politike*, Hyrje, f. 173—174.

derne e përbëjnë ekskluzivisht klasët. Meqë Marksi, veçanërisht në Kapital, çdo problem e trajtoi nga ky aspekt, ai Hegelin, te i cili ende ishte e pranishme lëkundja midis »individit të madh« dhe frymës abstrakte të popullit, këtu edhe më me vendosmëri dhe në mënyrë më të frytshme e korrigjoi atë, sesa te çështja e »idealizmit« dhe e »materializmit«, ndaj këtë ithtarët e tij shumë rrallë e kanë kuptuar.

Ekonomia klasike, e edhe më tepër vulgarizatorët e saj, e trajtoi zhvillimin e kapitalizmit nga aspekti i kapitalistit të veçantë dhe kështu u ballafaqua me disa kundërtënie të pazgjidhshme dhe probleme iluzore. Marksi në *Kapital* në mënyrë radikale e ndërpreu këtë metodë. Këtë e bëu jo për arsye që ai tash si agjitus, menjëherë çdo moment dhe ekskluzivisht ta trajtojë nga pikëpamja e proletariatit. Nga një njëanshmëri e tillë do të mund të lindte një ekonomi e re vullgare, me një parashenjë të kundërt. Përkundrazi, ngase ai problemet e gjithë shoqërisë kapitaliste i trajton si probleme të klasëve që e konstituojnë, të klasës së proletariatit dhe proletarëve si tërësi. Me këtë rast një mori çështjesh fitojnë dritë të re, si shfaqen problemet e reja të cilat ekonomia klasike nuk ishte në gjendje as t'i vërente, e lëre më t'i zgjidhte, si shumë probleme të saj fiktive treten në asgjë: hulumtimi i çështjeve të këtilla nuk mund të jetë punë që bëhet në këta rreshta ku dëshirohet të përqëndrohet vëmendja vetëm në problemin metodik. Fjala është këtu për kërkesën që të theksohen dy presupozimet e aplikimit të njëmendët e jo të metodës dialektike, siç ishte rasti te epigonet e Hegelit, të demonstrojë kërkesën për totalitetin edhe si lëndë e shtruar edhe si subjekt që e shtron.

II

Pas decenieve të vulgarizimit të marksizmit, vepra kryesore e Roza Luksemburgut, *Akumulimi i kapitalit*² i qaset problemit nga ky aspekt. Kjo zbutje e marksizmit dhe shtrëmbrimi i tij në atë »shkencor« borgjez, shprehjen e vet të parë e të qartë e mori në *Premisat e socializmit*³ të Bernshtajnit. Nuk është aspak e rastit që kapitulli i njëjtë i atij libri, që fillon me sulmin ndaj metodës dialektike, në emër të »shkencës ekzakte«, përfundon me formulime që ia veshin vetë Marksit blan-kizmit. S'është e rastit ngase në momentin kur braktiset pikëpamja e totalitetit, pikënisja dhe qëllimi, pre-

² R. Luksemburg: *Akumulacija kapitala* (Ak. i kapitalit) Beograd 1955.

³ E. Bernshtajn: *Premisat e socializmit dhe detyrat e socialdemokracisë në Marksizam i revizionizam*, Naprijed — Zagreb 1958, f. 19—234.

misa dhe kërkesa e metodës dialektike; në çastin kur revolucionin kuptohet jo si moment i procesit, por si akt i izoluar nga procesi i tërësishëm, ajo revolucionarja te Marks doemos shfaqet si kthim në epokën primitive të lëvizjes punëtore, në blankizëm, ndërkaq, me parimin e revolucionit si vijim i sundimit kategorial të totalitetit shkatërronhet i tërë sistemi i marksizmit. Kritika e Bernshtajnit edhe si oportunizëm është tepër oportuniste që në këtë pikëpamje të lejonte të dalin në sipërfaqe të gjitha rrjedhimet.⁴

Por rrjedha dialektike e historisë, të cilën ata deshin ta përjashtonin nga marksizmi, edhe këtu oportunistëve u ka imponuar rrjedhime të domosdoshme. Zhvillimi ekonomik i periudhës së imperializmit ka bërë gjithnjë më të pamundura sulmet fiktive në sistemin kapitalist, analizën shkencore të dukurive të izoluar, në interes të »shkencës ekzakte«. Është dashur që jo vetëm politikisht të përcaktohesh a je për kapitalizëm apo kundër tij. Vendimi duhej të bëhej edhe teorikisht. Vendimi thoshte: ose zhvillimin e tërësishëm shoqëror ta trajtosh në mënyrë marksiste si totalitet, por atëherë edhe teorikisht edhe praktikisht të mposhtet fenomeni i imperializmit, ose ta bishtërosh këtë ballafaqim, meqë është fjala për kufizimin e vet në hulumtimin e veçantë shkencor të momenteve të veçanta. Pikëpamja monografike me siguri mbyll horizontin para problemit, para vëzhgimit nga i cili tërë socialdemokracinë e cila ishte bërë oportuniste, e kaplonte tmërri. Meqë ajo në fusha të veçanta ka gjetur përshkrime »ekzakte« dhe »ligje jashtëkohore« për raste të veçanta, u tret veçimi i imperializmit nga periudha e mëparshme. Gjendej thjesht brenda kapitalizmit »në përgjithësi«, ekzistimi i të cilit gjithnjë më tepër u dukej pikërisht aq adekuat me esencën e mendjes njerëzore, me ligjësi po aq natyrore si u dukej edhe Rikardos e pasardhësve të tij, ekonomistëve borgjezë vullgarë.

Do të ishte jomarksiste dhe jodialektike ajo shtruarje e çështjes sikur të fillonim të hulumtonim a e ka kushtëzuar praktikisht oportunizmi këtë kthim në metodologjinë e ekonomistëve vullgarë apo anasjelltas. Për mënyrën e trajtimit të materializmit historik që të dyja tendencat përfaqësojnë të njëjtën gjë: ato përbëjnë mjedisin shoqëror të socialdemokracisë të paraluftës, mjedisin nga i cili ekskluzivisht mund të kuptohen luftërat teorike rreth akumulimit të kapitalit të Roza Luksemburgut.

⁴ Këtë përndryshe e pranon edhe vetë Bernshtajni. »Unë në të vërtetë, thotë ai, për shkak të nevojave agjituese të partisë nuk i kam nxjerrë rrjedhimet e fundit nga qëndrimet e mia kritike «*Premisat*», bot. IX f. 260.

Sepse, debati të cilin e udhëhoqën Baueri, Ecksteini etj., nuk sillej rreth çështjes nëse zgjidhja e problemit të akumulimit të kapitalit që e ka propozuar Roza Luksemburg ishte e saktë apo e gabuar. Mospajtimet kishin të bënin, përkundrazi me atë se a ekziston fare ndonjë problem dhe me ashpërsinë më të madhe është kontestuar ekzistimi i ndonjë problemi real. Nga këndvështrimi metodik i ekonomisë vullgare kjo është plotësisht e kuptueshme, madje e domosdoshme. Sepse, nëse çështja e akumulimit nga një anë përpunohet si problem i veçantë i ekonomisë nacionale, e nga ana tjetër vështrohet nga pikëpamja e kapitalistit të veçantë, atëherë këtu në të vërtetë nuk ekziston kurrfarë problemi. Mospranimi i tërë problemit është i lidhur ngushtë me faktin se kritikët e Roza Luksemburgut e kanë lënë anash kapitullin kryesor të librit »Kushtet historike të akumulimit« dhe çështjen e kanë shtruar rrjedhimisht në këtë formë: A janë të sakta formulat e Marksit që bazohen në premisat metodologjike të izoluarat të një shoqërie që përbëhet nga kapitalistët dhe proletarët dhe si mund të paraqiten ato më së miri. Kritikët natyrisht nuk kanë vënë re se te Marksi kjo premisë ishte vetëm metodologjike, që problemi të kuptohej më qartë, prej ku mandej duhej të përfshihej më tej, e çështja e shtruar, të përfshihej në totalitetin e shoqërisë. Ata po kështu nuk vunë re se vetë Marksi në raport me të ashtuquajturin akumulim fillestar e bëri këtë hap në vëllimin e parë të *Kapitalit*; ata — me vetëdije apo pa të — e heshtin faktin se i tërë kapitali në raport me këtë çështje është një fragment i cili ndërpritet mu aty ku kjo çështje duhet të zhvillohet; se prandaj Roza Luksemburg nuk bën asgjë tjetër veçse fragmentin e Marksit në atë frymë e zhvilloi deri në fund dhe e plotësoi sipas idesë së tij.

Ata megjithatë patën qëndrim konsekuent. Sepse, nga pikëpamja e kapitalistit të veçantë, nga pikëpamja e ekonomisë vullgare ky problem vërtetë as që duhet të shtrohet. Nga pikëpamja e kapitalistit të veçantë shfaqet realiteti ekonomik si botë me të cilën sundojnë ligjet natyrore të amshuara, si botë e cila atyre ligjeve ua ka përshtatur sjelljen e vet. Realizimi i mbivlerës, akumulimi bëhet sipas tyre (edhe këtu madje shpesh jo gjithnjë) në formë të këmbimit me kapitalistët e tjerë të veçantë. Ndërkaq, edhe i tërë problemi i akumulimit është vetëm problem i formës së ndërrimeve të nduarshme që i shpreh forma P—M—P (para-mall-para)

⁵ Në Antikritiken, Roza Luksemburg e vërteton këtë bindshëm, veçanërisht për kritikun e saj më serioz Otto Bauerin, publikuar si shtesë e Akumulimit të kapitalit (Vër. e përkthyesit).

dhe M—P—M (mall-para-mall) gjatë prodhimit, qarkullimit e të ngjashme. Kështu, çështja e akumulimit për ekonominë vullgare bëhet çështje e imët e shkencës së veçantë që aspak nuk ka lidhje me fatin e kapitalizmit në tërësi, për zgjidhjet e të cilit garanton mjaft saktësia e »formulave« të Marksit, të cilat më së shumti — sikurse te Otto Baueri — duhet të përmirësohet në »frymën e kohës«. Se me këto formula parimisht kurrë nuk mund të kuptohet realiteti ekonomik, meqë premisë e tyre është apstraktimi nga ai realitet (trajtimi i shoqërisë, sikur ajo përbëhet vetëm prej kapitalistëve dhe proletarëve), se formulat pra mund të shërbejnë vetëm për mbarshtimin më të qartë të problemit, vetëm si trambolinë për mbarshtimin e njimendhtë të problemit, këtë Baueri dhe shokët e kuptuan po aq pak sikurse edhe nxënësit e Rikardos të cilët në kohën e vet nuk i kuptuan çështjet e shtruara në mënyrë marksiste.

Akumulimi i kapitalit prapë i përvetëson metodat dhe shtrimin e çështjeve nga Marks i ri, nga vepra e tij »Mjerimi i filozofisë« Siç analizohen atje kushtet historike, të cilat kanë mundësuar e theksuar ekonominë e Rikardos, po ashtu këtu e njëjta metodë aplikohet në hulumtimet fragmentare nga vëllimi i dytë dhe i tretë i *Kapitalit*. Ekonomistët borgjezë, si përfaqësues ideologjikë të kapitalizmit në ngritje, është dashur që »ligjet natyrore«, të cilat i zbuluan Smiti dhe Rikardo, t'i identifikonte me realitetin shoqëror, në mënyrë që në shoqërinë kapitaliste të gjenin shoqërinë e vetme të mundur, e cila i përgjigjet mendjes dhe »natyrës« së njeriut. Socialdemokracia, nga ana e saj, si shprehje ideologjike e asaj aristokracie punëtore, e cila është bërë mikroborgjeze, që ishte e bashkinterësuar për robërimin imperialist të botës në fazën e fundit të kapitalizmit dhe e cila, megjithatë, u përpoq t'i shmangej fatit të vet të domosdoshëm, luftës botërore, është dashur ta kuptojë zhvillimin në atë mënyrë sikur akumulimi kapitalist është në gjendje të zhvillohet në hapësirën e zbrazët të formulave matematikore (pra pa probleme, pa luftën botërore). Kështu ajo duke marrë parasysh zgjuarësinë politike dhe parashikimet, u katan-dis thellë nën ato shtresa borgjezomëdha që ishin të interesuara për robërimin imperialist së bashku me pasojat e mundshme të luftës. Pikërisht në bazë të kësaj socialdemokracia qysh atëherë mundi të kuptonte pozitën e saj të sotme: se ajo është rojtare e ekzistimit të amshuar të rendit ekonomik kapitalist, rojtare para atyre pasojave vdekjeprurëse-katastrofale, kah të cilat verbërisht shpinin eksponentët e vërtetë të kapitalizmit imperialist. Sikundër që identifikimi i »ligjeve natyrore« të Rikardos me realitetin shoqëror ishte mburojë ideologjike e kapitalizmit në ngritje, ashtu edhe interpretimi i Marksit nga shkolla austriake, identifikimi i

apstraksioneve të tij me totalitetin e shoqërisë nga ana e saj ishte vetëmbrojtje e »racionalitetit« të kapitalizmit në rënie. Dhe sikundër shqyrtimi i totalitetit të Marksit të ri me ashpërsi ndriçoi facies hipocratica* të kapitalizmit, atëherë ende në lulëzim, ashtu edhe në trajtimin e Roza Luksemburgut shkalla më e lartë e kapitalizmit, me inkuadrimin e problemeve kryesore të tij në totalitetin e procesit historik, merr karakterin e valles mizore, të një rruge të Edipit në takimin e fatit të paevitueshëm.

III

Roza Luksemburg përgënjeshttrimin të ekonomisë vullgare »marksiste« ia kushtoi broshurën e saj të publikuar pas vdekjes**. Ky përgënjeshttrim ndërkaq, për nga metodologjia dhe mbarshtrimi do ta kishte vendin më adekuat në fund të kapitullit të dytë të *Akumulimit të kapitalit*, si shqyrtim i katërt në përpunimin e kësaj çështjeje vendimtare të zhvillimit kapitalist. Sepse ajo veçoria parashtreuese në atë tekst ka të bëjë me faktin se ajo kryesisht i është kushtuar hulumtimit historiko-problemor.

Jo vetëm që analiza e Marksit për riprodhimin e thjeshtë dhe të zgjeruar përbën pikënisjen e hulumtimit në përgjithësi dhe hyrjen për përpunimin definitiv të vetë problemit. Brendia e librit është, si të themi, shkoqitje letrare-historike e debateve të mëdha për çështjen e akumulimit: debatet e Sismondit me Rikardon dhe me shkollën e tij, Rodbertusit me Kirchmannin, të nadrojnë me marksistët rusë.

Ndërkaq edhe te kjo mënyrë e paraqitjes, Roza Luksemburgu nuk qëndron jashtë traditës së Marksit. Mënyra e saj e komponimit, është madje kthim kah marksizmi autentik, i pafalsifikuar: kah mënyra e paraqitjes së vetë Marksit. Sepse vepra e tij e parë e pjekur dhe e përkryer, *Mjerimi i filozofisë*, përgënjeshton Prudonin, duke u kthyer prapa te burimet e vërteta të pikëpamjes së tij, te Rikardoja, nga njëra anë dhe të Hegeli, nga ana tjetër. Analiza: ku, si dhe para së gjithash pse Prudoni e kuptoi gabimisht Rikardon dhe Hegelin, paraqet burimin e asaj drite, e cila pamëshirshëm ndriçon kundërthëniet e vetë Prudonit dhe depërton deri te themelet e panjohura dhe të enrëta prej ku burojnë ato paragjykime: deri te marrëdhëniet klasore, shprehje e të cilave janë pikëpamjet e tij. Sepse »kategoritë ekonomike janë vetëm shprehje teorike, apstraksione të marrëdhënieve shoqërore të prodhimit« — thotë Marksi.⁶

* Fytyrën e zymtë (vër. e përkth.)

** Fjala është për *Antikritiken*, ibid. (vër. e përkth.)

⁶ *Mjerimi i filozofisë*, f. 94

E në qoftë se vepra e tij kryesore teorike për shkak të vëllimit dhe të shumësisë së temave e problemeve të veçanta të trajtuara aty, vetëm pjesërisht ka lejuar këtë mënyrë historiko-problemore të mbarshtrimit, atëherë kjo nuk bën të fshehtë homogjenitetin e përpunimit të problemeve. *Kapitali dhe Teoritë e mbivlerës* përnjë vetë qenia e tyre janë vepra, struktura e brendshme e të cilave është përmbushje përmbajtësore e atij problemi që *Mjerimi i filozofisë* e ka shtruar dhe skicuar në mënyrë aq të shkëlqyeshme dhe aq shprehëse.

Ky formësim i brendshëm i problemit shpie prapë te problemi qëndror i metodës dialektike, te mbisundimi i kategorisë së totalitetit dhe kështu te filozofia e Hegelit. Metodën filozofike të Hegelit, e cila vazhdimisht ishte në mënyrë më të vullshme në *Fenomenologjinë e frymës* — njikohësisht *histori e filozofisë* dhe *filozofi e historisë*, në këtë pikë me rëndësi Marks i kurrë nuk e ka braktisur. Sepse, identiteti dialektik hegelian i mendimit dhe i qenësimit, të kuptuarit e identitetit të tyre si unitet i totalitetit të një procesi, përbën gjithashtu esencën e filozofisë së historisë të materializmit historik. Madje edhe polemika materialistike kundër të kuptuarit »ideologjik« të historisë është e drejtuar më shumë kundër epigonëve të Hegelit, sesa kundër vetë mësuesit, i cili në këtë pikëpamje ishte shumë më afër Marksit, sesa që ai herë-herë në luftë kundër shtangimit »idealist« të dialektikës mund të mendonte. Idealizmi »apsolut« i epigonëve të Hegelit në të vërtetë është tretje e totalitetit burimor të sistemit,⁷ ndarje e dialektikës nga historia e gjallë dhe kështu — në fund — eliminimi i unitetit dialektik të mendimit dhe qenësimit. Ndërkaq, materializmi i dogmatizuar i epigonëve të Marksit përsërit të njëjtën tretje të totalitetit konkret të realitetit historik. Edhe pse metoda e tyre nuk shndërrohet në skematikë mendore të zbrazët, sikurse e epigonëve të Hegelit, ajo shtangohet në një ekonomi vullgare mekanike. Nëse të parët kështu kanë humbur aftësinë që me konstruksionet thjeshtë ideologjike t'i kapin ngjarjet historike, të dytët poaq dalin të paaftë të kuptojnë si lidhjen e të ashtuquajturave forma »ideologjike të shoqërisë« me bazën e tyre ekonomike, ashtu edhe vetë ekonominë si totalitet, si realitet shoqëror.

Për metodën dialektike, në atë me çka merret gjithnjë — e sjell atë rreth të njëjtit problem: Rreth njohjes së totalitetit të procesit historik. Prandaj, për të

⁷ Për raportin e Hegelit ndaj pasardhësve krahaso studimin e mrekullueshëm të hegelianit Lassell: *Die Hegelsche und die Rozenkranzsche logik*, Werke, Casirer, VI. Sa e sendërtonte vetë Hegeli gabimisht sistemin e tij dhe si e korrigjonte Marks, shih stud. *Ç'është marksizmi ortodoks?*

problemet »ideologjike« dhe »ekonomike« pushojnë të jenë të izoluar midis tyre dhe shkrihen në njëri-tjetrin. Historia problematike shndërrohet vërtet në një histori të problemeve. Shprehja letrare, shkencore e ndonjë problemi shfaqet si shprehje e tërësisë shoqërore, si shprehje e mundësive të saj, e kufijve dhe problemeve të saj. Përpunimi letraro historik i problemeve në atë mënyrë më së miri e shpreh problematikën e procesit historik. Historia e filozofisë bëhet filozofi e historisë.

Për këtë arsye nuk është aspak e rastit që të dy pjesët themelore me të cilat teorikisht fillon rilindja e marksizmit, *Akumulimi i kapitalit* i Roza Luksemburgut dhe *Shteti e revolucionit* i Leninit, edhe përngja mënyra e mbarshtrimit e rikthejnë këtë formë të Marksit të ri. Për të zhvilluar në mënyrë dialektike problemin në veprat e tyre, ata na japin njëfar pasqyre letraro-historike të zanafilles së atyre problemeve. Meqë shkoqisin zhvillimin dhe ndryshimin e pikëpamjeve që i paraprin mbarshtrimit të problemeve nga ana e tyre, meqë çdo etapë të ndriçimit dhe të orrësimit mendor e trajtojnë në tërësinë e kushteve dhe të pasojave të tyre, ata bëjnë të mundur që vetë procesi historik, fryt i të cilit është ajo mënyrë dhe ai rezultat i paraqitjes së problemit, të zhvillohet në gjallërinë e paarritshme. Nuk ka dallim më të madh sesa ai midis kësaj metode dhe asaj »që merr parasysh paraardhësin«, në shkencën borgjeze. (të cilës plotësisht i takojnë edhe teoricienët socialdemokratë). Meqë në të vërtetë shkenca borgjeze bën dallimin metodik midis teorisë dhe historisë, rrjedhimisht, problemet individuale i ndan metodologjikisht nga njëri-tjetri dhe kështu për shkak të karakterit shkencor ekzakt e përjashton problemin e totalitetit, historia problematike për vetë problemin bëhet ballast ose ngarkesë narrative. Ajo bëhet e tillë që mund të jetë me interes vetëm për ata ekspertë, shkapërderdhja e pakufijshme e të cilave gjithnjë më shumë fshehë kuptimin e vërtetë të problemeve dhe kultivon një profesionalizëm pa frymë.

Duke u lidhur me traditat mbarshtruese-metodike të Marksit dhe të Hegelit, historia problemore e Leninit bëhet histori e brendshme e revolucioneve të shek. XIX, ndërsa mbarshtrimi letraro-historik i Roza Luksemburgut bëhet histori e luftës për mundësitë dhe zgjerimin e sistemit kapitalist. Trëndjet e para të mëdha të kapitalizmit ende të pazhvilluar e në ngritje e sipër, krizat e mëdha të vitit 1815 dhe 1818/19 përgatisin luftën në formën e »parimeve të reja të ekonomisë politike« të Sismondit. Fjala është, sipas qëllimit të saj, për njohjen e parë reaksionare të problematikës së kapitalizmit. Trajta e pazhvilluar e kapitalizmit ideologjikisht shprehet në pikëpamje të gabuara e të njëanshme të kundërshtarit. Derisa skepsa reaksionare e Sis-

mondit në krizat shihte shënjen e pamundësisë së akumulimit, optimizmi ende i pathyer i ihtarëve të rendit të ri të prodhimit mohon domosdonë e krizave dhe në përgjithësi ekzistimin e ndonjë problematike. Në fund të kësaj rrjedhe plotësisht u ndryshua shtresa sociale e atyre që shtrajnë pyetje, si dhe domethënia shoqërore e përgjigjes së tyre: ndërkaq, dalngadalë zë vendin e vet tema mbi fatin e revolucionit, mbi rënien e kapitalizmit. Se analiza e Marksit në pikëpamje teorike vazhdimisht ndikoi në këtë ndryshim të domethënies — ishte shenjë se borgjezisë po i del nga dora udhëheqja ideologjike e shoqërisë. Derisa këtu në marrjen e qëndrimit teorik të narodnjakëve haptas del në shesh esenca e tyre mikroborgjeze reaksionare, është interesant të vërehet sesi »marksistët« e Rusisë gjithnjë më shumë bëhen luftëtarë ideologjikë të zhvillimit kapitalist. Ata transformohen në trashëgimi ideologjike të optimizmit social të një Say, Mac Culloch-it etj., në lidhje me mundësitë e zhvillimit të kapitalizmit. »Marksistët, legalë rusë — thotë Roza Luksemburgu — padyshim i kanë mundur kundërshtarët e tyre, narodnjakët, por ata kanë fituar tepër ... fjala ishte për atë se a është i aftë për zhvillim kapitalizmi në përgjithësi e veçmas në Rusi, ndërkaq marksistët e përmendur këtë aftësi të kapitalizmit e kanë vërtetuar aq me bazë, sa teorikisht e vërtetuan madje edhe amshueshmërinë e tij. Është e qartë, nëse presypozohet akumulimi pa kufi i kapitalit, se me këtë është vërtetuar edhe aftësia jetësore e pakufizuar e kapitalizmit... Nëse mënyra kapitaliste e prodhimit është në gjendje të sigurojë zhvillim të pakufizuar të forcave prodhuese dhe progres ekonomik, atëherë ajo nuk mund të tejkalohet«.⁸

Këtu inkadrohet grindja e katërt dhe e fundit e Otto Bauerit me Roza Luksemburgun rreth problemit të akumulimit. Çështja e optimizmit social ka përjetuar ndryshimin e ri të funksionit. Dyshimi në mundësinë e akumulimit të Roza Luksemburgu heq formën e vet absolute. Ai shndërrohet në çështje historike mbi kushtet e akumulimit dhe kështu në siguri se akumulimi i pakufizuar është i pamundshëm. Me faktin se akumulimi trajtohet në mjedisin e tërësishëm shoqëror të tij, ai bëhet dialektik. Akumulimi tash ngrihet në dialektiken e tërë sistemit kapitalist. »Në momentin kur skema e Marksit mbi reproduksionin e zgjeruar i përgjigjet realitetit — thotë Roza Luksemburgu, mund të paralajmërojë daljen, kufirin historik të lëvizjes së akumulimit, pra fundin e mënyres kapitaliste të prodhimit. Pamundësia e akumulimit është njikohësisht pamundësi e kapitalizmit për të zhvilluar më tutje forcat prodhuese

⁸ R. L. Akumulimi i kapitalit, ibid. f. 245.

dhe kështu domosdoshmëri objektive historike e rënies së kapitalizmit. Prej këtu del lëvizja e kunderthënsime e fazës së fundit imperialiste si periudhë përfundimtare në rrjedhen historike të kapitalit.⁹ Meqë dyshimi bëhet siguri dialektike, ai lë pas vetes gjithë atë që është mikroborgjeze dhe reaksionare nga e kaluara e vet: dyshimi shndërrohet në optimizëm, në siguri teorike të revolucionit social që po vjen.

Po ky ndërrim i funksionit, pozicionit të kundërt ia vë vulën e luhatjes mikroborgjeze, shpirtngushtësisë e dyshimit. Konstatimit të Otto Bauerit i mungon optimizmi i kthjellët i një Say ose Tugan Baranowskit. Baueri dhe bashkëmendimtarët e tij me gjithë terminologjinë marksiste, në esencë janë prudonistë. Përpjekja e tyre për ta zgjedhur problemin e akumulimit, më mirë të themi të mos e pranojnë si problem, mbaron në përpjekjen prudoniste për t'i ruajtur »anët e mira« të zhvillimit kapitalist dhe për t'i eliminuar »anët e këqija« të tij.¹⁰ T'i pranosh çështjet e akumulimit, do të thotë ndërkah të pohosh se këto anë »të këqija« janë elemente të pandashme të vetë esencës së kapitalizmit; që do të thotë se imperializmi, lufta botërore dhe revolucioni botëror duhet të kuptohen si domosdoshmëri të zhvillimit. Kjo natyrisht nuk u shkon për shtati, siç u theksua, interesave të atyre shtresave, për interesat ideologjike të të cilave flasin marksistët e qendrës: të cilët e dëshirojnë kapitalizmin e zhvilluar pa »gunga« imperialiste, një prodhim »të rregulluar« pa pengesa lufte. »Kjo pikëpamje — thotë Roza Luksemburgu — arrin deri atje sa përpiket ta bindë borgjezinë sesi militarizmi e imperializmi janë të dëmshëm për vetë atë, nga pikëpamja e interesave kapitaliste, se prandaj duhet të izohet pakica simpatizuese e këtij imperializmi dhe duhet të krijohet blloku i proletariatit me masat e gjëra popullore, që të, zbutet' imperializmi... dhe, të lirohet nga romuzet'. Si liberalizmi në periudhën e rënies së tij që kthehet prej monarkisë së informuar keq dhe apelon në atë që do të ishte më mirë e informuar, ashtu, centrumi marksist' dëshiron që nga borgjezia e keqe këshillëdhënëse t'i këthehet asaj të cilën do të duhej këshilluar.«¹¹ Baueri dhe shokët e tij kanë kapitulluar para kapitalizmit si në pikëpamje ekonomike, ashtu edhe në atë ideologjike. Kapitullimi i tyre teorikisht shprehet në fatalizmin e tyre ekonomik, në besimin se janë — vetëm si vegzë ideologjike e ekonomike e kapitalizmit, dëshira e të cilëve është e drejtuar kah një kapitalizëm »pa anë të këqija«, pa »gunga«. Ata njikohësisht janë në një »opozicion« mikroborgjez ndaj kapitalizmit: në opozitë etike.

⁹ Ibid. f. 325

¹⁰ Marks: *Mjerimi i filozofisë*, 93—95

¹¹ *Antikritika*, ibid. f. 465.

Fatalizmi ekonomik dhe ribazimi etik i socializmit ngushtësisht i takojnë njëri-tjetrit. Nuk është e rastit pse i gjejmë në të njëjtën mënyrë te Bernshtajni, te Tugan Baranovski dhe te Otto Baueri. Madje jo vetëm për shkak të domosdoshë që për rrugën objektive kah revolucionin, të cilën ata vetvetes ia kanë mbyllur, të kërkohej e të gjendet një zëvendësim subjektiv, por para së gjithash si pasojë metodike e trajtimit vullgar ekonomik: si pasojë e individualizmit metodologjik. Ribazimi »etik« i socializmit është ana subjektive e kategorisë së totalitetit, e cila, si e vetmja e aftë për përmbledhje, aty mungon. Për individin — qoftë ai tash kapitalist i veçantë apo proletar — është e domosdoshme që bota përreth, mjedisi i tij shoqëror (edhe si shprehje e tij teorike edhe si projekcion, natyrë) të shfaqet brutalisht si diçka e huaj për të. Botën e tillë mund ta marrë me mend ai vetëm në qoftë se ajo në teori e marrë formën e »ligjeve të amshuara objektive«, përkatësisht nëse fiton atë racionalitet, i cili është i huaj për njeriun, ku njeriu me veprimtarinë e tij nuk mund të ndikojë dhe ku ai nuk mund të depërtojë; nëse njeriu ndaj atij realiteti sillet në mënyrë kontemplative, fataliste. Një botë e tillë ofron vetëm dy rrugë të mundshme veprimtarie, të cilat janë rrugë fiktive. E para, shfrytëzimin dhe aprovimin e ligjeve të pandryshuara fataliste, në mënyrën e sipërpërmendur, për nevojat e njeriut (p.sh. teknika). E dyta, si veprimtari e drejtuar në brendi, si përpjekje që ndryshimi i botës të bëhet në të vetmen pikë të lirë që ka mbetur, në vetë njeriun (etika). Meqë mekanizimi i botës njikohësisht dhe domosdo mekanizon edhe subjektin e vet, vetë njeriun, kjo etikë mbetet gjithashtu abstrakte, vetëm normative, përkundër totalitetit si dhe njeriut të izoluar nga bota, mbetet joaktive dhe jokrijuese. Ajo mbetet kërkesë dhe ka thjesht karakter pretendimi. Lidhja metodike me *Kritikën e mendjes së pastër* dhe me *Kritikën e mendjes praktike të Kantit*, këtu tash është e pashmangshme. Ndërkaq, çdo »marksist« që në trajtimin e realitetit historiko-ekonomik ka braktisur totalitetin e procesit historik, metodën e Hegelit dhe të Marksit, për t'iu ofruar në çfarëdo mënyre metodës së veçantë shkencore dhe johistorike apo trajtimit »kritik«, i cili kërkon »ligjet«, është i detyruar që posa të shtrojë problemin e veprimtarisë — t'i kthehet etikës abstrakte të shkollës së Kantit.

Braktisja e kategorisë së totalitetit në të vërtetë e prish *unitetin e teorisë dhe të praktikës*. Veprimtaria, praktika — të cilën Marksi e shtroi si kërkesë në fillim të tezave të tij mbi Fojerbahun — në esencë është përkshim, ndryshim i realitetit. Realiteti, ndërkaq, mund të kuptohet dhe të përshkohet vetëm si totalitet, ndërsa

për ta bërë këtë është i aftë vetëm subjekti, i cili është edhe vetë totaliteti. Hegeli i ri nuk e shtronte kot si kërkesë të filozofisë së tij qëndrimin që »e vërteta duhet të kuptohet e të shprehet jo vetëm si substancë, por gjithashtu edhe si subjekt«.¹² Ai kështu e zbuloi mungesën më të thellë, kufizimin e filozofisë klasike gjermane, por në realizimin e kësaj kërkeje as filozofia e tij nuk qe konsekuente; ajo mbeti shumëfish e ngatërruar brenda kufijve të njëjtë si edhe filozofia e paraardhësve të tij. Ndërkaq, Marksit iu dha rasti ta zbulonte »të vërtetën si subjekt« dhe kështu të vendoste unitetin teori-praktikë, ngase ai mbushjen e totalitetit të njohur e përqendroi dhe e kufizoi në realitetin e procesit historik dhe kështu përcaktoi totalitetin i cili njihet dhe i cili duhet të njohet. Epërsia shkencore — metodike e pikëpamjes së klasës (ndaj individit) u bë e qartë më parë. Tani është i qartë edhe shkaku i epërsisë: *vetëm klasa është e aftë që ta përshkojë realitetin shoqëror përmes veprimtarisë dhe ta ndryshojë në totalitetin e vet*. Për këtë arsye »kritika« që aplikohet nga kjo pikëpamje, mbasiqë është trajtimi i totalitetit, është unitet dialektik i teorisë dhe i praktikës. Ajo është në unitetin dialektik njikohësisht edhe shkak edhe pasojë, edhe shprehje edhe motor i procesit historiko-dialektik. Proletariati si subjekt mendimi i shoqërisë me një të rënë then dilemën e pamundësisë: dilemën e fatalizmit të ligjeve të pastra dhe të etikës së besimit të pastër.

Në qoftë se pra, për marksizmin njohja e kushtëzimit historik të kapitalizmit (problemi i akumulimit) bëhet çështje jetësore, kjo ndodh për shkak se vetëm në atë lidhje, në unitetin e teorisë dhe të praktikës, shfaqet domosdoja e bazuar e revolucionit social, e transformimit total të totalitetit shoqëror. Vetëm në rastin kur edhe vetë të njohurit dhe njohja e kësaj lidhjeje mund të kuptohet si prodhim i procesit, mund të mbyllet rrethi i metodës dialektike (edhe ky përcaktim rrjedh nga Hegeli). Qysh në polemikën e saj më të hershme kundër Bernshtajnit, Roza Luksemburgu theksonte dallimin ndërmjet parciales dhe totale, ndërmjet trajtimit dialektik e mekanik të historisë (qoftë ai oportunist apo puçist). »Këtu — thotë ajo — qëndron — dallimi qëndror midis grushtshteteve blankiste të një 'pakice të vendosur', e cila në çdo çast shfaqet si nga gryka e revoles, gjithnjë në kohë të keqe dhe të marrjes së pushtetit me ndihmën e masës popullore me vetëdije klasore, e cila vetë mund të jetë vetëm prodhim i thyerjes së filluar të shoqërisë civile dhe e cila bart në vete legjitimitimin eko-

¹² Hegel: *Fenomenologjia e frymës*, Parathënia, Kultura — Zagreb 1955, f. 13.

nomiko-politik të shfaqjes në çastin e duhur».¹³ Ndërkaq, edhe në shkrimin e saj të fundit, thotë në mënyrë të ngjashme: »tendenca objektive e zhvillimit kapitalist, sipas atij qëllimi, mjafton që shumë më heret të krijohet një ashpërsim social — politik i të kundërtave në shoqëri dhe një gjendje e cila nuk mbahet, për të përgatitur fundin e sistemit sundues. Por këto të kundërta social-politike edhe vet në instancën e fundit janë rezultat i paqëndrueshmërisë ekonomike të sistemit kapitalist, nga ku buron ashpërsimi, i cili zmadhohet aq më shumë, sa më e ndieshme të bëhet ajo paqëndrueshmëri».¹⁴

Proletariati është, pra, njëkohësisht prodhim i kri­zës përmënte të kapitalizmit dhe ekzekutues i atyre tendencave që e shpien kapitalizmin në krizë. »Proletariati — ekzekuton gjykimin të cilin prona private ia komunikoi vetvetes kur krijoi proletariatin — thotë Marksi».¹⁵ Ai vepron në çastin kur ka kuptuar pozitën e vet. Ndërsa ai e njeh gjendjen e vet në shoqëri, në çastin kur lufton kundër kapitalizmit. Ndërkaq, vetëdija klasore e proletariatit, e vërteta e procesit si »subjekt« është çdo gjë tjetër më parë, se diçka që lëviz sipas ligjeve mekanike apo që mbetet stabile. Ajo është vetëdije e vetë procesit dialektik: është gjithashtu një no­cion dialektik. Sepse, ana praktike, dialektike e vetëdi­jës klasore, esenca e saj mund të bëhet e dukshme në trajtën e vërtetë të saj, kur procesi historik në mënyrë urdhërore kërkon të hyjë në fuqi, kur një krizë akute e ekonomisë e fut atë vetëdije në veprim. Përndryshe, ajo duke iu përgjigjur krizës latente — përmënte të kapitalizmit, mbetet teorike e latente: si vetëdije »e thatë« ose sipas fjalëve të Roza Luksemburgut, si »shu­më ideale« qëndron kundruall çështjeve të ditës dhe kërkon luftëra ditore.¹⁶

Në unitetin dialektik të teorisë dhe të praktikës, të cilin Marksi e njohu dhe e bëri të vetëdijshëm në luftë për çlirimin e proletariatit, nuk mund të ekzistojë kurr­farë vetëdijeje boshe, as si teori »e pastër«, as si kërkesë boshe, si normë boshe për veprimtari. Edhe kërkesa kë­tu ka realitetin e vet. Kjo don të thotë se ajo gjendje e procesit historik që vetëdijes klasore të proletariatit i ep karakterin »latent dhe teorik« të kërkesës, duhet të formësohet si realitet gjegjës dhe aktivisht të përfshi­het në totalitetin e procesit. Ky tip i vetëdijes klasore të proletariatit është partia. Nuk është e rastit që e njëjta Roza Luksemburg, e cila më parë dhe më qartë

¹³ *Reforma sociale apo revolucioni*, në përmbledhjen *Mark­sizam i revizionizam*, Naprijed — Zagreb 1958, f. 325.

¹⁴ *Antikritika*, ibid. f. 399

¹⁵ *Familja e shenjtë*, ibid. f. 80.

¹⁶ R. Luksemburg: *Masseustreik, partei und Gewerkschaften*, Lepzig 1919, f. 48.

se shumë të tjerë njohu esencën e aksioneve revolucionare të masave (ku ajo përndryshe ka theksuar vetëm aspektin tjetër të konstatimit, të përpunuar më parë që ato aksione duhet patjetër të dalin nga domosdoshmëria e proceseve ekonomike), e kishte të qartë më parë se shumë të tjerë rolin e partisë në revolucion.¹⁷ Për vullgarizatorët mekanikë, partia ishte trajtë boshe organizative — ndërsa lëvizja masive, revolucionit, gjithashtu vetëm çështje organizimi. Roza Luksemburgu herët dinte se organizimi është më parë pasojë sesa parakusht i procesit revolucionar, sikundër që madje edhe vetë proletariati mund të organizohet si klasë gjithashtu vetëm në proces dhe përmes tij. Në atë proces të cilin partia nuk mund ta shkaktojë as ta shmangë, i takon, ndërkahq, rol me rëndësi: të jetë bartëse e vetëdijes klasore të proletariatit, ndërgjegje e misionit të tij. Derisa mënyra aktive dhe gjithsesi »reale« e shqyrtimit që ka të bëjë me trajtimin sipërfaqësor, partisë i ndan detjra kryesisht organizative, përkundër faktit të revolucionit, e fut në pozicionin e fatalizmit të paqëndrueshëm, pikëpamja e Roza Luksemburgut bëhet burim i aktivitetit të njëmendtë revolucionar. Nëse partisë i takon që »në çdo fazë e moment të luftës të realizohet forca ekzistuese, pjesërisht e vërtetuar e vetëdijes së zgjuar të proletariatit dhe ajo të dalë sheshazi në qëndrimin luftarak të partisë, që taktika e socialdemokracisë për nga vendosmëria dhe mprehtësia asnjëherë të mos jetë nën nivelin e raportit të forcave, por përkundrazi, t'u prijë atyre«,¹⁸ atëherë ajo karakterin e kërkesave të veta në momentin akut të revolucionit e shndërron në realitet krijues, në mënyrë që të vërtetën që i takon e inkuadron në lëvizjen masive, kështu që prej domosdoshmërisë ekonomike të sajimit ngrihet në liri të veprimit të vetëdijshëm. Ky transformim i kërkesave në realitet bëhet levë e organizimit të vërtetë klasor revolucionar të proletariati. Njohja shndërrohet në veprim, teoria në parullë, ndërsa masa që vepron sipas parullës futet gjithnjë më fuqishëm në radhën e veteranëve. Nga parullat e sakta organikisht dalin parakushtet dhe mundësitë, madje edhe organizatat teknike të proletariatit luftarak.

Vetëdija klasore është »etika« e proletariatit, uniteti i teorisë dhe i praktikës së tij, pika ku domosdoja ekonomike e luftës për çlirim dijalektikisht shndërrohet në liri. Meqë partia njihet si figurë historike dhe si bartës veprues i vetëdijes klasore, ajo njëkohësisht shndërrohet në bartëse të etikës së proletariatit luftarak. Ky

¹⁷ Për pikëpamjen e saj krahaso vërejtjet kritike »Për kritikën e revolucionit rus dhe mendime metodike mbi çështjet organizative.

¹⁸ Massenstreik ... etj. ibid. f. 38.

funksion do të përcaktojë pozitën e saj. Madje edhe kur politika e saj nuk është gjithnjë në përputhje me realitetin empirik të çastit, nëse parullat e saj në momente të tilla nuk përcillen, rrjedha e domosdoshme e historisë jo vetëm që do t'i japë të drejtë, por forca morale e vetëdijes së vërtetë klasore të veprimit të drejtë e adekuat — edhe praktikisht dhe politikisht — realisht — do të japë frytet e veta.¹⁹

Sepse forca e partisë është morale: ajo mbushet me besimin spontan të masave revolucionare, të cilat nga zhvillimi ekonomik detyrohen të revoltohen dhe me përjetimin se partia është objektivizim i vullnetit autentik të tyre, por ende jo mjaft të qartë, figurë e dukshme dhe e organizuar e vetëdijes së tyre klasore. Ndërkaq, në qoftë se partia ka dëshmuar dhe e ka merituar atë besim, ajo mund të bëhet udhëheqëse e revolucionit. Sepse, vetëm atëherë synimi spontan i masave me gjithë forcën do të shkojë kah partia, në drejtim të vetëdijesimit të vet. Oportunistët, duke ndarë të pandashmen i kanë mbyllur vetvetes këtë mundësi njohjeje, njohjen vetëvepruese të proletariatit. Prandaj, prijësit e tyre — në mënyrë tipike mikroborgjeze dhe sipas mendjes së shëndoshë — me tallje flasin për »besimin religjioz«, i cili gjëja ndodhet në bazë të bolshevizmit, të marksizmit revolucionar. Me këtë akuzë ata faktikisht pranojnë paaftësinë e tyre. Ky dyshim që gërren përbrenda, kot mbulohet me velin e »shkencorësisë« objektive. Çdo fjalë dhe çdo shprehje e fytyrës te të mirët shpreh dëshpërimin, ndërsa te të këqijtë, zbrastësinë, e cila qëndron mbrapa tyre: ndarjen e plotë nga proletariati, nga rruga dhe apeli i tij. Ajo që ata e quajnë besim dhe duan ta përulin me shenjë »religjioz«, nuk është as më shumë as më pak veçse saktësi e rënies së kapitalizmit dhe siguri — në fund — në revolucionin fitimtar të proletariatit. Për këtë nuk mund të ketë kurrfarë garancioni material. Ai na garantohe vetëm metodikisht, me ndihmën e metodës dialektike. Ndërkaq, edhe kjo garancë mund të provohet e të arrihet vetëm me vepër, me vetë revolucionin, me jetën dhe vdekjen për të. Nuk mund të jesh vetëm marksist i objektivitetit kabinetik, siç nuk ka siguri të garantuar »të ligjshme natyrore« për fitoren e revolucionit botëror.

Uniteti i teorisë dhe i praktikës nuk ekziston vetëm teorikisht por ekziston edhe në praktikë. Sikundër që proletariati si klasë mund të fitojë dhe të forcojë vetëdijen e vet klasore vetëm me luftë dhe kështu të ngrihet në nivelin e detyrës së vet historikisht të cak-

¹⁹ Krahason vendin e bukur në Junius broshurën (fjala është për broshurën e Roza Luks. të nënshkruar me pseudonimin »Junius«.

tuar, ashtu edhe partia dhe luftëtarët e veçantë, mund ta përvetësojnë teorinë e tyre realisht, nëse janë të aftë që atë unitet ta bartin në praktikë. I ashtuquajtur i besim religjioz këtu nuk është asgjë më shumë se siguri metodike për atë se procesi historik, pa marrë parasysh humbjet momentale dhe rëniet e papritura, shkon deri në fund, rrugës së tij vetëm nëpërmes veprave tona. Për oportunistët edhe këtu ekziston dilema e vjetër mbi pamundësinë; ata thonë: nëse komunistët parashikojnë, humbjen', atëherë ata ose duhet të heqin dorë nga çdo veprim, ose janë avanturistë të pandërgjegjshëm, politikanë të katastrofave dhe puçistë. Në inferioritetin e tyre shpirtëror dhe moral ata nuk janë të aftë që vetveten dhe çastin e veprimtarisë së vet ta shohin si moment të totalitetit të procesit: »humbjen« si rrugë të domosdoshme kah fitorja.

Në veprën jetësore të Roza Luksemburgut, uniteti dialektik midis teorisë dhe praktikës, midis fitores dhe humbjes, fatit individual dhe procesit të tërësishëm, përbënte udhërrëfimin e teorisë së saj dhe mënyrën e jetës. Qysh në polemikën e saj të parë kundër Bernshtajnit²⁰ ajo vërtetonte sesi marrja e domosdoshme e pushtetit shtetëror »para kohës« nga ana e proletariatit është vërtetë e domosdoshme, ndërsa besimin frikacak oportunist në revolucionin e demaskoi si »paradoks politik që del nga zhvillimi mekanik i shoqërisë, i cili për fitoren e luftës klasore presupozon një çast të caktuar jashtë dhe të pavarur nga lufta e klasave«. Siguria, e liruar nga iluzionet e çoi Roza Luksemburgun në luftën e saj për çlirimin e proletariatit: për çlirimin e tij politik dhe ekonomik, nga robëria materiale e kapitalizmit; çlirimin ideologjik, nga robëria shpirtërore në oportunizëm. Si udhëheqëse e madhe shpirtërore e proletariatit, ajo betejën kryesore e zhvilloi kundër këtij kundërshtarit të fundit, më të rrezikshmit, i cili më vështirë mundet. Vdekja e saj nga duart e kundërshtarëve të saj më të mdhej e më të mllëfosur Scheidemannit dhe Noskut, është kurorëzim i jetës dhe i mendimit të saj. Fakti që ajo në kryengritjen e janarit — e cila teorikisht ka mundur të parashikohej vite më parë, ndërsa taktikisht në çastin që ndodhi — mbeti me masat dhe me to ndau fatin, është gjithashtu rrjedhojë e unitetit të teorisë dhe praktikës në veprimtarinë e saj, si dhe armiqësia për vdekje e merituar e vrasësve të saj, e oportunistëve socialdemokratë.

Janar 1921

*Përktheu nga serbokroatishtja
Kadri METAJ*

²⁰ *Reforma sociale apo revolucioni*. Ibid, f. 325.

ARTIKUL

ČLANCI

**gani
bobi**

**RRAFSHI
POPULLOR
I INTEGRIMIT
SOCIOKULTUROR
TË SHQIPTARËVE**

I. Njësitë dhe format integrative në rrafsh popullor

Kulturës shqiptare, bile deri në periudhën për të cilën po flasim ne*), i përgjigjet sintagma *kulturë popullore* me tipare dalluese të formuara kryesisht nën veprimin e rrethanave pushtuese. Vetë qëndresa dhe përballimi i këtyre rrethanave flasin për arritjen e një njësie relativisht të lartë të integritimit sociokulturor të shqiptarëve, të cilës, duke mos gjetur fjalë të tjera, i përshatet formulimi i Stjuardit: *rrafsh popullor i integritimit sociokulturor*.¹ Në këtë rrafsh, si një »sistem sociokulturor shumëfamiljar;«² si një tërësi shoqërore e kulturore ndërfamiljare e ndërfarefisnore, ekzistonte një optimum vlerash e sjelljesh ideale për të gjithë, i cili normohej e ripërkufizohej vazhdimisht duke u nisur nga sjelljet dhe vlerat pakashumë të ndryshme dhe pakashumë devijante të individëve, si dhe duke i marrë parasysh rrethanat pushtuese dhe rrethanat e mjedisit. Brenda këtij optimumi diferencoheshin disa forma të sjelljes mbi baza të moshës, të gjinisë, ndonjëherë të profesionit dhe të disa roleve dhe të pozitave të tjera në familje e më gjerë, mirëpo të gjitha këto — diferencime nuk ishin të asaj shkalle sa t'ia merrnin karakterin homogjen kulturës shqiptare dhe ta bënë atë që të mos i mjaftonte vetvetes.

*) Ky punim është pjesë e një studimi mbi integritimin sociokulturor të shqiptarëve midis dy luftërave botërore.

¹ Džulijan Stjuard, *Teorija kulturne promene*, BIGZ — Beograd, 1981, f. 91.

² Po aty, f. 92.

Integrimi sociokulturor i shqiptarëve në rrafsh popullor, si kuadër i përbashkët, si tërësi shoqërore e kulturore që ishte e përcaktuar nga raporti i ndërsjellë me njësitë ende më të ngushta integrative sociokulturore (familja, vëllazëria, fshati, fisi, bajraku, krahina), u dha mundësinë shqiptarëve që ta manifestonin veten në mënyrë më të plotë: nuk ishin më vetëm pjesëtarë të familjes, as dhe vetëm të fshatit, apo dhe vetëm të fisit; ishin edhe pjesëtarë të popullit dhe përgjegjës për të. Integrimi sociokulturor në rrafsh popullor e ndryshoi pozitën dhe funksionin e individit brenda njërive më të ngushta, meqë u krijua një raport i ri i ndërsjellë mes tyre. Ndërveprimi sociokulturor në rrafsh popullor i liron nga disa përgjegjësi njësitë më të ngushta integrative sociokulturore, për t'i bërë të varura dhe përgjegjëse ato ndaj njërive gjithnjë më të gjera shoqërore e kulturore. Kjo nuk do të thotë se ato humbën të gjitha funksionet e mëparshme të tyre. Përkundrazi, ato ruajtën shumë funksione të veçanta të tyre, mirëpo ruajtja e këtyre funksioneve nuk pati për pasojë krijimin e mënyrave të veçanta të jetuarit, përkatësisht, ndarjen subkulturore midis familjeve, fshatrave, vëllazërive, fiseve e bajraqeve: shaljanët nuk patën mënyrë të veçantë jetese nga krasniqasit, e aq më pak Colaajt nga Cufajt. Normat dhe institucionet shoqërore e kulturore, përkatësisht sistemi i vlerave nuk ishte një për Bajrakun e Mirëditës e një për Bajrakun e Nikçit: ai ekzistonte për të gjithë njësoj dhe përpunohej e ripërkufizohej vazhdimisht nga veprimi i rrethanave të reja shoqërore e historike. Rivalitetet e përçarjet mes familjeve, vëllazërive, fiseve dhe bajraqeve, nuk duhet të jenë *argument i mjaftueshëm* për të parë ndarjet kulturore e shoqërore midis fiseve shqiptare, ta zëmë, Këlmend e Berishë sikurse, fjala vjen, mes fiseve të indianëve — Peublo e Kuakiutla, çfarë ka pasur përpjekje të këtilla në shkrimet mbi shqiptarët. Nuk ka dyshim se rivalitetet dhe përçarjet e këtilla kryesisht u kushtëzuan, u nxitën dhe u stimuluan nga rrethanat pushtuese, brenda të të cilave jetuan shekuj të tërë shqiptarët. Veprime shpërbërëse e partikularizuese pati, bile edhe syresh intensive që krijuan zona të izoluara brenda kulturës dhe shoqërisë shqiptare, duke i ndërprerë për një kohë të gjatë kontaktet e komunikimet midis njëra-tjetrës dhe duke i lënë ato nën veprimin e faktorëve të ndryshëm ekzistencialë e konfesionalë, për ç'gjë NE-ja shqiptare shpeshherë mbeti e rrudhur brenda krahinës, brenda fisit, brenda bajrakut, brenda katundit, apo dhe brenda vëllazërisë. Me fjalë të tjera, rrafshi popullor i integritit sociokulturor të shqiptarëve rrudhej e shtrihej, ngushtohej e zgjerohej, ishte latent e bëhej manifestiv, varësisht nga rrethanat pushtuese. Që të shihet më shtruar ndërveprimi i njërive dhe formave integrative sociokul-

turore në rrafsh popullor, po i veçojmë disa tipare dalluese të kulturës shqiptare, duke u lejuar më parë t'i diskutojmë disa teza të thëna turravrap e me qëllime të caktuara për këtë popull dhe kulturën e tij.

Njëra nga këto teza është ajo mbi të ashtuquajturën *patologji akulturative* të shqiptarëve, e cila ka zotëruar një kohë të gjatë në literaturën mbi shqiptarët dhe e cila edhe sot po përvidhet në forma të ndryshme në disa shkrime mbi këtë popull. Shprehjet si *popull i mbyllur*, apo edhe *arnautë të egër*, *njerëz me bishta* (me bishta, gjithsesi, por duhet verifikuar: *me të deles a me të dhisë!*),³ e të ngjashme si këto e denoncojnë qëllimin final të kësaj teze. Ta lëmë qëllimin final më një anë e të shohim se cilat janë »motivet gnoseologjike« për një tezë të këtillë.

Po fillojmë nga varianti »më afirmative« e kësaj teze: shqiptarët janë popull i lashtë dhe me vlerë për »përfytyrimin retrospektiv« të indoevropianëve të vjetër. Në sajë të izolimit shoqëror e kulturor të tyre u ruajtën »të paprekura« dhe »të pandërprera« traditat dhe institucionet shoqërore e kulturore që nga koha e vjetër. Ruajtja e lashtësive »shpjegohet« me »karakterin e vendit« dhe »tenacitetin e banorëve«. Faktori i parë përkufizohet si »e dhënë gjeografike«, si »influcencë e formimit tokësor dhe e natyrës së vendit mbi jetën dhe mbi veprimet e banorëve«, ndërsa »tenaciteti i banorëve« mbetet të kuptohet vetvetiu si diçka që u takon shqiptarëve që nga koha kur u dukën ata në faqen e dheut!

Varianta tjetër e kësaj teze e sheh në »cilësitë natyrore« shkakun e »vonesës«, përkatësisht »retardimin shoqëror e kulturor« të shqiptarëve, gjendjen »parakulturore« të tyre. Ky »retardim« shoqëror e kulturor i shqiptarëve, i kushtëzuar nga »cilësitë natyrore« të tyre, është i një shkalle alarmante për popujt e kulturuar, prandaj duhet të bëhet çmos që të nxirren nga »kjo gjendje« përmes kulturimit (nuk thuhet asimilimit!) të tyre, ose të paktën duhet të mbahen nën kontrollin e vazhdueshëm që të mos e rrezikojnë Ballkanin dhe Evropën mbarë.⁵

Sipas një variante, apo nënvariante të tretë të tezës mbi patologjinë akulturative të shqiptarëve, ky popull për nga »orientimi« është »kundërshoqëror« dhe »kundërkulturor«. Është popull i luftërave »të pakuptimta«, i rebelimeve »të paqëllim«, i »mortaliteteve të dhunsh-

³ Khs: Miroslav Kërlezha, *Ese*, Rilindja — Prishtinë, 1979, f. 226 e tutje.

⁴ Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore V*, Rilindja — Prishtinë, 1975, f. 101.

⁵ Dr. Vl. Georgevitch, *Les Albanaais et les Grandes Puissances*, Paris, 1913, f. 255 e tutje.

me«. Shqiptarët nuk vdesin nga vdekja e rëndomtë, por duke e vlarë njëri-tjetrin, pa ndonjë arsye, apo për shkak të rivalitetit.⁶ Kështu vrasin edhe të tjerët, pa e ditur se pse e bëjnë këtë punë.

I ashpërsuam qëllimisht disa variaanta e nënvariaanta të tezës mbi patologjinë akulturative të shqiptarëve në mënyrë që të mund t'i shohim më qartë »konsekuencat« e kësaj teze. Të vazhdojmë nga aty ku filluam të flasim për këtë tezë, nga variaanta »afirmative« e saj: shqiptarët i ruajtën »të paprekura« zakonet dhe traditat e të parëve që nga kohërat më të errëta e më të lashta. Këtë »punë« e bënë për shkak të »karakterit të vendit« dhe të »tenacitetit« të tyre. Duhet të thuhet që këtu se është e pamundshme të flitet për izolimin në kuptimin e ruajtjes së »paprekur«, apo »të pandërprerë« të zakoneve dhe të traditave të një populli. Pastaj, vetë izolimi është rrjedhojë e kontaktit. Po të mos ekzistonte kontakti, s'do të mund të flitej për dukurinë e izolimit dhe, anasjelltas, sikur të mos ekzistonte izolimi, s'do të mund të flitej me të drejtë për kontaktin. »Në esencë, izolimi relativ dhe kontaktet pakashumë intensive — janë dukuri që sipas një rregulle manifestohen së bashku«.⁷ Në anën tjetër, »karakter i vendit« si »e dhënë gjeografike« nuk mund të jetë faktor kryesor e as vendimtar për të shpjeguar »izolimin« shoqëror e kulturor të shqiptarëve e as ruajtjen e »vjetërsive« të tyre. Me këtë nuk duam ta injorojmë krejtësisht »karakterin e vendit« si faktor me rëndësi për krijimin e tipareve kulturore, mirëpo mund të gjendet një mori »karaktere vendi« të ngjashme, mbase edhe të njëjta, por me kultura dhe shoqëri të ndryshme. Nuk ka mjedis natyror që nuk është »tolerant« për disa (sa të duash!) sisteme shoqërore e kulturore. Përshtatja ndaj mjedisit kurrnjëherë nuk mund të jetë e asaj shkalle që t'i bëjë të pamundshme ndryshueshmëti dhe dinamikën sociokulturore të një populli.

Tiparet dalluese të kulturës shqiptare nuk mund të shpiegohen vetvetiu me tiparet e mjedisit natyror (»karakterit të vendit«), sepse dalin vështirësi të pakapërcyeshme për t'i shpjeguar pastaj »më se një të tretën e popullsisë« kë këtij populli që »zgjodhi« rrugën e mërgimit dhe ekzistencën jo të sigurt jashtë vendit të vet dhe të tjerët, »me dhjetëra mijë«, që lanë qytetet e fushat për t'u ngulitur në »malet e zeza« gjatë ardhjes së turqve dhe shtrirjes së sundimit të tyre në Shqi-

⁶ Coon, Carlton; *Caravan, The Story of the Middle East*, New York, 1961 (Shih: Vera St. Erlich, *U društvu s čojekom*, SNL — Zagreb, 1978, f. 80.).

⁷ Zigmunt Bauman, *Kultura i društvo*, Prosveta — Beograd, 1984, f. 113.

përi.⁸ Është shumë afër mendësh se gjithë këtë »rrugë« nuk e bënë shqiptarët për të ruajtur »me besnikëri« zakonet dhe traditat e tyre dhe për t'i lënë »të paprekura« ato siç ua kishin lënë të parët e tyre. Ndryshueshmë të shoqërore e kulturore qenë të paevitueshme, qoftë si përshtatje mjedisëve të reja natyrore, qoftë si përshtatje ndaj rrethanave pushtuese, pa marrë parasysh a qenë ato procese të mbylljes e të primitivizimit sekundar të të arriturës, të rezistencës, apo procese të përpunimit dhe të rikrijimit të elementeve kulturore. Nuk mbetën konstante zakonet dhe institucionet shoqërore e kulturore të shqiptarëve, por mbeti konstant vetëm ndryshimi i tyre.

Siç e thamë më sipër se »izolimi« shoqëror e kulturor është manifestim i përbashkët me kontaktet shoqërore e kulturore (s'mund të ketë izolim pa prani të kontakteve dhe s'mund të flitet për kontaktet pa prani të një izolimi relativ), ashtu duhet të thuhet edhe për izolimin shoqëror-hapësinor: nuk është vetëm izolimi kulturor rezultat i izolimit shoqëror-hapësinor, por edhe izolimi shoqëror-hapësinor është rezultat i izolimit kulturor. »Karakteristikat e shumta të shoqërive dhe të kulturave të caktuara, bile edhe të qarqeve të tëra shoqërore-kulturore, nuk mund të interpretohen thjesht me karakteristikat e mjedisit natyror, por përmes një tipi të veçantë të drejtpeshimit midis atij mjedisi dhe banorëve të tij si dhe izolimit shoqëror-kulturor që është bërë i mundshëm në sajë të atij drejtpeshimi, e i cili njëkohësisht ka shkaktuar kumulimin dhe intensitetin e karakteristikave të veçanta për një kohë të gjatë«.⁹

Pse i »zgjodhën« shqiptarët »malet e zeza«, apo »rrugën e mërgimit«, është rezultat kompleks i proceseve të veprimit të ndërsjellë të shumë faktorëve. Njëri nga këta faktorë ka të bëjë me atë se shqiptarët duhej të kishin arritur një shkallë të konsiderueshme të integritetit sociokulturor para ardhjes së turqve në trojet e tyre. Rrethanat e reja të krijuara nga sundimtarët e rinj, kontaktet e dhunshme me ta dhe me kulturën që e sillnin me vete ata, shkaktuan procese mjaft intensive të interaksionit kulturor, që kishin për rezultat ndryshimet e vazhdueshme, modifikimet dhe rikrijimet e institucioneve shoqërore e kulturore të shqiptarëve. Mirëpo, këto ndryshime, këto procese të transkulturimit nuk hetoheshin, meqë u zhvilluan në drejtime të kundërta me synimet e pushtuesve dhe me kulturën e tyre. Së këndejmi, shqiptarët mbesin gjithnjë »arnautë të egër«,

⁸ *Historia e letërsisë shqipe I—II*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1975, f. 143.

⁹ *Zygmunt Bauman*, vep. e cit. f. 102.

»barbarë që s'lidhen«, »popull parakulturor«, »masë e ngjashme me kafshët«, mu pse kultura e tyre ishte e ndryshme nga ajo e atyre që e »vlerësonin«. Në terrin e mosnjohjes së kulturës shqiptare, çdo gjë e saj dukej zi. Popull me »patologji akulturative«, pse proceset akulturative të kësaj kulture zhvilloheshin në drejtime të ndryshme, e edhe të kundërta me kulturat e pushtuesve të tyre. Popull, jo vetëm »parakulturor«, por edhe »kundërkulturor«. Dhe — me të drejtë! Kultura shqiptare po i ripërkufizonte tiparet dalluese të saja në drejtim të kundërt me kulturat që u kishin sjellë më vete pushtuesit e tyre.

Orientimi i shqiptarëve për të qenë »popull parakulturor«, apo »popull kundërkulturor«, orientimi i këtij populli për të lënë fushat e për të marrë malet, është, padyshim, shprehje e një provokimi të padëshirueshëm, të cilit nuk mund t'i bënin ballë shqiptarët. Porosia:

*Të kam lënë malin
Të më rritësh djalin,*

e sintetizon këtë që u tha. Është zgjedhur mali për t'u rritur me furtunë e me rreze, për t'u ndeshur ballë për ballë me ujëqit e malit, për t'u rebeluar, për të përjashtuar dhunën e përbrendësuar nga jashtë, për t'u çliruar nga ajo dhunë e huaj; është zgjedhur mali si jetë me rreze e me të papritura; është zgjedhur mali si vlerë e dorës së parë shoqërore e kulturore, është zgjedhur, pra, trimëria si njëra nga vlerat dominante të kulturës shqiptare. Po çfarë »vlerash dominante«, çfarë »trimërie« e çfarë »kulture«, allahile, një popull rebel?! Një popull rebel që vritet mes vete e vret të tjerët, e s'di pse vritet e s'di pse vret. Pikërisht ashtu: shqiptarët shpesh herë s'kanë ditur se pse vriten e s'kanë ditur se pse vrasin! Shpjegimi, megjithatë, është: kur mllëfi i përmbajtur nuk mund të shpërthejë, kur synimet hakmarrëse nuk mund të realizohen, atëherë për t'u çliruar nga kjo »furi«, thotë Sartri, shkohet »deri aty sa vrahën mes vete: fiset luftojnë njëri kundër tjetrit, ngase nuk mund të konfrontohen me armikun e vërtetë — dhe mund të jenë të sigurt se politika koloniale do të bëjë çmos për t'i nxitur rivalitetet e tyre; vëllai duke ngritur thikën kundër vëllait të vet, mendon se kështu do ta shkatërrojë njëherë e përgjithmonë imazhin e urrejtur të përbuzjes së tyre të përbashkët».¹⁰ E gjithë kjo hata nuk është »regulativ natyror« i shqiptarëve, nuk është dhe »stuhi absurde«, as »shpërthim i instikteve të egra«,

¹⁰ Zhan — Pol Sartri, *Parathënie* në librin: Franc Fanoni, *Të mallkuarit e botës*, Rilindja — Prishtinë, 1984, f. 16.

por është hap drejt ripërvetësimit të tyre, hap drejt rivendosjes së sovranitetit. Para shqiptarëve, do të thoshte autori që e cituam, ishte alternativa: të mbesin të tmerruar ose të bëhen të tmerrshëm, domethënë t'i dorëzohen shpërbërjes së jetës ose ta pushtojnë unitetin e tyre gjinor. Zgjedhën këtë të fundit, edhe pse luftërat e tyre të tjerët i panë si fitore të barbarisë. U bënë të tmerrshëm sepse vetëm në këtë mënyrë mund të mos mbetnin të tmerruar; vetëm në këtë mënyrë mund të ishin dhe mund ta njihnin vetën e tyre të humbur; mund ta përvetësonin sërish atë: të ishin historikë e johistorikë njëkohësisht. Dhe — kjo histori dhe johistori ishin njësoj të domosdoshme, jo vetëm për baraspeshën psikoafektive të shqiptarëve, por edhe për »shëndetin e individit, të popullit dhe të kulturës« do të shtonte Niçeja.¹¹

Burrëria e shqiptarit është »me dalë në kushtrim për çdo rasë që ka nevojë shoqi, lagjja, katundi, bajraku, etj.«; »për shqiptarin është burri me mbetë në luftë«,¹² prandaj kjo dalje në kushtrim për çdo rasë, po edhe kjo mbetje në luftë, bënin që populli të lëvizte: të ishte kudo që ishte pjesëtari i tij në luftë kundër armikut. Falen gjaqet e zhduken rivalitetet, meqë zbulohen si përbrendësim i dhunës dhe i terrorit të push-tuesve kundër tyre. Fshihet historia, rrënohen ndalesat, sepse të vrasësh një pushtues, do të thotë »me një gurë t'i vrasësh dy zogj, t'i zhdukësh përnjëherë një shtypës dhe një të shtypur: mbetet një njëri i vdekur dhe një njëri i lirë; i gjalli, për herë të parë, e ndien trollin kombëtar nën shputat e këmbëve. Në atë çast kombi nuk largohet prej tij: ai e ndesh atë kudo që të shkojë, kudo që të jetë — kurrmë s'është larg tij, ai gërshetohet me lirinë e tij«. ¹³ Ja, »patologjia akulturative« e shqiptarëve, ja, »fakti kundërshoqëror« e »kundërkulturore«! — bënë me gisht disa kulturologë dhe antropologë »të paangazhuar«. Pikërisht ajo që në »dritën e shkencës së tyre quhej »patologji akulturative« dhe »fakt kundërshoqëror« e »kundërkulturore«, në »terrën« e kulturës shqiptare ishte »manifestimi më i plotë kulturor«. ¹⁴ Rebelimet aq të shpeshta të shqiptarëve, që përfunduan, jo njëherë, në luftëra të organizuara dhe të vetëdijshme

¹¹ Fridrih Niçe, *O koristi i shteti istorije za život*, Grafos — Beograd, 1979, f. 10.

¹² Kr. Maloku, *Shpirti i shqiptarit*, Bota shqiptare, Tiranë, 1943, f. 347.

¹³ Zhan — Pol Sartri, vep. e cit., f. 19.

¹⁴ »Mendojmë se lufta e organizuar dhe e vetëdijshme që e ndërmerr populli i kolonizuar për ta vendosur sovranitetin e kombit, përbën manifestimin më të plotë kulturor që mund të jetë«; Franc Fanoni, *Të mallkuarit e botës*, Rilindja — Prishtinë, 1984, f. 223 e tutje.

për çlirimin e tyre kombëtar dhe që u bënë, shpeshherë, njësia më e fortë integrative sociokulturore e tyre, hapën perspektiva të reja dhe vendosen *njërëzi të reja*, për vete dhe për të tjerët, prandaj *manifestimi kulturor* i këtyre luftërave është i pakontestueshëm. Po edhe rebelimet e pa ndonjë »rezultat final«, kishin domethënie kulturore: ato i çlironin shqiptarët nga *neurozat push-tuese*, i çlironin ata nga *kompleksi i inferioritetit*, ua kthenin atyre vetëbesimin, të cilin me aq insistim domin t'ua rrënonin të tjerët, duke i quajtur *njerëz me bishta e bisha të egra me fytyrë njeriu*.¹⁵ Në mos qoftë »final«, njëllot rezultati është edhe kjo që thoshte Ami Bue: »Në qoftë se Shqiptari ka cilësi fizike të Zvicëranëve e të Tirolasvet, në qoftë se ay është si dhe ata një ecës i palodhur me këmbë, i cili me pushkë majë supit, ngjit e zbrit posi dhijat majat e maleve, janë bashkuar tek ay edhe gjallëria dhe shkathtësia jugore me hollësi dhe prezencë të jashtëzakonshme të mendjes. Janë populli i përgjigjeve të shpejta e therëse *par excellence*. Krenaria natyrore e Shqiptarit vërehet në më të voglat fjalë të tija, në gjestet, në ecjen e tij të lehtë dhe mund të themi teatrore. Kuraja i është e lindur...«¹⁶ Edhe ky vetëbesim dhe kjo »kurajo« ishin »fakte kundërkulturore«, »dëshmi« të »patologjisë akulturative« të shqiptarëve: ç'u duhej atyre kurajoja e ç'u duhej atyre vetëbesimi, kur »këto« nuk i kërkonin pushtuesit e tyre. Në vend që ta ulnin kokën e të zbatonin me përpikëri urdhrat e detyrat që ua kishin vënë sundimtarët e tyre, ata bënë të kundërtën: ngrenin kryet lart dhe përgjigjeshin në mënyrë therëse. Ky veprim i kundërt i tyre, a nuk është njëkohësisht veprim kundërkulturor!?

Duke dashur t'i vëmë në pah kalimthi »arsyet njo-hëse« dhe motivet e tezës mbi patologjinë akulturative të shqiptarëve, e cila në forma të ndryshme edhe sot është e pranishme në disa shkrime mbi këtë popull dhe kulturën e tij, në njëfarë dore e denoncuan edhe qëllimin e saj: të pakulturuarit duhet të kulturohen (në kuptimin duhet të asimilohen), vrrësit duhet vrrë (në kuptimin që të shpëtojnë të tjerët) — të legjitimohet shtypja dhe terrori (në emër të humanizmit dhe të kulturës)!

T'i kthehemi tashti problemit për të cilin premtuam se do të flasim. Të përpiqemi t'i shohim interaksionet e njësive integrative sociokulturore në rrafsh popullor, duke u ndalur te disa nga tiparet dalluese të kulturës shqiptare. Të fillojmë nga »mali« që u përmend më

¹⁵ Khs: Miroslav Kërlezha, vep. e cit., f. 226 e tutje.

¹⁶ Ami Boue, *La Turquie, d'Europe*, bot. i vitit 1889, I, f. 380; Cit. sipas: Dr. Eqrem Çabej, vep. e cit. f. 114 — 115.

¹⁷ Kr. Maloku, vep. e cit., f. 347.

parë, nga »zgjedhja« e jetës me rreziqe e të papritura, pa konfor e pa bollëk, si orientim shoqëror e kulturor i shqiptarëve. Të marrësh një orientim të këtillë, do të thotë ta vësh guximin si vlerë dominante, e të cilit duhet t'i nënshtrohen vlerat e tjera. Shqiptarët këtë vlerë e quanin *trimëri*, mirëpo trimëria nuk u nda nga tërësia e vlerave shoqërore-kulturore, nuk u veçua ajo për t'u bërë kuantitet i pastër, vlerë »universale« që mund t'i zëvendësojë të gjitha vlerat e tjera, si paraja, fjala vjen, në kohën tonë. *Trimi është me nder e besë dhe Trim i mirë me shokë shumë*. Nuk mund të jetë trim ai të cilit i merret nderi, i tilli »është i dekun mbas Kanunit«, e nderi merret »në qoftë se i thotë kush se rren faqe burravet në kuvend, në qoftë se e pshtyn, i matet, e shtyn a i bie kush; në qoftë se ia prish ndër-mjetësinë a ja thyen besën, ja dhunon gruen a e ban me hikun, ja marron (turpëron) armët e krahit a të brezit; në qoftë se ja dhunon bukën tue ja nga mikun a punëtorin; në qoftë se ja thyen shtëpinë, vathin, kotecin a çarranikun n'oborr; në qoftë se ia ndalin uhan a detyrën, ja luejnë rrasën e vegshit në votër, ja marrin rendin e të lames së duervet, kur ulet me hangër më ndonji darsëm a festë, mort etj.«.¹⁷ Pastaj nuk mund të jesh trim e të mos jesh burrë, e »Burrnija nuk kallzon vetëm sjelljen e jashtme për ballë t'anmikut (...) Burrnija difton zotnimin e vetvedit, nderimin për nder të vet e të tjerëvet, qetësinë e duresën ndër të paprituna e rreziqe, papërkulninë e pathyeshmënin kundrejt të mitosunash. Për shqiptarin është burrni me mbetë në luftë, me i dal zot atij që i bie ndore me mprojtë të drejtat e veta dhe të shoqit, me falë anmikun, mos me ja xanë frymën të ligshtit, kur ja rrëfen ligshtiën e vet, me pritë e me përcjellë miq, me dalë në kushtrim për çdo rasë qi ka nevojë shoqi, lagja, katundi, bajraku, etj.«.¹⁸ Të jesh trim do të thotë njëkohësisht të jesh i zoti të presësh e të përcjellësh miqtë *me bukë e kripë e zemër*, apo *me bukë e pras e gas*, krejt njësoj, por ta nderosh mikun është kryesorja, ta konsiderosh atë si »shpijar të plangut«, »kushdo e kahdo të jetë«,¹⁹ të sakrifikohesh për të.

»Keqa Zeka ishte nandëdhjet' e pesë vjeç kur vdiq; para se me vdekë thirrin të mpin afër vendit e ndër të tjera porosi, qi i dha në kohë të vdekjes, i tha edhe këto fjalë: mikun bir-o prite me gëzim e ven-ja bukën para me shka të fali Zoti, pa e

¹⁷ Po aty, f. 348.

¹⁸ At. Shtjefën Gjeçov, *Buka, krypa e zemra*, Bota shqiptare, Tiranë, 1943, f. 355.

këqyr kah është e kush është. Tri herë e kam djegë kullën për miq e jam fikë se më mirë me u-fikë se me u-mbarrue».²⁰

Pastaj, nuk mund të jesh trim po qe *mikpreme*, sepse »më i madhi shnjërezim është me qenë mikpreme: ky nuk mund të duket ndër mbledhje e s'ka shka ban ndër shokë; hije e zezë randon mbi të e mbi vllaznin' e tij deri ditën që ta laj vedin dhe mikun, pse gjaku falet me kanû, por nderi s'i falet kuj«;²¹ ose, si thotë At. Gjeçovi: »Kanuja e Shkypnís', këtij farë mistreci ja djegë shpin', e gjobitë për ngajë të marrës qi ja lshon vendit edhe e qet prej bujrakut, tue ja lanë tokën djerr për pesë e më vjet, edhe pemët qi ka nranxë shpijet ja pret«.²² Mikpreme mund të bëhesh »edhe tue ta xanë vetëm emnin: 'Jam miku i njatij' e edhe pa të pasë qenë kurr te dera, po e ngau kush, të jetë mik në derë e ftyra t'u-vrugnu«.²³ Mandej »asht kanû i vendit, që, po ja preu kujt mikun, nuk e kërkon gjakun shtëpija e të vramit, por mikpremi. Kur vret mikpremi gjakësin e mikut, lan vedin e merr gjakun e mikut; vihen krye për krye me miqt e s'i bjen në gjak kujt«.²⁴

»Niset një hoxhë prej krahinës së Gjakovës për me vojtë në Shkodër, e me vedi ka një klysh qeni (...) Kur bjen në livadhe të Shalës, ndeshet me disa barij e fillon me i hy frika; i flet klyshit sa me ndie barijt: mos u-tut, bre qen, se jemi miqt e bajraktarit të Shalës (...) E vranë disa Shoshjonë që kishin dalë në pritë me vra Nikajt (...) U-përhap zani prej barijvet që e kishin ndëgjue hoxhën tue i thanë klyshit (...) S'vonon shumë, e shtëpija e bajraktarit, për mos me ja lanë atë marre vedit, vret dy vetë prej Shoshit, njenin për hoxhën e tjetrin për qenin«.

Trimëria si vlerë shoqërore e kulturore e shqiptarëve, nuk është e shkëputur edhe nga një vlerë tjetër, po ashtu dominante për shumë kohë në shoqërinë dhe kulturën e këtij populli — nga *besa*, e cila, siç thotë Kadareja, »për periudha të gjata« ka qenë »një mekanizëm që vepronte konkretisht në jetën e shqiptarit« dhe u shndërrua kështu »në një institucion të vërtetë juridik, me rregullat e nenet e saj, me fuqinë e saj ku-

²⁰ Bernardin Palaj, *Mikëpritja e malevet*, Bota shqiptare, Tiranë, 1943, 352.

²¹ Po aty, f. 351.

²² At. Shtjefën Gjeçov, vep. e cit., f. 356.

²³ Bernardin Palaj, vep. e cit., 352.

²⁴ Po aty, f. 353.

²⁵ Po aty, f. 352.

shtetuese dhe me interpretuesit e saja.²⁶ Trimi është *besnik* dhe trimi është *me besë*. Nuk mund të flitet për trimërinë aty ku *çartet* besa, aty ku është *pabesia*. Shumë varre u çilën, shumë shtëpi u rrënuan, shumë gjëmadha mbetën si kundërmonumente të *pabesisë*.

Siç deshëm të tregojmë deri më këtu, vlerat dominante shoqërore e kulturore të shqiptarëve përkufizoheshin nga tërësia e tyre dhe brenda asaj tërësie ato mbetën kualitet, sepse ishte i pamundshëm kuantifikimi i tyre pikërisht për shkak të raportit të ndërsjellë midis këtyre vlerave. Ky raport i ndërsjellë i përcaktonte ato dhe nuk lejonte shpëputjen e ndonjërës për t'u kuantifikuar e për t'u bërë *universale* që të mund t'i zëvendësonte të gjitha në kuptimin e asaj që thotë Marks i parë (»atë që mund ta blejë paraja, ajo jam unë vetë (...) unë që me para mund të arrij çdo gjë që dëshiron zemra e njeriut, vallë, nuk i kam të gjitha aftësitë njerëzore«).²⁷ Besojmë se është thënë qartë se nuk mund të ishe trim pa qenë edhe burrë, pa qenë edhe mikpritës, pa qenë edhe besnik, pa qenë edhe i ndershëm etj., ashtu sikundër nuk mund të ishe, ta zëmë, mikpritës pa i pasur edhe vlerat që i përmendëm më sipër.

Duke lënë fushat e duke marrë malet, shqiptarët zgjedhën mënyrën e tyre të të jetuarit me rreziqe e me trazira. Në këtë mënyrë jetese u tha se cilat vlera prijnë. U tha po ashtu se këto vlera ishin brenda një tërësie që i përcaktonte ato. Zgjedhja e vlerave dominante të një kulture është rezultat kompleks i veprimit të ndërsjellë të shumë faktorëve. Nuk mund të thuhet kurrnjëherë me siguri se akti i zgjedhjes së vlerave dominante të një kulture është akt i vetëdijshëm, mirëpo mund të jemi plotësisht të sigurt se kultura që zgjedh vlerat dominante të saja është kulturë e orientuar dhe se vlerat më kryesore që kishte zgjedhur kultura shqiptare e orientonin popullin në drejtim të kundërt me pushtuesit e tij. Burrëri, trimëri, nder e besë ishin »mos me lanë tjetrin me t'poshtnue«, »me dalë në kushtrim për çdo rasë«, »me mbetë në luftë kundër anmikut«, »mos me iu frigue rrezikut«, »me qenë i papërkulun e i pathyeshëm kundrejt të mitosunash« ..., vlera këto që nuk i kërkonin fare (!) pushtuesit e shqiptarëve. Një orientim i këtillë vleror nuk mund të kishte për »rezultat« të vetin konforin dhe bollëkun, rehatinë e indiferencën. Në këtë kuptim mbase vlen të përmendet ajo që thotë Herbert Luisi në *Albanien* e tij:

²⁶ Ismail Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Tiranë, 1980, f. 21.

²⁷ Marks — Engels, *O umetnosti i književnosti*, Kultura — Beograd, ff. 52 — 55.

»Një nga mbresat më të forta që na lë përpjekja e gjatë me polemin shqiptar është sigurisht kjo që te çdo shqiptar kemi të bëjmë me një njeri që vepron më vehte. Secili, qoftë i ditur apo i trashë, ka një fuqi vendimi të madhe dhe është mësuar të dërdhij edhe plëngun e gjakun e tij. Prandaj, në një gjendje të vështirë, çdo njeri, qoftë gjykimi i tij i vogël, paraqet një madhëri shpirti që bie në sy, sepse gjithkush është në gjendje të marrij një nismë të fuqishme. Shkurt, në Shqipëri nuk ka një gurmëbull njerëzish indiferentë.«²⁸

Vënia e guximit në krye të klerarkisë së vlerave, asaj trimërie të përkufizuar nga tërësia, nga raporti i ndërsjellë me vlerat e tjera, flet për një popull që e synon para së gjithash lirinë e tij. Brenda këtij orientimi nuk mund të zhvilloheshin interaksionet kumulative. Keqë Zekës tri herë i ishte djegur kulla për miq e ishte fikur, »por më mirë me u-fikë se me u-mbarrue«. Nuk besojmë se vargjet naive të Çajupit:

*Jam i varfër, po i lirë
ndaj më pëlqen varfëria,*

të kenë shprehur thellësinë e mendimit të Rusosë: *pa-suria dhe liria janë të papajtueshme*,²⁹ por jemi të sigurtë se orientimi shoqëror e kulturor i shqiptarëve nuk ishte në drejtim të kumulimit të pasurisë. Këtë e tregon fare mirë edhe qendrimi i tyre ndaj punës dhe shfrytëzimit të potencialit prodhues: »Bujku i malit prodhon në truall të tij *vetëm ato* që i duhen për jetesën e vet e të familjes së vet, zezavatin, pemën e duhanin *për sa i duhet* atij; ay bën më shumë vetë teshat dhe veglat që i nevojiten për punë dhe për mbajtjen e shtëpisë« (nënvizimet tona).³⁰ Shihet qartë se ka munguar orientimi për shfrytëzimin e plotë të potencialit prodhues. Bujku punon e prodhon *vetëm ato* e *vetëm për aq sa i duhet* atij. Nuk mund t'i merret e drejta kurrkujt që këtë që u tha ta shpiegojë si rrjedhojë të mungesës së kushteve për ruajtjen e tepricave dhe të plasimit të tyre në treg. Mbi këtë bazë mund të ketë të tillë që i shpiegojnë edhe zakonet e ndarjes e të dhurimit të shqiptarëve. Të thuhet, fjala vjen, se zakoni i ndarjes nga një *të zieme mish* të gjithë lagjes kur ndonjeri i asaj lagjeje *pret gjanë*, ka lindur ngase mungonin mje-

²⁸ Herbert Luis, *Karakteri i shqiptarit*, Bota shqiptare, Tiranë, f. 349.

²⁹ Jean — Jacques Rousseau, *Nacrt ustava za Korziku*, Politicka misao, 1/1979, f. 122.

³⁰ *Die Siedlungen Sudalbaniens von Dr. Martin Urban*, 1938, f. 17; Cit. sipas: Dr. Eqrem Çabej, vep. e cit. f. 112.

tet për të ruajtur mishin (mendohet në frigoriferë të ngrirjes së thellë!). Po të ekzistonte orientimi kulturor e shoqëror për interaksione kumulative, do të gjendeshin format edhe do të krijoheshin mundësitë për ruajtjen dhe plasimin e tepricave. Se një orientim i tillë ka munguar dhe se vetë sistemi i marrëdhënieve shoqërore dhe vetë sistemi i kulturës e kanë rezistuar një orientim të këtillë, flet edhe qëndrimi ndaj punës që kishin shqiptarët. Puna dhe produktet e punës nuk janë kuantifikuar sipas masës së tregut dhe të ligjeve të tij, për shkak të vetë orientimit shoqëror e kulturor, orientim ky që ka qenë jashtë influencës së tregut dhe që i ka rezistuar, siç thotë poeti Ndre Mjeda, *të rejes qytetni*, ku:

*për qëllim asht ari
e dhuna tregtari (.)*

Puna, përkatësisht, interesimi për punë, ndër shqiptarët përgjithësisht nuk është udhëhequr nga dëshira për të fituar, as për të krijuar »standard jetësor«, puna ka qenë dhe ka mbetur *kualitet* për aq sa ka qenë në pajtim me tërësinë e normave shoqërore e kulturore. Jashtë kësaj tërësie, qoftë si reduktim, qoftë si predimesionim, gjykohej. Puna ishte e domosdoshme dhe kishte kuptim vetëm për të përmbushur një minimum nevojash për ekzistencë. Këto nevoja ishin gati konstante, me fare pak tendenca të zmadhimit. Edhe mjetet e punës dhe teknikat e prodhimit që përdoreshin flasin se orientimi nuk ishte në drejtim të shtimit të prodhimtarisë dhe të shfrytëzimit maksimal të potencialit prodhues. Mund t'i bëhet vërejtje kësaj që u tha në atë kuptim që mjedisi natyror në të cilin jetuan shqiptarët përgjithësisht ishte i atillë që maksimumi i shfrytëzimit të tij nuk mund të siguronte më shumë se minimumin e mjeteve për ekzistencën e këtyre banorëve. Një vërejtje e tillë mbase mund të arnohet me disa të dhëna, mirëpo duhet të thuhet shtruar se ajo nuk mund të qëndrojë. Orientimi për shfrytëzimin maksimal të potencialit prodhues do të ishte në kundërshtim me ato vlera sociokulturore, të cilat shqiptarët i konsideronin të dorës së parë. Nëse më parë është orientuar që të mos lejojë t'ia luajë kush rrasën e vegshit në votër, ose nëse më parë ka vendosur me dalë në kushtrim për çdo rasë, atëherë është e ditur se sa mund të jetë »i brengosur« ai për arën që i prishet për shat', apo për bagëtinë që i kanë mbetë në vathë.

Mosinteresimi për shtimin e prodhimtarisë dhe shfrytëzimin sa më të madh të potencialit prodhues nuk duhet të kuptohet si »simptom« i përtacisë së shqiptarëve, e aq më pak »i përtacisë së lindur« të tyre, çfarë kemi ndeshur konstatime të këtilla për ta. U tha më

parë se puna nuk ishte e shkëputur nga tërësia e marrëdhënieve shoqërore dhe se ajo kontrollohej nga kjo tërësi për të mbetur kualitet brenda saj, e jo për t'u shkëputur e për t'u kuantifikuar nga shtytjet për profit që i stimulon tregu dhe mekanizmat e tij. Se nuk është fjala për një përtaci të lindur, por për një »lojalitet« ndaj sistemit të marrëdhënieve shoqërore dhe sistemit të kulturës së tyre, tregon fakti se shqiptarët punonin, bile ditën e natën, atëherë kur është »koha e punës«, koha e shtatit, e kosës, e drapërit... Në këtë kohë nuk mund të rrije e të lozje e të kuvendoje, sepse në sistemin e marrëdhënieve shoqërore dhe në sistemin e kulturës kjo kohë ishte e karakterizuar si *kohë e punës*, si *valë e punës*, prandaj punohej me të madhe. Natyrisht, kjo kohë nuk zgjatte shumë, kryesisht muajt e verës, mirëpo punohej aq sa nuk lejohet mundësia të flitet për përtacinë. Përkrye kësaj, po të merren parasysh shumë forma të punës së përbashkët, të pronave të përbashkëta; shumë zakone të ndarjes e të këmbimit të fruteve të prodhimit, gostitë, dera e hapur për mikun, *kushdo e kahdo qoftë ai...*, orientimi për profit e grumbullim të pasurisë nuk mund të ishte në pajtim me normat shoqërore e kulturore të shqiptarëve.

Me këtë nuk deshëm të themi se nuk ka pasur shmangie e veprime të kundërta në raport me sistemin e marrëdhënieve shoqërore dhe sistemin e kulturës. Ka pasur, bile jo pak. Vetë institucionalizimi i disa formave të singjenitetit kulturor, si, fjala vjen, institucionalizimi i virtytit të mbajtjes së fjalës në *besë*, i bujarisë në *mikpritje* etj., flasin se veprime për të deharmonizuar sistemin shoqëror-kulturor të shqiptarëve kishte mjaft. Forcimi i institucioneve të këtilla si primitivizime sekundare të të arritures, të kushtëzuara kryesisht nga rrethanat pushtuese, po bëhej represiv për vetë shqiptarët. Individit po është i kufizuar për ta organizuar jetën si do ai, sepse po është i detyruar të jetë »në pajtim« me institucionin dhe me normën, në krijimin e të cilave, hiç apo fare pak, ka marrë pjesë ai. Mirëpo, në çdo sistem shoqëror e kulturor, ku më shumë e ku më pak, gjenden alternativat. Cilat qenë alternativat dhe ambivalencat ndaj institucioneve shoqërore e kulturore të shqiptarëve në rrafsh popullor të integritetit të tyre sociokulturor — është çështja për të cilën po flasim këtu më poshtë.

II. Alternativat dhe ambivalencat ndaj institucioneve shoqërore e kulturore

Një varg formash të eskapizmit e ndeshim edhe në kulturën shqiptare si rrjedhojë e përpjekjes për t'u ikur kërkesave kolektive dhe presionit të tyre mbi individin,

përkatësisht si rrjedhojë e përpjekjes që të zvogëlohet tensioni i brendshëm i shkaktuar nga agresivitetet e lindura të individit dhe hiperfrenimet shoqërore e kulturore të tyre. Dëshira për të recuperuar instinktiven (afektiven, emotiven, imagjinativen, seksualen, korpuralen...) e ndrydhur, për së tepërmi të disiplinuar, të përdhunuar nga institucionet shoqërore e kulturore, manifestohet në mënyrë të ndryshme edhe në kulturën shqiptare.

Edhe pse represiviteti kulturor i shqiptarëve nuk ka arritur kurrnjëherë shkallën e një terrori të plotë të mendjes mbi emocionin, të raciales mbi imagjinaren, si në disa kultura ku emocionaliteti është bllokuar pothuajse tërësisht nga tirania e racionalitetit, kultura shqiptare ka krijuar ndalesat e saj mbi atë që është autentike dhe njerëzore te individit. Këtu më poshtë po i veçojmë vetëm disa nga format e recuperimit të instinktives së bllokuar nga kërkesat tepër rigorozë kolektive, përkatësisht nga normat dhe institucionet shoqërore e kulturore të shqiptarëve.

Së pari po i rikujtojmë rebelimet aq të shpeshta të shqiptarëve, të cilat, përveç funksionit të pakontestueshëm rezistues ndaj pushtuesvet, ishin edhe mënyrë e ikjes nga detyrimet që shtrinin mbi ta institucionet shoqërore e kulturore, si dhe ishin mënyrë e zbrazjes së agresivitetit dhe e krijimit të baraspeshës psikoafektive të tyre. Dalja në mal si cub, komit, çetani, kaçak..., i bënte të mundshëm shqiptarit që të çlirohej nga represiviteti i normave dhe ta përtërinte instinktiven e frenuar të tij pa e humbur prestigjin shoqëror, meqë kaçakët, edhe pse thenin normat shoqërore e kulturore, arsyetoheshin për guximin dhe admiroheshin për jetën me rreze që kishin zgjedhur. (Luftërat dhe lëvizjet e kaçakëve janë shprehje e pasandjeve e organizimit kolektiv të mllefrit dhe e orientimit të tij kundër pushtuesit të përbashkët).

Qëndrimi ambivalent ndaj normave dhe institucioneve shoqërore e kulturore është i theksuar te shqiptarët. Në një anë është kërkesa që ato norma të ruhen, të forcohen, verbërisht të respektohen — të bëhen si të themi tabu; dhe, më anën tjetër, është e flakët dëshira, s'po themi koshiente, për t'i rrënuar ato. Të ndalemi pak te sintagma: *cub i malit*. Na duket se, si kurrkund tjetër, në këtë sintagmë janë të njësuara zgjimi i kujtesës për veprime të ndaluara dhe zgjimi i tendencës që të zbatohen ato veprime. Ta vëmë këtë sintagmë në gojë të femrës shqiptare: *më ruaj, zot, nga cub'i malit!* Sa janë të njësuara në këtë lutje droja për veprime të palejueshme dhe dëshira e zjarrtë për veprime të tilla. Rrënkimi: *më ruaj, zot nga cub'i malit!* është për më tepër gjakim: *piqëm, zot, me njat cub mali!*

Autoriteti i institucioneve shoqërore e kulturore është i fortë, por i fortë dhe autoritet bëhet edhe ai që u kundërvihet autoriteteve të këtilla, prandaj edhe *droe-gjakimi* për një veprim të këtillë. Së këndejmi do parë konfirmimin shoqëror e kulturor të sjelljeve dhe të veprimeve që njëherë janë gjykuar si devijante dhe pastaj janë adaptuar dhe përkufizuar si kërkesa shoqërore e kulturore: nga rebeli u bënë rebelimet shoqërore, nga kaçaku — luftërat e kaçakëve që u shndërruan në luftëra popullore kundër shtypjes dhe sundimit të Turqisë.

Ambivalenca ndaj institucioneve dhe normave shoqërore, përkatësisht ashpërsimi më i fortë midis dëshirës për dhe dëshirës kundër zakoneve shqiptare vërehet posaçërisht po të shikohet problemi i dashurisë dhe i seksit në jetën dhe në kulturën e popullit tonë. Të rrallë janë ata popuj që kanë mundur të krijojnë institucione kaq represive ndaj seksit dhe dashurisë si shqiptarët, ashtu sikundër janë të rrallë ata popuj që e kanë realizuar seksin e dashurinë duke i vënë aq pran e pranë vdekjes së tyre, po ashtu, si shqiptarët. Dashuria për shqiptarët ishte, siç e thotë me frymëzim e thellësi mendimi Kadareja, »përtej bukurisë së syve dhe vetullave:

Mori e mira n'ortek të borës

këndon poeti anonim. Dashuria për të është në radhë të parë rrezik, dritë e bardhë alpine, lëbyrje sysh nga dëbora, marramendje lumturie, por të gjitha këto pranë një orteku, pra pranë vdekjes». ³¹ Dhe — kjo dashuri, mbase vetëm kjo që vjen si *ortek i borës* ka fuqinë të *shkulë themelet e shtëpisë*, të kanunit, nga *sevdaja e djalërisë*, siç thuhet në një këngë tjetër popullore. Ndalesat dhe kufizimet kaq të ashpëra të dashurisë nuk kanë arritur ta flakin këtë nga jeta e shqiptarëve; nuk kanë arritur dhe ta reduktojnë në një sentiment të flashkët, veç se e kanë shndërruar atë në një dramë të vërtetë, në një përjetim të thellë, që, nuk është tepër sërish të citohet poeti popullor, *shkul themelet e shtëpisë*.

Para kësaj force kaq të madhe, që shpesh bëhej po aq tmerruese, shoqëria shqiptare u desht të lëshonte pe: legjitimoi në njëfarë dore dashurinë, por me kusht që ajo të bëhej maksimalisht fshehurazi. Këtë më së miri e ilustronë vargjet popullore, të cilat për argumentime të tjera i citon profesor Çabej: ³²

³¹ Ismail Kadare, vep. e cit., f. 74.

³² Dr. Eqrem Çabej, vep. e cit., f. 119.

*Puthm e ndukëm sa të duash
Po mos dëfto e mos thuash.*

Mirëpo, edhe kur e dinte i treti, që të mos bëhej *e madhe*, që të mos bëheshin gjaqet, sekreti i dashurisë ruhej:

*Dhe një plakë që na diti
Asnjë fjalë nukë qiti*

Pastaj, nuk mjaftonte të dihej, por edhe të zihej qifti i dashnorëve. Bile, vargu popullor: *me ma çu' zanin peshë* ishte qortim-dëshirë e të dashuruarve: për aq sa dëshironin që të mos dihej për dashurinë e tyre, për aq dhe më tepër u bëhej qejfi kur zëri *çohej peshë* për ta.

Përkrye zakoneve të ashpëra me të cilat gjykohej seksi dhe dashuria jashtë institucionit të martesës, i cili gati gjithherë krijohej pa u pasë pyetur dhe pa u pasë marrë më parë pëlqimi i bashkëshortëve të ardhshëm, sidomos i femrës, individit gjente alternativa brenda dhe jashtë normave shoqërore e kulturore të shqiptarëve për të përmbushur e për të sublimuar në forma të ndryshme seksin, ashtu që të çlirohet nga neurozat dhe psikozat e ndryshme mbi këtë bazë. Janë martesat e hershme (vajza posa të bëhej *me flokë* e djali posa të bëhej *për ujë*), është mënyra *aktive* e jetës si rrjedhojë e rrethanave të vështira shoqërore e historike; janë dhe mekanizmat sociopsikologjikë (format e ndryshme të identifikimit dhe të projektimit), që e »kontrolluan« dhe e sublimuan këtë nevojë për aq sa të ruhej baraspesha psikoafektive e individit në kuadër të tërësisë së marrëdhënieve shoqërore e kulturore. Me këtë nuk po duam të themi se nuk pati deformitete e patologji, qoftë për shkak të predimensionimit, qoftë për shkak të reduktimit të kësaj nevoje. Megjithëkëtë, patologjitë, psikozat dhe neurozat e ndryshme mbi baza të seksit nuk mund të thuhet se janë e kanë qenë karakteristikë e shqiptarëve dhe për shumë arsye, veç tjerash edhe për këto që i përmendëm më sipër, por edhe për një që kujtojmë se duhet të përmendet: institucionet shoqërore e kulturore të shqiptarëve përgjithësisht nuk e kanë gjykuar seksin dhe dashurinë jashtë institucionit të martesës si *mëkat*, siç kanë arritur t'i ngarkojnë individët me këtë ndjenjë faji shumë kultura, por vetëm si *rrezik*. E, të jetohet me rreziqe e me të papritura — ishte, si të themi, orientim kulturor i shqiptarëve.

Qëllimi ynë nuk ishte të jepnim këtu një gjykim as global e as universal për seksin e dashurinë të shqiptarët, një gjykim i cili do të ishte i qëndrueshëm për të gjitha kohët dhe për të gjitha mjediset shqiptare. Dëshëm *vetëm* të tregojmë se edhe shqiptarët kanë gje-

tur forma të ndryshme, alternativa, për çlirimin e seksit dhe të dashurisë nga represiviteti i institucioneve shoqërore e kulturore të tyre. Këto forma e këto alternativa kanë qenë të ndryshme në kohë dhe në mjedise të ndryshme. Eqrem Çabej, fjala vjen, gjen gjurmë të zakonit të rrëmbimit të gruas, apo edhe të blerjes së saj, te shqiptarët, që lidh këto me zakonet e lashta të popujve indoevropianë: »Rrëmbimin e nuses na e tregojnë sot edhe zakonet e martesës së Shqiptarëve të Kalabrisë, ku dhandri me miq t'armatosun futet në shtëpinë e nuses dhe aty rrëmben kinse me përdhuni fatin e vet«.³³ I njëjti autor gjen të ruajtura në malësinë shqiptare gjurmët e, siç i quan ai, *përdalsisë miksores*, ngaqë i zoti i shtëpisë po e pyetka mikun si në tallje se me cilën grue të shtëpisë do të flejë.³⁴ Kësaj t'i shtohet edhe: *ara jonë, fara jonë*, shprehje kjo që po ashtu thuhet si në tallje nëse *zihet keq* një mashkull me gruan e tjetrit brenda fisit apo vëllazërisë. Shembujt e fundit, po të kihet parasysh edhe sistemi klasifikues gjuhësor për farefisninë, përmes të të cilit merret për bazë, jo raporti midis dy individëve, por raporti midis një individi dhe grupit (»nënë« nuk quhet vetëm prindi i individit, por edhe për afërsisht të gjitha moshataret e nënës së tij; »babë«, »motër«, »vëlla«, »mixhë«, e kështu me radhë), Frojdit do t'i mjaftonin për të parë gjurmët e *martesës kolektive (grupore)*³⁵ te shqiptarët. Fakte për konstruktimin e »teorive« të ndryshme mbi seksin dhe dashurinë te shqiptarët mund të gjenden dhe mund të mblidhen. Ne i përmendëm disa, jo për të bërë »teori«, por për të treguar qëndrimin konstant ambivalent të shqiptarëve ndaj institucioneve të tyre shoqërore e kulturore.

Ikja nga detyrimet e institucioneve shoqërore e kulturore, si dhe dëshira për të recuperuar atë që është në natyrën e njeriut, por e ndrydhur dhe e bllokuar nga këto institucione, është realizuar edhe përmes lojërave. Sociologjia e lojërave te shqiptarët nuk është as në fillimet e saja. Po edhe shkencat e tjera, si etnologjia, etnografia, antropologjia, psikologjia etj., nuk janë marrë sa duhet, për të mos thënë se nuk janë marrë fare, me studimin e lojërave të shqiptarëve, e kjo sipas Huizingas do të thoshte se nuk janë marrë me studimin e kulturës, meqë »ajo (kultura — G. B.) zhvillohet në lojë e si lojë«.³⁶ Në pastë ekskluzivitet në këtë mendim të Huizingas, atëherë »nuk është plotësisht absurde që diagnoza mbi një qytetërim të jepet në sajë të lojë-

³³ Po aty, f. 194.

³⁴ Po aty, f. 195.

³⁵ Khs: Sigmund Frojd, 4, *O seksualnoj teoriji Totem i tabu*, Matica srpska — Beograd, 1969, ff. 129 — 132.

³⁶ Khs: Rože Kajoja, *Igre i ljudi*, Nolit — Beograd, 1979, f. 9.

rave të tij» — do të thoshte Kajoa.³⁷ Në kulturën shqiptare i ndeshim të zhvilluara në forma të ndryshme lojërash e të gjitha tipeve, sipas klasifikimit të Kajoa. Porse, një konfirmim më të madh shoqëror kishin lojërat e tipit *agon* (me karakter garash), përmes të cilave vihehin në spikamë fuqia dhe shkathtësia individuale dhe kolektive — lroheshin shtytjet e rivalitetit, të triumfit, të superioritetit individual e kolektiv. Nuk kanë munguar edhe lojërat e tipit *ilinx* e *mimicry* si përpjekje e përmbushjes së dëshirave të ndrydhura për shkatërrim e kaos, për të fshirë për një çast kujtesën dhe për të braktisur për një moment personalitetin — për të qenë ai që s'jam; për të luhatur perceptimin e për të krijuar marramendjen, për të ndryshuar realitetin... Më të rralla te shqiptarët ishin lojërat e tipit *alea* (lojërat fatit). Mungesa e formave të lojërave të këtij tipi në kulturën shqiptare duhet të kërkohej në faktin se lojëtarë gjatë këtyre lojërave është në pozitë fare pasive, fuqia dhe shkathtësitë e tij nuk kanë kurrfarë funksioni, e as që mund të manifestohen, si dhe në faktin se lojërat e tipit *alea* zhvillohen mbi raportin kryesor dhe të vetëm: *rast-fitim*, ose, siç thotë ndryshe Kajoa, lojërat e fatit »janë edhe lojëra për para«,³⁸ prandaj si të tilla ato nuk kanë mundur të zhvilloheshin shumë për shkak të vetë orientimit shoqëror e kulturor të shqiptarëve, për shkak se ndikimi i tregut dhe i parasë, ka munguar ose ishte fare i vogël në kulturën tonë, pra, pse dëshira për fitim dhe profit nuk mund të zhvillohej brenda sistemit shoqëror-kulturor të shqiptarëve.

Lojërat, jo vetëm si qllirim, kompensim e sublimim i shtytjeve dhe i energjisë së frenuar të individit, por edhe si forma të integritetit sociokulturor, kanë një rëndësi të madhe, veçmas në kulturën tonë, ku vështirë mund të vihej kufiri mes lojës dhe realitetit. Loja, edhe atëherë kur manifestonte rivalitetet dhe triumfet individuale (si mrokjet *shkekas* e *shtatas*, *gurapesha*, *gjuajtja* e *shenjës* etj.), edhe atëherë kur manifestonte rivalitetet, ngadhënjimet dhe superioritetet kolektive (si lojërat *rrasash*, *kapuçash* etj.), nuk ishte e ndarë më vete, e ciptuar në *lojtar* e *spektator*, por ishte aktive për të gjithë. Që të mbështetet ky konstatim, po ndalemi pak te *loja* e *kapuçave*. Kur luhej kjo lojë oda ishte plot e përplot. Prania e *paidia-s* dhe e *ludus-it*, ishte, jo vetëm te lojtarët, por edhe të të gjithë të pranishmit. Ndjenja e fitores kolektive i ngritte në këmbë të gjithë, si lojtarët, ashtu edhe spektatorët. Të gjithë së bashku i këndonin të mundurit përmes një valleje monotone, me lëvizje anash, që krijonte një marramendje dhe përfyty-

³⁷ Po aty, f. 41.

³⁸ Po aty, f. 33.

rim të ndryshuar, i cili shpesh arrinte deri në ekstatë. Këngët e kapuçave ishin më shumë çirrje e shfryrje për-mes fjalësh e shprehjesh fyese e poshtëruese, të cilat në jetën e rëndomtë nuk mund të përdroreshin, e të cilat të mundurit duhet t'i duronin. Në fakt, loja e kapuçave ishte një kombinim i *agon-it* me *ilinx-in*, sepse në të manifestoheshin, jo vetëm rivalitetet dhe triumfet kolektive, jo vetëm aftësitë e grupit, por edhe dëshirat për marramendje e kaos, për shkatërrim. Sa e fortë ishte rënia për çergë dhe sa e furishme ishte hudhja e mestes kur lojëtari e gjente *me dhjetë plumbin*. Ç'dëshirë triumfale e rrënuese ishte ajo që dilte nga çirrjet e lëvizjet e ashpëra e monotone të të gjithëve kur »këndoheshin« të mundurit! Lojërat si kjo ishin me rëndësi të shumëfishtë për shqiptarët, jo vetëm për shkak të baraspeshës psikoafektive që e arrinin ata edhe përmes lojërave, por edhe për shkak të socializimit dhe të kulturalizimit të tyre, që ndihmohej nga lojërat.

Përfundimisht të themi se në kulturën shqiptare gjenden mjaft forma kulturore që flasin për qëndrimin ambivalent të shqiptarëve ndaj institucioneve të tyre shoqërore e kulturore dhe se u realizuan mjaft alternative, forma të ndryshme të eskapizmit, me qëllim që të rekuperohej instinktivja e ndrydhur nga represiviteti i kërkesave kolektive.

III. Funksionimi i njërive integrative sociokulturore

Njësitë integrative sociokulturore, që në tërësinë e tyre u jepnin tiparet *popullore* kulturës dhe shoqërisë shqiptare, funksiononin mbi baza të familjes së zgjeruar, mbi baza të farefisnisë së zgjeruar e brenda një optimumi që u siguronte individëve tipe të ngjashme sjelljesh për situata të ngjashme dhe, përmes një komplementariteti të ndërsjellë, tipe sjelljesh të ndryshme për individë të ndryshëm në çdo situatë. Këto tipe sjelljesh (tipi i sjelljes së fëmijëve, të grave, të të rinjve, të pleqve...) i nënshtroheshin një autoriteti të përbashkët koordinues, që krijonte tërësinë. Kemi të bëjmë me një diferencim të sjelljeve, të pozitave dhe të funksioneve shoqërore mbi baza rotacioni sipas moshës, siç do ta cilësonin sociologët. Mirëpo ky lloj diferencimi nuk nënkuptonte as dhënien e privilegjeve dhe as marrjen e të drejtave, sepse diferencimi i këtillë nuk përkufizonte pozitën për të cilat mund të konkurronin njerëzit e zgjedhur dhe të cilat mund t'i merrnin vetëm ata. Përkundrazi, nëpër të gjitha »pozitat« kalonte individi gjatë jetës së vet: prej »ruajtjes së qengjave« e deri te »balli i oxhakut«. Zigmunt Bauman i këtë lloj diferencimi do ta quante »organizimi të procesit të shoqërorizimit të personalitetit«, aftësim për të kryer punë dhe

detyra gjithnjë më të komplikuar, që mbështetet në njohuritë e fituara nga përvoja. Secila fazë (e rritës, e moshës) sjell prestigj dhe të drejta më të mëdha, por që »janë në pajtim me parimin e ekuivalencës dhe janë të lidhura me zmadhimin e obligimeve«. ³⁹ Së këndejmi do parë respektin aq të madh ndaj të vjetërve, sepse ata janë individët që i kanë kaluar të gjitha shkallët e punëve dhe të detyrave që paraqesin tërësinë e jetës, ndaj fjala e tyre duhet dëgjuar me vëmendje, e këshilla (urdhri) i tyre duhet të zbatohet me konsekuencë. Vetë shprehjet *plaku i shtëpisë, plaku i katundit, plaku (krye-plaku) i fisit* e të tjera si këto, flasin për autoritetin dhe monopolin e pleqve në familje dhe më gjerë. Kur thuhet *plaku i shtëpisë*, apo *plaku i katundit* nuk mendohet vetëm për njeriun më të mocëm, por edhe për njeriun më të urtë, më të ditur, më të drejtë, më autoritativ, më përgjegjës dhe më të pakontestueshëm. (Shiko pastaj: *plak-pleqëri*; duhet të pleqërohet kjo punë = duhet të mendohet thellë kjo punë; duhet të ndahet pleqëria = duhet të ndahet drejtësia, untia etj.) Vetëm njeriu që ka shkelur nëpër të gjitha fazat e jetës është i zoti të flasë për jetën, sepse është i rryer në përplasjet e saj. Si i till vetëm ai është në gjendje ta përkufizojë përvojën (diturinë) dhe t'ua përcjellë atë breznive. Roli shoqëror i pleqve është i madh; ata janë bartësit dhe interpretuesit kryesorë të kulturës, prandaj pozita e tyre në krye të vendit është e pakontestueshme.

Siç tha Baumani, diferencimi shoqëror mbi baza të rotacionit përkah mosha u ka ofruar mundësinë të gjithëve për të gëzuar të gjitha pozitrat shoqërore gjatë jetës së vet, kështu që është siguruar parimi i reciprocitetit në sajë të të cilit janë rregulluar marrëdhëniet dhe është harmonizuar qarkullimi i të mirave sipas ekuivalencës, e jo sipas eksploatimit. ⁴⁰ Ky parim i reciprocitetit në shoqërinë shqiptare ishte ndërfamiljar e ndërfarefisnor; ishte me fjalë të tjera në rrafsh popullor të integritetit sociokulturor, brenda të të cilit vepronin dhe gërshetoheshin mes vete njësitë integrative socio-kulturore mbi baza të fqinjësisë dhe mbi baza të fare-sisnës, e lidhjeve të tjera familjare, e ku pleqtë (e katundit, të fisit, të krahinës, të popullit) kishin *kryet* e vëndit (fjalën kryesore). Ata ishin të parët dhe si të tillë të pacënueshëm, meqë përmes tyre krijoheshin kontakti i drejtpërdrejtë me të parët tanë. Së këndejmi, *kulti i të parëve* bëhet me kaq ndikim në kulturën dhe në shoqërinë shqiptare: ne duhet të punojmë e të jetojmë në mënyrë që *mos ta marrojmë* njëri-tjetrit, por (dhe më kryesorja) *mos t'i marrojmë të parët tanë, mos*

³⁹ Zigmunt Bauman, vep. e cit., ff. 220 — 221.

⁴⁰ Po aty, f. 220 e tutje.

t'ua qesim hijen e zezë atyre. Ne jetojmë e punojmë ashtu siç na thonë të parët tanë, sepse duke i nderuar ata, nderojmë veten, duke ua zbardhur faqen atyre, zbardhim faqen tonë. M'u bëfsh plak (i katundit, i fisit) — ishte bekimi më i madh që i bënte nëna fëmijës, dhe, përpos dëshirës që fëmija të jetonte gjatë dhe t'i përballonte të gjitha »fazat« e jetës, në këtë bekim shpërthente edhe më e madhe dëshira që fëmija të bëhej i parë (më i urti, më i drejti, më trimi) që lidhet e bashkohet me të parët tanë.

Nuk ka dyshim se autoriteti i të parëve shkaktoi një lloj repetitiviteti, që forconte tipe të caktuara sjelljesh e vlerash, duke i bërë inerte ato, të qëndrueshme dhe rezistente ndaj ndryshimeve, mirëpo, nëse jetohej për *faqe të bardhë* të të parëve, »faqja e bardhë« e tyre përkufizohej (interpretohej, përpunohej, modifikohej) në të tashmen, nën veprimin e rethanave të reja, kështu që ndryshimi (dinamika e kulturës) nuk eliminohej. Optimumi i sjelljeve dhe vlerave i koordinuar nga autoriteti i përbashkët i të parëve (në kuptimin që e përdorëm më sipër: ndikonin në të tashmen, por edhe e tashmja në ta), nuk e favorizonte distingun: *interes i përgjithshëm — interes personal*, meqë nuk mendohej në mënyrën se mirëqenia e njërit mund ta rrezikojë mirëqenien e tjetrit, por, përkundrazi, mendohej se mirëqenia përplotësohej dhe begatohej nga identifikimi i pjesërishëm reciprok që e bashkonte njërin me tjetrin brenda familjes, brenda vëllazërisë, brenda fshatit, brenda fisit, brenda bajrakut e edhe më gjerë. Duke u krijuar njësia më e gjerë integrative sociokulturore (rrafshi popullor) si një sistem shoqëror-kulturore ndërfamiljar e ndërfaqefisnor, njësitë më të vogla (familja, vëllazëria, fshati, fisi...) u liruan nga disa funksione për t'u bërë të varura e përgjegjëse ndaj njësisë më të gjerë (rrafshit popullor), e cila ishte kuadër i përbashkët për të gjitha. Duke qenë rrafshi popullor kuadër i përbashkët për të gjitha njësitë integrative sociokulturore, kuadër brenda të të cilit krijohej raporti i ndërsjellë midis njësive, që e vështirë, të mos themi e pamundshme, shikëputja e ndonjëres njësi dhe ekzistimi i saj më vete e për vete (mendohet në diferencimin si orientim të ndryshëm kulturor). E kemi thënë edhe më parë se pikërisht për shkak të krijimit të rrafshit popullor, përkatësisht për shkak të veprimit të tij si njësia më e gjerë integrative sociokulturore, nuk qe e mundshme ndarja kulturore midis fiseve dhe bajraqeve.

Një mendim i këtyllë bie në kundërshtim me atë të Çebejt, i cili diferencimet kulturore, ose si u thotë ai, *qarqet kulturore*, i sheh të jenë »lindur e rritur organikisht prej truallit të fisit«,⁴¹ sepse, sipas Çabejt, »lidh-

⁴¹ Dr. Eqrem Çabej, vep. e cit. f. 134.

jet etnike dhe etike me fis, ndjenja e bashkëjetesës brenda një atdheu më të ngushtë na japin në literaturë edhe rrymën e regjionalizmit.⁴² Vetë ndarja që e propozon Çabej në vetëm tri qarqe kulturore (*Qarku katolik i Shqipërisë Veriore*, *Qarku italo-shqiptar* dhe *Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore*) është kundërgument i ndarjes kulturore të shqiptarëve mbi baza të fiseve, përkatësisht mbi baza të diferencimit fisnor të tyre. Kësaj i shtohen edhe pyetjet: a i përfshiu të gjithë shqiptarët organizimi fisnor?, kur dhe për cilën pjesë të shqiptarëve mund të flitet me argumente për këtë organizim?; dhe, së fundi, vetëm tri fise paskan pasur dikur shqiptarët? Kjo »dikur« mund të përcaktohet saktësisht, meqë dihet mirëfilli kur u bënë shpërnguljet e shqiptarëve për në Itali, dihet mirëfilli kur jetuan e vepruan Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi etj., ashtu siç dihet mirëfilli kur krijuan e vepruan Kavalioti, Todhri, Totasi, Vithkuqari etj.

Janë pikërisht rrethanat pushtuese që i detyruan shqiptarët »të zgjedhin« tokat e pabanueshme më parë të Kalabrisë e të Sicilisë, të nguliteshin në »male të zeza«, të mbesnin të izoluar aq sa të mos dinin me shëku për njëri-tjetrin, e jo »ndjenja e bashkëjetesës brenda një atdheu më të ngushtë«. Rrethanat pushtuese për shqiptarët nuk kishin filluar, e as përfunduar me invadimin e Turqisë në Shqipëri. Ato dhe kryesisht ato (rrethanat pushtuese) shkaktuan procese të dekulturnimit dhe të partikularizimit të shqiptarëve në njësi më të ngushta sociokulturore që lieshin në një kohë të gjatë nën presion të vazhdueshëm të ndikimeve kontraktore, të cilat patën për pasojë destabilizimin e sistemit kulturor të shqiptarëve dhe çorientimin e tij (t'i kujtojmë me këtë rast tri religjionet e shqiptarëve). Futja e dhunshme e elementeve dhe e karakteristikave kulturore më kontradiktore në kulturën shqiptare nuk përfundoi pa rezistencën e fortë të rrafshit popullor të integritetit sociokulturor të shqiptarëve dhe veprimin të fuqishëm të tij që një »material« i kundërtëhënshëm, një »lëndë« e deharmonizuar kulturore, të modifikohet në një harmoni të re, për ç'gjë dalin forma esencialisht të ndryshme kulturore nga ato që u janë detyruar nga forca e pushtuesit. Për ta ilustruar këtë konstatim, po ndalemi një grimë herë të krijimi i bajrageve ndër shqiptarët. Partikulariteti i shoqërisë shqiptare në fise nuk i mjaftonte sundimit otoman për të realizuar qëllimet e veta, aq më parë pse fiset, posaçërisht në viset malore u pavarësuan thuaja plotësisht nga ndikimi i pushtuesit. Organizimi fisëror dhe autoriteti i pakontestueshëm i krerëve të fisit ishte aty ku fisi shtrihej bren-

⁴² Po aty, f. 134.

da një territori kompakt. Mirëpo, siç dihet, shumë fise shqiptare nuk mbeten brenda territorit kompakt. Në një katund mund të kishte pjesëtarë të shtatë-tetë e më shumë fiseve, kështuqë ndikimi i institucionit të fisit në këto mjedise ishte shumë më i vogël. Kjo ishte një mundësi për pushtuesin për të nxitur e stimuluar rivalitetet midis fiseve pikërisht në ato mjedise ku atyre u mungonte territori i përbashkët, si dhe për të zbatuar një organizim të ri, që do të dobësonte ndikimin e institucionit të fisit në ato mjedise ku ai ishte brenda një territori kompakt. Krijohen *bajraquet* dhe një bajrak mund të përfshinte disa fise, ashtu sikundër brenda një fisi mund të kishte disa bajraqe. Vetë ky fakt tregon synimin për të shpërbërë organizimin shoqëror e kulturor të shqiptarëve, i cili i rezistonte aq shumë pushtuesit, sa që fare pak mund të depërtonte influenca e tij: »Turqit nuk ia arritën t'i pushtonin fiset malësore me forcën e armëve, prandaj ata gjatë shekullit XVII filluan t'i emëronin bajraktarët dhe t'i krijonin 'bajraquet në Malësi, me qëllim që ta dobësonin autoritetin e krerëve të fisit dhe fuqinë e tij. Bajraktarëve turqit u jepnin dhurata, rrogë e dekorata të ndryshme dhe këta e kishin për detyrë të merrnin pjesë me njerëzit e bajrakut në luftëra të ndryshme që i bënin turqit në Ballkan ose më larg«. ⁴³ Formimi i bajrakut me organet e tij: *bajraktarin*, *krenët* dhe *djemtë*, imponon një diferencim të ri të shqiptarëve ku zotëronte organizimi fisnor. Bajraku tashti bëhet autoritet më i lartë, të cilit »i përket prija e përgjegjësia e parë ndër punë të mbrendëshme e të jashtme të bajrakut në kohë lufte dhe paqje«. ⁴⁴ Megjithatë, ky diferencim i ri shoqëror, që kishte për qëllim të shpërbënte edhe më tepër shoqërinë shqiptare dhe të krijonte një mbështetje ushtarake për qëllimet dhe interesat e turqve, gradualisht vjen e i dorëzohet sistemit shoqëror e kulturor të shqiptarëve, për t'u kthyer kështu kundër themeluesit të tij: organeve të bajrakut vjen e i shtohet edhe një organ i veçantë — *djelmënia e fisit*, që kishte për detyrë »t'i ndalë sendergjimet e orvatjet e Turqisë për me i përça e me i prishë krenët e bajraktarët« dhe që »kishte për detyrë me zbatue pikërisht kanunin e mos me njoftë ndërhyrjen e autoritetit turk«. ⁴⁵ Me një fjalë, institucioni i bajrakut, i krijuar nga turqit, gradualisht i dorëzohet traditës së vendit, për t'u shndërruar në një institucion të atillë që nxjerr shpesh në log të kuvendit krerë e bajraktarë e burra armësh për të luftuar kun-

⁴³ Mark Krasniqi, *Lugu i Baranit*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1984, f. 45.

⁴⁴ Bernardin Palaj, *Organizimi i bajrakut*, Bota shqiptare, Tiranë, 1943, f. 328.

⁴⁵ Po aty.

dër pushtuesve osmanë. Prandaj, të kthehemi aty ku mbetëm: veprimi i rrafshit popullor të integritetit socio-kulturor ka arritur që të krijojë forma krejt të ndryshme me ato që janë imponuar nga pushtuesit. Kjo, jo vetëm që duhet të merret parasysh kur flitet për institucionet e veçanta që janë themeluar e stimuluar nga pushtuesit, e që gjatë kohës janë kthyer kundër tyre, pra, janë modifikuar në një harmoni të re, në një tërësi tjetër, por duhet të merret parasysh edhe kur flasim për të ashtuquajturat »shtresime« (greke, sllave, orientale etj.), si dhe kur flitet vetëm për katolicizmin, ortodoksizmin e muslimanizmin shqiptarë. Faktet e zhveshura, pa u parë rendi i tyre në një sistem të caktuar dhe marrëdhënia e tyre e ndërsjellë brenda atij sistemi, brenda asaj tërësie, nuk thonë shumë për kulturën. Ndarjet kulturore nuk mund të shpjegohen vetëm me faktin se *këtu* e ndeshim një vijë kulturore që *atje* mungon, ose vetëm me faktin se e njëjta vijë është *këtu* e *atje* në trajta të ndryshme, por ndarjet kulturore esencialisht janë vetëm atëherë kur si tërësi kulturore janë të orientuara në drejtime të ndryshme. E, tërësia nuk është vetëm grumbull elementesh, vijash, dukurish — pjesësh që e përbëjnë tërësinë, por rezultat i një renditjeje që e përcakton atë dhe i raportit të ndërsjellë midis atyre pjesëve. Ruth Benedikti këtë e konkretizon në këtë mënyrë: »Baroti nuk është vetëm shumë e squfurit e thëngjilldrurit e salnitrit dhe kurrfarë sasive njo-hurish, bile mbi që të trija këto pjesë përbërëse në të gjitha format e manifestimit të tyre në botën e natyrës, nuk e shpjegon natyrën e barotit. Mundësitë e reja u krijuan nga përzierja, asofarë mundësish që nuk ishin në pjesët përbërëse të saj; edhe mënyra e sjelljes së kësaj përzierjeje është e ndryshme në mënyrë të pakufizuar ndaj sjelljes së secilës pjesë përbërëse gjatë kombinimeve të tjera. Kulturat gjithashtu janë më tepër se shumë e karakteristikave të tyre.«⁴⁶

Në frymën e këtij mendimi do të mund të thuhej se nuk është thënë diçka me relevancë për kulturën shqiptare nëse konstatojmë se zakoni i nuses, ta zëmë, që posa ajo të hyjë në shtëpi të sillet tri herë rreth votrës, është marrë nga sllavët, apo nga lituanët, sepse për kulturën nuk është me rëndësi zakoni si i tillë, por vendi i tij (renditja e tij) në kuadër të tërësisë kulturore, si dhe marrëdhënia e ndërsjellë me pjesët e tjera të kësaj tërësie, për ç'gjë i njëjti zakon bëhet i ndryshëm në kultura të ndryshme. Pastaj, mund të dimë çdo gjë, fjala vjen, rreth shtrirjes së islamizmit ndër shqiptarët, mirëpo mund të nxjerrim konkludime shu-

⁴⁶ Ruth Benedikt, *Obrasci kulture*, Prosveta — Beograd, 1976, f. 74.

më të gabueshme për kulturën shqiptare si tërësi, përdërisa nuk e shohim vendin, veprimin e këtij elementi në raport me pjesët e tjera të tërësisë, përkatësisht funksionimin e tij në kuadër të tërësisë kulturore. Janë një mori procesesh të ndërveprimit kulturor si: *rezistenca kulturore, përpunimi kulturor, riinterpretimi kulturor, motivet kulturore* etj., që veprojnë në mënyrë të ndryshme e me intensitet të ndryshëm në kulturat e ndryshme dhe të cilat bëjnë që të mos ketë procese e dukuri krejtësisht të njëjta në kultura të ndryshme. Do të ishte punë që s'bëhet sikur të shihej njësoj, bie fjala, iluminizmi të francezët, të gjermanët dhe të shqiptarët. Fugia bartëse e një kulture, qëllimi seleksionues i saj — marrja e asaj që mund të shfrytëzohet dhe hedhja e tjetrës që e konsideron të padobishme; përshtatja e gjithë asaj që merret nevojave të veta — janë procese që i cilësojnë kulturat, procese këto që asnjëherë nuk mund të thuhet me siguri se janë të vetëdijshme, por që duhet t'i kemi gjithsesi parasysh nëse duam t'i interpretojmë me arsye dukuritë kulturore dhe kulturën përgjithësisht. Askush nuk mund të pohojë me arsye se proceset e interaksionit kulturor të shkaktuara nga kontakti i dhunshëm me kulturën turke të popujt e Ballkanit ishin procese të vetëdijshme, ashtu sikundër që nuk mund të pohohet me prezencë të mendjes se këto procese dhanë rezultate të njëjta në të gjitha kulturat e këtyre popujve. Nuk ka fije dyshimi se orientalizma shqiptare është e ndryshme nga orientalizma sorbe, bullgare, greke etj., pikërisht për shkak të proceseve të ndryshme të ndërveprimit kulturor, për shkak të vendit dhe të raportit reciprok të ndryshëm që kishte e huaja e dhunshme në tërësinë kulturore të secilit popull veç e veç.

Ndarja konfesionale e shqiptarëve në tri fe nuk arriti të krijonte edhe ndarjen kulturore mbi këto baza për shkak të funksionimit të njërive popullore integrative sociokulturore. Ritet popullore, bestytnitë, e gjithë ajo që me një fjalë quhet *magji* kishte ndikim shumë më të madh në jetën e shqiptarëve sesa tri religjionet e tyre së bashku. Kjo duhet të kërkohej në radhë të parë në faktin se orientimi kulturor i shqiptarëve ishte i atillë që shihte në të njëjtën perspektivë të ashtuquajturit *rend shoqëror* e *rend natyror*, pa e vënë një disting të qartë midis tyre. Njeriu dhe natyra ishin të lidhura ngushtë mes vete. Në këtë marrëdhënie besimet popullore ruanin supremacinë ndaj besimeve fetare, për shkak se të parat pranonin një qëndrim më aktiv të njeriut ndaj botës — nevojën dhe dobinë e individit dhe të grupit për veprimtari aktive, e që për instancë të fundit kishte përmbushjen e rendit natyror, ndërsa, të

dytat, krijonin raport më pasiv në këtë drejtim.⁴⁷ Ndarja konfesionale nuk shkaktoi ndarjen kulturore të shqiptarët edhe për shkak të autoritetit të pakontestueshëm të të parëve në jetën e tyre. Të parët, siç kemi thënë më herët, kishin primatin për të zgjedhur, për të vlerësuar, për të hedhur gjithë atë që nuk përkonte me shprehitë dhe me adetet e tyre. Ata u tregonin si të punohej toka, si të ruhej bagëtia, si të luftohej armiku etj., kështu që e kaluara ishte aq e tashme, saqë mungonte vetëdija për të, apo siç e thotë Mark Bllouh ndryshe: »... njerëzit të kaluarën dhe të tashmen i merrnin si gjendje që janë aq ngushtë të lidhura mes vete sa nuk ishin në gjendje të shihnin kontrastet midis tyre, bile as që ishin të vetëdijshëm për këtë nevojë«.⁴⁸

Është interesant të theksohet në këtë kontekst mënyra sesi rrëfejnë pleqtë e katundeve tona për ngjarje të ndryshme historike. Edhe kur është fjala për ngjarje të disa shekujve më parë, rrëfimi është aq »i konkretizuar« thuajse ngjarja po zhvillohet aty për aty. Një e kryer e shkuar që e nis rrëfimin shndërrohet shpejt në një të tashme që zotëron deri në përfundimin e tij. Lekë Dukagjini është i ulur në ballin e oxhakut të çergës së madhe, për anash dritares, në odën e rrëfyesit, kurse Mic Sokoli lufton nëpër arat dhe malet e fshatit të atij që rrëfen. Skënderbeu me trimat e tij është te Rrasat e Bardha e turqit në Ara të Çelës! Bile, ai duke i rënë rrëmishëm me shpatë një pashaje turk, ia paska pas hedhur kryet atij përmbi gardh kunorë të Colajve!

Siç është thënë, kulturat dhe shoqërit popullore kanë një vetëdije dhe koncept të ndryshëm për kohën. Koha, kohëzgjatja, njihen vetëm në sajë të funksionit që kanë për jetën dhe për veprimtaritë e njerëzve. Në kuadër të këtij konceptimi për kohën, nuk kishte »kohë të përgjithshme«; ajo ekzistonte si kohë e Motit të Madh, e Hyrjetit, e Serbisë së Parë..., apo koha e të zhdërgave, e shatit të parë, e lamave, e qengjave..., ose dhe koha pa le Cufa e pa dekë Mala. Ndikimi i besimeve popullore, autoriteti i fortë i së kaluarës, konceptimi i kohës si u përshkrua më sipër, si dhe arsyet që u thanë parandej, kushtëzuan mënyrë të menduarit, të cilën Levi—Strosi do ta quante »shkencë konkrete«, që merr për bazë kategorinë e »lidhjes së domosdoshme«, që manifestohet përmes »shqyrtimit të gjërave dhe personaliteteve si përfaqësues të tipit të dukurive të ngjashme që i kundërvihet tipit të dukurive të ndryshme«; ku

⁴⁷ Khs: Zigmunt Bauman, vep. e cit., ff. 293 — 297.

⁴⁸ Marc Bloch, *La société féodale*, t. I, f. 91. (Cit. sipas: Z. Bauman, vep. e cit., f. 297); Khs. edhe: Mark Blok, *Evropski feudalizam, në: Teorije o društvu, I*, Vuk Karadžić — Beograd, ff. 371 — 378.

mbizotëron »njohja kualitative« — »të vërejturit shqisor« të dallimeve dhe të ngjashmërive, për ndryshim nga »shqyrtimet abstrakte-kuantitative«. ⁴⁹

Brenda një kulture të këtillë, për mendimin tonë, ishte e pamundshme që religjioni të krijojë ndarje kulturore (*ndarje* në kuptimin e tërësisë kulturore të orientuar ndryshe nga tërësia tjetër kulturore). Megjithëkëtë, religjionet ndihmuan diferencimet vertikale të kulturës shqiptare si rrjedhojë e veprimit të faktorëve gjeografikë e historikë, por të theksohet edhe njëherë: diferencimet lokale të kulturës shqiptare nuk përkojnë me shtrirjen e religjioneve në këtë kulturë. Duam të themi se dallimet kulturore ishin më të dukshme midis, ta zëmë, një ortodoksi të Veriut dhe një ortodoksi të Jugut sesa dallimet kulturore midis pjesëtarëve të të tri religjioneve të Veriut, fjala vjen. Përkrye kësaj, duhet të kihet parasysh se »as mbrendapërmbrënda një zone të vetme situata nuk është unike. Në qytete dhe në fusha situata ndryshon nga ajo në male, por në Jug ky ndryshim konsiston kryesisht në intensitet dhe në sasi«. ⁵⁰

Pas kësaj që u tha, mund t'i kthehemi me pa ngurrim propozimit të Çabejt, që para tij na shfaqet edhe nga Maksimilian Lamerci. ⁵¹ Përkufizimet e Çabejt: *Qarku katolik i Shqipërisë Veriore* dhe *Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore* për ne do të ishin të qëndrueshëm pa atë *katolik* e atë *ortodoks*, nëse janë marrë parasysh diferencimet kulturore si prerje vertikale të kulturës shqiptare. Nëse sintagmat e mësipërme janë përdorur për të përkufizuar *vetëm* shkrimtarët shqiptarë të para shekullit XIX, atëherë (1) formulimi *qark kulturor* nuk qëndron për arsye se shkrimtari-prifti-hoxha-mësuesi-der-vishi... në kuadër të përkufizimit tonë të kulturës dhe duke marrë parasysh funksionin që kishin ata në kulturën shqiptare, nuk mund të ishin më shumë se *ndërmjetësues kulturorë*; si dhe (2) mbetën pa u përfshirë shkrimtarët e tipit Nezimi, Kamberi e të tjerë, që nji-

⁴⁹ Khs: Klod Levi — Stros, *Divlja misao*, Nolit — Beograd, 1966, kreu: *Nauka o konkretnom*, ff. 35 — 69.

⁵⁰ Rexhep Ismajli, *Gjuha shqipe e »Kuvendit të Arbërit«*, Disertacion i doktoratës, i mbrojtur në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Kosovës, në Prishtinë, më 1982, f. 74. (Shih nga ky autor, në të njëjtën vepër, arsyet pse dominoi alfabeti latin në shkrimet e shqipes; rivalitetet mënyrë e »angazhimit« për supremaci të tri feve të shqiptarëve, rrugët që hapën ato drejt asimilimit gjuhësor dhe etnik, posaçërisht ortodoksizmi, ff. 64 — 81.)

⁵¹ Siç na njohton vetë Çabej (Studime gjuhësore, V, Rilindja Prishtinë, 1975, ff. 180 — 185; Studime filologjike 1/1964) idenë për periodizimin e letërsisë shqipe në sajë të qarqeve kulturore e letrare e ka shfaqur para tij, më 1922, në veprën: *Midis Drinës e Vjosës*, botuar në gjuhën gjermane.

hen si *Bejtexhinjë* e që jetuan e vepruan nën influencën e fesë dhe të kulturës islame, kryesisht para shekullit XIX.

Një hartë e kulturës shqiptare, e ndarë në *zona kulturore*, në *subkultura* si diferencime vertikale, do të mund të bëhej mbi baza të diferencimeve gjuhësore, si rrjedhojë e veprimit të shumë faktorëve. Harta e kulturës shqiptare përgjithësisht do t'i përngjante hartës dialektologjike të gjuhës shqipe. Diferencimet gjuhësore për mendimin tonë janë udhërrëfyesit më të saktë për të ndjekur përgjithësisht diferencimet kulturore, që paraqiten në formë rrathësh që priten e që krijojnë *zona të ndërmjeme*, të cilat bashkojnë një zonë me tjetrën. Së këndejmi, pyetja: a është kultura shqiptare *një kulturë* e përbashkët për shqiptarët?, do të ishte e njëjtë me pyetjen: a është gjuha shqipe *një gjuhë* e përbashkët për shqiptarët?

Rëndësia e kulturës shqiptare, përkatësisht, kultura vetë, nuk shihet në mënyrë të plotë nëse arrijmë t'i shohim *vetëm* diferencimet lokale dhe ndryshimet e vazhdueshme të saj. Duhet të shihet, ç'është më kryesorja, edhe përpjekja e tyre që të derdhen në një tërësi. Rrafshi popullor i integritetit sociokulturor ishte për shumë kohë njësia ku derdheshin spontanisht ndryshueshmëti kulturore të shqiptarëve. Veprimi i kësaj njësie të integritetit sociokulturor ishte në atë shkallë saqë për një kohë të gjatë nuk lejoi shpëputje e distanca të mëdha midis të ashtuquajturave *kulturë gojore* dhe *kulturë e shkruar*. Brenda rrafshit popullor të integritetit sociokulturor u zhvillua e gjithë lufta për liri e pavarësi të shqiptarëve. Ky rrafsh zgjerohej e ngushtohej, ose, më saktë: bëhej herë latent e herë manifestiv, varësisht nga rrethanat shoqërore e historike.

Gani Bobi

LE NIVEAU POPULAIRE DE L'INTEGRATION SOCIOCULTURELLE DES ALBANAIS

Le niveau populaire de l'integration socioculturelle des Albanais est formé principalement sous l'influence des circonstances de la domination. Les mêmes circonstances ont influencées aussi la formation du type dominant socioculturelle des Albanais, caractérisé par une manière de vivre remplie de risques et de l'imprevu, par la rébellion contre les dirigeants et le contrôle collectif, par le défi envers toute sorte de pouvoir, interne ou externe.

L'analyse des formes et des unités populaire intégratives socioculturelle et des alternatives et des ambivalences envers les institutions sociales et culturelles des Albanais, aussi bien que des autres formes de la récupération de la vitalité authentique humaine freinée par ces institutions met en lumière une unité fonctionnelle qui les caractérise.

muhamedin
kullashi

HUMANIZMI EKZISTENCIALIST I SARTRIT

Tezën kryesore të mendimit filozofik në agun e kohës së re e artikulloi Dekarti si *Cogito ergo sum* (Mendoj, pra, jam). Kjo ishte një *pikëpamje* e re në të kuptuarit e njeriut dhe të botës: subjekti mendor u bë instanca kryesore që i prodhon mendimet e veta, ato nuk janë as dhuratë nga hyjnia (botëkuptimi fetar), e as nuk u paraprijnë akteve të tij të menduarit, nuk janë vetëm rikujtime (platonizmi) por janë prodhime. Mirëpo, siç konstatoi Hajdegeri, Dekarti dhe vijuesit e tjerë të filozofisë racionaliste e ndriçuan kryesisht »cogito«-n, strukturën e vetëdijes njohëse dhe raportin e saj ndaj objektit të njohjes. Ndërkaq, ajo »um« mbeti disi nën hije një kohë të gjatë. Shelingu, duke iu kundërvënë Hegelit — filozofia e të cilit shënon përkryerjen e mundësive kryesore të filozofisë së kohës së vet, *pikëmbërritjen* e saj — e bëri çështje pikërisht atë »aspekt« të njeriut që kishte mbetur i pandriçuar deri atëherë, e problematizoi atë »jam« të njeriut, mëvetësinë e ekzistencës së tij. Shelingu e kritikon pikëpamjen e Hegelit për ekzistencën si zhvillim i një embrioni në fillim i mbyllur në vete. Për të ekzistenca del, por jo në një mënyrë të natyrshme, si zhvillimi i embrionit, nga ajo »Grund« — baza e errët e çdo gjëje. »Grund« dhe ekzistenca nuk janë për Shelingun »dy momente të një zhvillimi të njëjtë«, meqë dallojnë dukshëm mes vete, dallojnë si *pesha* e *drita*.¹ Shelingu u ballafaqua dhe u orvat të gjente përgjigje në pyetjen më të thjeshtë

¹ Jean Beaufret: *Interduction aux philosophies de l'existence*, Denoel/Gonthier, Paris, fq. 106.

e njëherazi më të ndërlikuar: *si ndodh që diçka fare të jetë?* Kjo qasje e re e Shelingut do ta frymëzojë edhe Kjerkegorin në përpjekjet e tij që ta pushtojë një hapësirë të të menduarit që e bën çështje ekzistencën e njeriut, mëvetësinë e saj (vetëm njeriu *ekziston*, qeniet e tjera *janë*), në kundërshtim me sistemin filozofik grandioz të Hegelit ku kjo çështje sipas tij, u tret.

1. EKZISTENCIALIZMI. — Dihet se mendimi i Kjerkegorit ndikoi fuqimisht në filozofinë ekzistencialiste të shekullit XX, pra edhe në ekzistencializmin e Sartrit. Mirëpo, ndryshe nga Kjerkegori i cili i qaset drejtpërsëdrejti problematikës së ekzistencës duke iu shmangur qëllimisht problemeve ontologjike, Sartri arriti të çështja e ekzistencës tërthorazi — nëpërmjet ontologjisë fenomenologjike. Kategoritë themelore të kësaj »doktrine« — qeniesimi-në-vete (*l'être-en-soi*), qeniesimi-për-vete (*l'être-pour-soi*), hiçi (*le néant*) — Sartri i zhvilloi gjerësisht në veprën bazë të fazës ekzistencialiste të mendimit të tij, në *Qeniesimi dhe Hiçi* (1943). Ndërkaq, *Ekzistencializmi është humanizëm*, që doli katër vjet më vonë, shpesh u vlerësua thjesht si një tekst popullarizues ku në një trajtë të përshtatshme për një publik më të gjerë Sartri i paraqet disa nga tezat kryesore të ekzistencializmit të vet, që ishin elaboruar në mënyrë sistematike në *Qeniesimi e Hiçi*. Me këtë konstatim pajtohet disi edhe vetë Sartri mu në këtë tekst, ku thekson se ka pranuar ta vulgarizonte deridikund filozofinë e vet, por jo ta deformonte atë. Arsyetimin për këtë Sartri e gjen në qëndrimin se mendimi i tij mëton të jetë mendim i angazhuar, e së këndejmi, vulgarizimi ndonjëherë del si i paevitueshëm.

Megjithatë, mendimi që e përcakton në këtë mënyrë raportin midis këtyre dy veprave është *pjesërisht* i saktë. *Ekzistencializmi është humanizëm* nuk është vetëm paraqitje e popullarizuar e tezave të zhvilluara në *Qeniesimi dhe Hiçi*. Së pari, s'duhet të lihet anash intervalin kohor që i ndan këto dy vepra dhe gjithë atë që ndodhi në Evropë në vitet 1943 — 1947. Pastaj, s'duhet të harrohet fakti se mendimi i Sartrit në asnjë vepër të veçantë nuk e merr trajtën e një mendimi të përkryer e të përfunduar, mbasiqë ai përkah natyra e vet është vazhdimisht i hapur, çdoherë në formim e sipër, formim ky që nënkupton zgjerimin e thellimin por edhe ndryshimin. Po të merren parasysh këto dy momente, atëherë raporti midis këtyre dy veprave duket paksa ndryshe. S'ka dyshim se konceptet të cilat Sartri i skicon kalimthi në *Ekzistencializmi është humanizëm*, e kanë bazën e vet në *Qeniesimi dhe Hiçi* ku janë zhvilluar hollësisht. Mirëpo, në *Ekzistencializmi është humanizëm* ato i përshkon një frymë e re, aty thekson në një më-

nyrë të veçantë disa aspekte të tyre, hetohet një ndërrim i orientimit: shikimi i Sartrit është i kthyer më tepër kah *shoqëria* e *historia*, e nuk ndalet në rrafshin spekulativ ku zhvillohet dialektika e qeniesimit-në-vete me qeniesimin-për-vete. Ky ndërrim i orientimit merr trajtën e vet të qartë dhjetë vjetë më vonë në veprën *Çështjet e metodës* ku Sartri mëton ta gërshetojë ekzistencializmin e vet me mendimin e Marksit, duke u orvatur të gjente përgjigjet në pyetjet që i kishte shtruar vetes pas Luftës së Dytë Botërore.²

Ekzistencializmi është humanizëm mund të shikohet si një reagim i Sartrit ndaj disa prej shumë vërejtjeve e kritikave, që iu bënë nga pozita të ndryshme teorike e ideologjike, për »pesimizmin«, »defetizmin«, »subjektivizmin«, »idealizmin«, »karakterin abstrakt« të ekzistencializmit të tij. Duket se vet titulli i këtij libri është i formuluar si një përgjigje përmbledhëse ndaj vërejtjeve më të shpeshta. Zhan Bofre, njëri nga njohësit e mirë të ekzistencializmit, e sheh këtë tezë të formuluar në titullin e librit si një »lucus a non lucendo«: koncepti i *humanizmit* me të cilin Sartri do ta ndriçojë kuptimin e *ekzistencializmit* të tij është vetë edhe më i errët. Bofreja e sheh këtu çështjen nga perspektiva e filozofisë së Hajdegerit — veçanërisht nga kritika e tij e shtruar në *Letër mbi humanizmin* — ku vlerësohet se teza kryesore e ekzistencializmit të Sartrit (ekzistenca mbetet i paraprinë esencës) brenda horizontit të metafizikës. Hajdegeri është i preokupuar me problemin e daljes nga suazat e metafizikës për ta zhvilluar një mendim autentik që e ndriçon dhe e bën të mundur qeniesimin e vërtetë.

Të shohim megjithatë si e kupton vetë Sartri përmbysjen e raportit *ekzistencë-esencë* dhe si qëndron puna me konceptin e tij për humanizmin: është apo nuk është aq i errët si i duket Bofresë. Se ekzistenca i paraprin esencës për Sartrin do të thotë se njeriu së pari ekziston, shpërthen në botë e pastaj përkufizohet. Ndryshe nga qeniet e tjera, njeriu nuk e ka që më parë të përkufizuar qeniesimin e vet. Ekzistenca e tij është e hapur ndaj mundësive të shumta, të cilat individit vetë i zgjedh për ta përkufizuar veten. Ekzistenca e njeriut nuk është zhvillim i një embrioni ku do të ishin të paracaktuara veçoritë e atij zhvillimi (sikurse te fara e një bime: në saje të llojit të farës e dimë që më parë

² Shih: Zhan — Pol Sartri: *Çështjet e metodës*, Rilindja, Prishtinë, 1979, sidomos kaptinën e parë me titull »Marksizmi dhe ekzistencializmi«.

se çfarë bime do të fitojmë, trajtën e cilësitë e tjera). Mirëpo, njeriu nuk është as bimë, as kafshë, as gur, ai dallon nga të gjitha qeniet në saje të ekzistencës së vet.

2. *Natyra njerëzore dhe ekzistenca.* — Ky pikëshkrim i ri i raportit ekzistenca-esenca nënkupton për Sartrin flakjen e konceptit *natyrë njerëzore*. Sipas tij, mu ky koncept — qoftë në versionin e tij teologjik, qoftë në versionin e filozofisë materialiste të shekullit XVIII — implikon epërsinë e esencës ndaj ekzistencës, do të thotë një pikëpamje tradicionale të cilën Sartri dëshiron ta tejkalojë. Të supozosh një natyrë njerëzore për të do të thotë të supozosh se esenca e njeriut është e dhënë, i paraprinë ekzistencës së tij, e paracakton atë disi.

Flakja e konceptit »natyrë njerëzore« nuk na duket e arsyeshme. Koncepti »natyrë njerëzore« nuk e përjashton doemos tezën për ekzistencën si të hapur, të papërkufizuar që më parë; kjo mund të vlejë vetëm për ato koncepte që e shohin natyrën e njeriut si të caktuar, të pandrushueshme, të përkufizuar njëherë e përgjithmonë me disa konstanta etj. Por ka edhe koncepte të tjera, rrënjësisht të ndryshme, e madje jo vetëm bashkëkohore.³ Ta përmendim këtu megjithatë një koncept bashkëkohor të natyrës njerëzore, atë të Erih Fromit. Ky koncept i Fromit nuk pengon që ekzistenca njerëzore të shihet si e hapur, meqë për të natyra njerëzore nuk është as biologjikisht e fiksuar, as tërësi e lindur e shtypjeve, as rrjedhojë e thjeshtë e trajtave kulutrore, as e përhershme dhe e pandryshueshme, e as e ndryshueshme deri në pakufi: ajo është produkt i zhvillimit historik, sadoqë i ka edhe disa »veti« konstante.⁴

t'u mungojë baza e gjerë sociale, siç është sigurimi shëndetësor, pensional e invalidor etj. Familjet pa fëmijë dhe familjet me një gjeneratë janë konsideruar si të shkreta dhe pa perspektivë sociale pikërisht për shkak të mungesës së fuqisë punëtore dhe të ngushtimit të mundësive të ekzistencës. Nga këto arsye edhe shpjegohen normat dhe pikëpamjet mbi martesën, siç janë hyrja e hershme në të, universaliteti i saj, hyrja përsëri në martesë pas shkurorëzimeve etj. Shpenzimet e mbajtjes dhe të ngritjes së fëmijëve në popullatën shqiptare, sikundër edhe në çdo popullatë tjetër që ka ekzistuar në

Tabela 2.

Dallimet në shkallën e natalitetit të popullsisë së RPS të Shqipërisë, sipas rretheve (në promila, më 1960, 1969 dhe 1978)

Shkallët më të larta	Shkallët më të ulta	Dallimet midis shkallës maksimale dhe minimale	
1960			
1. Skrapari	55,0		
2. Tepelena	53,1	1. Tirana	32,9
3. Gramshi	51,3	2. Gjirokastra	36,7
4. Tropoja	49,4	3. Korça	40,3
5. Përmeti	48,0		
Të gjitha rrethet e tjera (18) kanë natalitet midis		41,4 dhe	47,7
promila.		(Shqipëria 43,3 promila)	
1969			
1. Mirdita	46,7	1. Gjirokastra	25,7
2. Kukësi	44,7	2. Kolonja	27,4
3. Tropoja	44,6	3. Tirana	28,3
4. Puka	44,2	4. Përmeti	28,3
5. Dibra	43,7	5. Korça	28,8
Të gjitha rrethet e tjera (16) kanë natalitet midis		31,2 dhe	41,0
promila.		(Shqipëria 35,5 promila)	
1978			
1. Puka	35,1	1. Gjirokastra	21,8
2. Kukësi	34,8	2. Tirana	21,9
3. Gramshi	34,7	3. Kolonja	22,0
4. Dibra	34,7	4. Korça	23,4
5. Librazhdi	34,4	5. Saranda	23,8
Të gjitha rrethet e tjera (16) kanë natalitet midis		25,3 dhe	31,8
promila.		Shqipëria 27,5 promila)	

Burimi: *Vjetari Statistikor i RPSH 1969 dhe 1970*, Drejtoria e statistikës, Tiranë, 1970; *35 vjet Shqipëri Socialiste, Të dhëna statistikore për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës*. Drejtoria e Statistikës, Tiranë 1979.

kushte të tilla të moszhvillimit, gjithmonë kanë qenë shumë modeste.¹⁵

Pas Luftës së Dytë Botërore, me zbërthimin gradual të strukturës homogjene socialo-ekonomike dhe kulturo-arsimore përmes rritjes së popullsisë urbane dhe zgjerimit të profesioneve joagrarë, zvogëlimit të alfabetizimit dhe rritjes së shtresave të arsimuara të popullsisë, përmirësimit të pozitës së gruas etj., edhe te popullata shqiptare shkalla e natalitetit nisi të binte dhe të diferencuhej në pikëpamje regjionale dhe sociale-klasore, por edhe të zbërtheheshin edhe veçoritë e tjera të dinamikës dhe të përbërjes demografike. Për këtë arsye, te popullata shqiptare, sikurse edhe te çdo popullatë tjetër në pikëpamje sociale dhe hapësinore heteronome, shkallët e lindshmërisë duhet të vështrohen të diferencuara sipas karakteristikave territoriale, sociale, profesionale dhe arsimore, nivelit të urbanizimit, karakteristikave të mobilitetit hapësinor dhe social, burimeve të të ardhurave të familjeve dhe veçanërisht pjesëmarrjes së femrës në jetën shoqërore-ekonomike. Atëherë do të shihet sesi nataliteti thyhet nëpër prizmen e stratifikimit shoqëror, ndërsa ndikimet e vlerave e të institucioneve tradicionale, të dokeve e të besimeve, për të cilat shpesh mendohet se kanë edhe origjinë etnike, janë vetëm të ndërmjetshme përmes shtresëzimit përkatës social dhe bazës materiale dhe superstrukturës shoqërore. Eksperiencia e popullatave, që e kanë kaluar transicionin demografik, tregon se *fillimi i rënies së natalitetit nuk paraqitet në tërësinë e popullatës, por në ato pjesë të saj në të cilat tashmë janë krijuar kushtet për ndryshimin e sjelljes riprodhuese.*

Rezultatet e regjistrimeve të popullsisë dhe analizat demografike përmes anketave,¹⁶ më së miri dëshmoj-

¹⁵ H. Islami, *Fshati i Kosovës. Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural*, Rilindja, Prishtinë 1985; H. Islami, «Problemi društvenog razvitka kosovskog sela *Sociologjia*, nr. 4, 1979, fq. 401; H. Islami, «Zakasnjela demografska tranzicija na Kosovu u okviru demografskog prelaznog razdoblja u Jugoslaviji i Evropi», *Sociologjia*, nr. 3, 1985, fq. 372 — 374.

¹⁶ Deri tash në Jugosllavi janë realizuar dy anketime mbi fertilitetin e popullsisë. Anketimin e parë e ka realizuar Qendra për Kërkime Demografike e Institutit të Shkencave Shoqërore të Beogradit më 1970, ndërsa të dytin Enti Federativ dhe entet republikane dhe krahinore të statistikës më 1976 në kuadër të «Anketës Botërore mbi Fertilitetin», me të cilin projekt ka udhëhequr Instituti Ndërkombëtar i Statistikës, me mjete të Fondit të OKB-së për aktivitete popullore. Duhet të përmendet edhe një anketë, të cilën, në kuadër të projektit «Pozita shoqërore e gruas në KSA të Kosovës», e ka realizuar Instituti i Filozofisë dhe i Sociologjisë i Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Anketa e fundit, ndonëse e kufizuar, rezultatet e saj janë identike me ato të dy anketave të përmendura kur është fjala për fertilitetin.

në për dallimet në nivelin e natalitetit e të fertilitetit midis pjesëtarëve të nacionalitetit dhe konfesionalitetit të njëjtë nëse jetojnë në terriore me shkallë të ndryshme të zhvillimit shoqëroro-ekonomik dhe kanë pozitë jo të njëjtë në shkallën socialo-profesionale dhe arsimore. Këto hulumtime në shembullin e të gjitha territoreve dhe nacionaliteteve në Jugosllavi tregojnë se femrat ekonomikisht aktive linden më pak fëmijë se femrat e mbajtura (Tabela 3, 5 dhe 7), se femrat e profesioneve agrare (edhe femrat aktive edhe ato të mbajtura) kanë fertilitet mesatarisht më të lartë se femrat e profesioneve jobujqësore (Tabela 3, 4 dhe 6) dhe se më shumë fëmijë linden femrat analfabete dhe ato pa përgatitje shkollë, ndërsa më pak femrat me nivel më të lartë të arimit (Tabela 7 dhe 8). Së këndejmi, *teza mbi determinimin etnik dhe religjioz të natalitetit, të cilën po e përkrahin disa me rastin e popullsisë shqiptare, nuk mund të qëndrojë nga analiza tanimë elementare e hapësirës jugosllave — bashkësisë shumënacionale: në Kosovë dhe në territoret e tjera më pak të zhvilluara të vendit shkallë më të lartë të natalitetit kanë pjesëtarët e të gjitha bashkësive kombëtare, si ata të cilët »amë« i kanë këto terriore, ashtu edhe ato nacionalitete të cilat në këto terriore jetojnë në numër më të madh, ndërsa »amët« i kanë jashtë këtyre territoreve (në republikat e zhvilluara), çfarë është rasti me serbët në BeH dhe në Kosovë,¹⁷ me kroatët gjithashtu në BeH dhe në Kosovë, pastaj me myslimanët në BeH dhe në rajonin e Sanxhakut, me malazeztë në Kosovë dhe në »amën« e tyre, në Mal të Zi. Ndonëse dukuria e natalitetit të ulët dhe gjithnjë të zvogëluar të shqiptarëve në Mal të Zi nuk është hulumtuar sa duhet, duke pasur parasysh faktin se territoret ku jetojnë shqiptarët në këtë republikë kanë nivel përafërsisht të njëjtë të zhvillimit shoqëroro-ekonomik sikurse edhe territoret e tjera të vendit që i banojnë ata, duhet theksuar se ky pro-*

¹⁷ »Niveli i fertilitetit të kombësisë serbe mjaft dallohet sipas republikave dhe krahinave. Ai është më i ulët në territorin e ngushtë të Serbisë, në Vojvodinë dhe në Kroaci, pra në terriore ku fertiliteti është i ulët. Shumë më i lartë është në Maqedoni dhe BeH, ndërsa edhe më i lartë në Kosovë dhe Metohi. Kjo pajtueshmëri me diferencimin regjional të fertilitetit të popullsisë së përgjithshme tregon se niveli i fertilitetit të popullsisë serbe sipas territoreve është në rradhë të parë nën ndikimin e dallimeve të cilat ekzistojnë midis tyre në zhvillimin industrial, në nivelin e urbanizimit, në strukturën arsimore të popullsisë, punësimit të femrës, mortalitetit të foshnjave dhe faktorëve të tjerë të cilët në masë më të madhe ndikojnë në shkallën e fertilitetit në një popullatë« (M. Rašević, *Determinante fertiliteta stanovništva u Jugoslaviji*, fq. 134).

ces është pasojë e shpërnguljeve të vazhdueshme të të rinjve dhe e ngulitjes së tyre në Kosovë dhe kohëve të fundit në botën e jashtme (SHBA etj.).

Fakti se shtresat dhe strukturat e caktuara shoqërore — fshatarësia, punëtorët, nëpunësit dhe inteligjencia kanë shkallë të ndryshme të natalitetit, tregon se *riprodhimi i popullsisë ka karakter klasor*, ku përkatësia kombëtare përputhet me ndikimin e përkatësisë sipas grupeve socialo-ekonomike, profesionale dhe shkallës së arsimit e të pavarësisë materiale të femrës,¹⁸ ndërsa përkatësia nacionale paraqitet vetëm si një veçori sociale dhe se *»dallimet në fertilitetin e popullsisë të nacionaliteteve të ndryshme në vendin tonë janë kryesisht të kushtëzuara nga faktorët socio-ekonomikë në tërësi, kurse në masë shumë të vogël edhe nga ato veçori të kombësisë, të cilat janë me këto inherente«*.¹⁹ Ky qëndrim edhe më parë është pranuar,²⁰ por edhe më vonë, në studimet demografike, shumë herë është vërtetuar.²¹ Të dhënat mbi lëvizjen dhe nivelin e natalitetit sipas republikave dhe krahinave qartë tregojnë »se ndikimi i faktorit etnik në fertilitet i nënshtrohet disa kushteve të mjedisit, çfarë është rasti edhe me kategoritë e tjera sociale dhe se përkatësia kombëtare në asnjë rast nuk ka rëndësi relevante në nivelin e pjellorisë. Dallimet e përmendura midis disa nacionaliteteve paraqiten, në të vërtetë, për shkak të nivelit jo të njëjtë të zhvillimit socio-ekonomik, kulturor, arsimor etj.«²² Por, edhe nëse mund

¹⁸ Për hulumtimet e hollësishme mbi determinantet e transicionit të shpejtuar demografik dhe lëvizjen e natalitetit sipas veçorive hapësinore, socialo-profesionale, arsimore, religjioze e tjera në BeH shih: Z. Grebo, *Çovjek, rađanje i društvo*, Svjetlost, Sarajevo 1975.

¹⁹ Grup autorësh, *Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd 1971, fq. 93 (nënvizoi H. I.).

²⁰ D. Breznik — M. Sentić, »Demografska ispitivanja i narodnost«, *Naše teme*, br. 8—9, Zagreb 1965, fq. 1385—1393; D. Breznik — M. Sentić, »Etničke, religiozne i rasne grupe«, *Stanovništvo*, nr. 3—4, 1968, fq. 145—154.

²¹ Grup autorësh, *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, CDI, IDN, Beograd 1978, fq. 148, 150; M. Sentić, »Uticaј narodnosti i religije na fertilitet stanovništva Jugoslavije«, *Stanovništvo*, nr. 3—4, 1971, fq. 293; M. Rašević, *Po aty*, fq. 130—138; S. Šuvar, *Nacionalno i nacionalističko*, Marksistički centar, Split 1974, fq. 323—328.

²² I. Ginić, »Sastav stanovništva Jugoslavije po nacionalnosti«, në studimin *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, fq. 69—97 (nënvizoi H. I.).

Duke përkrahur qëndrimin e njëjtë, Rašević thekson »se nacionaliteti paraqet vetëm një nga karakteristikat sociale, ndërsa dallimet në nivelin e fertilitetit midis grupeve kombëtare varen nga të gjithë faktorët e tjerë të cilët kushtëzojnë fertilitetin e popullsisë (M. Rašević, *Po aty*, fq. 132).

të thuhet se disa karakteristika, në masë të vogël apo të madhe, janë të lidhura me përkatësinë nacionale, si-kurse janë zakonet, qëndrimi ndaj fëmijëve dhe me ma-dhësinë e familjes, roli dhe vendi i femrës në familje dhe shoqëri, moshë e hyrjes në martesë, ndikimi i reli-gjionit, vlerësimi i situatave jetësore etj. ato janë, pa dyshim, shprehje e nivelit të zhvillimit shoqëroro-eko-nomik dhe të strukturave përkatëse socialo-ekonomike të popullsisë për një kohë të gjatë.²³ »Nataliteti në një pjesë të mirë varet nga mjedisi në të cilin jetojnë bash-këshortët, pra kryesisht nga kushtet ekonomiko-ociale. Kështu përqindja e grave të kombësisë serbe të cilat kanë lindur 6 e më tepër fëmijë në Kosovë është 19,6%, ndërsa në territorin e Vojvodinës gjithsej 1,4%. Te ma-lazeztë p.sh. përqindja e grave me 5 e më shumë fë-mijë në Kosovë është 13,4%, kurse gra me aq fëmijë në Vojvodinë, sipas anketës, nuk ka pasur».²⁴

Tabela 3

Numri mesatar i fëmijëve të lindur të gjallë të grave 15—49 vjet sipas aktivitetit dhe profesionit të mbajtësve të tyre (anketa, 1970)

Kosova	Aktive (gjithsej)	2,06	Të mbajtura (gjithsej)	4,17
	— bujqësoret	3,14	— bujqësoret	4,74
	— punëtorët	2,31	— punëtorët	3,89
	— nëpunësit	1,09	— nëpunëset	3,97
Vojvodina	Aktive (gjithsej)	1,71	Të mbajtura (gjithsej)	1,98
	— bujqësoret	1,93	— bujqësoret	2,27
	— punëtorët	1,77	— punëtorët	1,91
	— nëpunëset	1,27	— nëpunëset	1,72

Burimi: D. Gjoshij, »Fertilitetet, kontrola ragjanja i profesio-nalne karakteristike udatih zhen«, *Stanovništvo*, nr. 3—4, CDI, IDN, Beograd 1971, fq. 269.

²³ »Nuk janë këto veçori etnike të dhëna njëherë e për-gjithmonë, por janë fenomene shoqërore që kanë traditë she-kullore dhe në këtë kohëzgjatje historike marrin formën e li-gjësisve shoqërore deri në momentin derisa pikëpamja tradicio-nale nuk ndeshet me kushtet e ndryshuara materiale të jetës. Ndeshja e mënyrës tradicionale të jetës, e pikëpamjeve dhe e kushteve të ndryshme materiale është në vazhde, por ajo nuk i ka përfshirë me intensitet të njëjtë të gjitha regjionet, të gjitha grupet etnike, të gjitha brezet... Ky rreth magjik i mje-rimit dhe i mosdijes mund të thyhet vetëm nga jashtë, me ndryshimin e mënyrës së ekonomizimit (e cila do ta nxjerrë gruan nga mbyllja në rrethin e ngushtë të ekonomisë shtëpiake dhe do ta shndërronë në molekul të klasës punëtore) dhe me arsimin e detyrueshëm minimal tetëklasësh, që do të zbatohet« (K. Miljovski, »Bitnija demografske izmene i elementi popula-cione politike«, *Ekonomika misao*, nr. 3, Beograd 1974, fq. 46).

²⁴ M. Sentić, »Uticaj narodnosti i religije na fertilitet sta-novništva Jugoslavije«, *Stanovništvo*, nr. 3—4, 1971, fq. 282 (nënvizoi H. I.).

Tabela 4

Numri mesatar i fëmijëve të lindur të gjallë të grave të moshës 15 — 19 vjet sipas profesionit (regjistrimi, 1961; anketa, 1970)

		Bujqësoret	Punëtoret	Nëpunëset
Kosova	1961 (regjistrimi)	3,68	3,71	2,96
	1970 (anketa)	4,69	3,83	3,55
Vojvodina	1961 (regjistrimi)	2,32	1,98	1,47
	1970 (anketa)	2,07	1,88	1,44

Burimi: D. Gjoshijq, *Po aty*, fq. 270.

Tabela 5

Popullsia femërore (në vend) 15 e më tepër vjet sipas aktivitetit dhe numrit të fëmijëve të lindur të gjallë në Kosovë, regjistrimi i vitit 1981 (struktura në %)

	Gjithsej	Nuk ka lindur	1	2	3	4	5	6 e më tepër fëmijë
Aktive	100,0	42,6	11,7	20,7	11,2	5,3	2,8	5,1
E mbajtur	100,0	31,9	5,7	7,6	8,5	8,5	7,9	29,4

Burimi: Popis stanovništva, domaćinstva i stanova 1981, *Žene stare 15 i više godina prema vitalnim, etničkim, obrazovnim i ekonomskim obeležjima u SAP Kosovu*, Bilten 47, Pokrajinski zavod za statistiku, Priština 1984, fq. 56.

Tabela 6

Popullsia femërore (në vend) e moshës 15 e më tepër vjet sipas aktivitetit, pozitës socio-profesioniste dhe numrit të fëmijëve të lindur të gjallë në Kosovë (regjistrimi i vitit 1981)

	Bujq. individualë e të ngjashëm	Punëtore në industri, ndërtimtari, xehetari e të ngjashëm	Punëtore komunikacion, tregti, hotelieri e të ngjashëm	Punëtore në drejtorate, administratë, financa, vende udhëheqëse, ekspertë, artistë e të ngjashëm
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0
Nuk ka lindur	28,0	47,0	41,0	38,0
1	5,2	8,3	11,6	14,3

Aktivë që ushtrojnë profesion

2	12,0	11,6	21,1	21,2	29,6
3	14,1	9,6	12,6	14,0	12,8
4	12,3	9,0	5,9	8,2	3,3
5	8,6	4,5	2,7	5,4	0,9
6 e më tepër fëmijë	19,4	9,6	4,7	10,7	0,6

*Pozita socio-profesioniste e mbajtësit që ushtron
profesion në vend*

Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Nuk ka lindur	33,0	30,2	29,7	31,5	32,6
1	4,8	5,5	6,3	5,6	6,7
2	4,9	6,9	9,6	8,7	10,0
3	5,8	7,7	10,7	10,2	10,8
4	6,6	9,1	9,5	10,0	9,5
5	7,4	8,4	8,5	8,4	7,7
6 e më tepër fëmijë	36,8	31,7	25,5	24,9	22,1

Burimi: Po aty, fq. 56.

Tabela 7

*Numri i fëmijëve të lindur të gjallë të grave (kohorta 45 — 49
vjet) sipas përgatitjes shkollore (regjistrimi 1971)*

	Pa përgatit- je shkollore	Me 4 kl. të shkollës fi- llore	Me shkollë të plotë fillore	Me shkollë të mesme	Me fa- kultet
Kosova	6,4	5,1	3,0	1,9	1,2
Vojvodina	3,1	2,5	1,5	1,3	0,9

Burimi: D. Breznik, »Natalitet i fertilitet stanovnishtva Jugosla-
vije«, në librin *Fertilitet stanovništva i planiranje po-
rodice u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd 1980, fq. 90.

Tabela 8

*Popullsia femërore (në vend) e moshës 15 e më tepër vjet sipas
përgatitjes shkollore dhe numrit të fëmijëve të lindur të gjallë
në Kosovë, regjistrimi i vitit 1981 (struktura në %)*

	Analfabetë dhe pa përgatitje shkollore	Arsimi jo i plotë fillor	Arsimimi i plotë fillor	Arsimi i mesëm	Arsimi i lartë dhe superior
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Nuk ka lindur	14,8	22,2	52,8	56,6	35,3
1	3,8	6,4	7,8	12,1	15,1
2	4,7	10,0	10,4	18,2	30,5

3	6,5	12,4	9,3	8,2	12,7
4	8,2	12,2	6,9	2,5	3,3
5	9,5	10,6	4,6	0,9	1,0
6 e më tepër fëmijë	52,0	25,6	7,5	1,1	1,6

Burimi: Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 1981, *zhe-
ne stare 15 i više godina prema vitalnim, etničkim,
obrazovnim i ekonomskim obeležjima u SAP Kosovu*,
Bilten 47, Pokrajinski zavod za statistiku, Prishtina 1984,
fq. 14.

Dallimet e sotme në nivelin e fertilitetit, si dhe në të gjitha variablat e tjera të zhvillimit demografik në kuptim të ngushtë apo të gjerë midis nacionaliteteve do të zvogëlohen »në qoftë se bëhet deri te zvogëlimi i dallimeve të cilat midis tyre ekzistojnë në kushtet socio-ekonomike dhe në radhë të parë nëse zvogëlohen dallimet në strukturën ekonomike dhe arsimore, në statusin e femrës, në mobilitetin social etj.«.²⁵

Tabela 9

Shkalla e natalitetit të popullsisë së Kosovës sipas disa karakteristikave socio-ekonomike më 1953 dhe 1961 (në promila)

	Popullsia fshatare	Popullsia urbane	Popullsia bujqësore	Popullsia jobujqësore
1953	—	—	45,0	36,1
1961	40,8	40,1	44,9	37,2

Burimi: B. Maksimović, »Prelazak poloprivrednog stanovništva u nepoloprivredne delatnosti«, *Stanovništvo*, nr. 1, 1964, fq. 13; I. Ginić, »Demografski izvori i faktori urbanizacije u SR Srbiji«, *Stanovništvo*, nr. 2, 1966, fq. 124 (të dhënat për popullsinë fshatare dhe urbane kanë të bëjnë për vitin 1963).

Femra është akteri kryesor në procesin e përtëritjes njerëzore, ndërsa martesë dhe familja suazë theme-lore ku realizohet procesi i lindjes dhe amësia. Pozita socio-kulturore, punuese dhe profesioniste e femrës dhe dhe komponentja e qeverisjes së saj në familje dhe shoqëri përcakton edhe tipin e sjelljes riprodutive. Re-

²⁵ M. Rašević, *Po aty*, fq. 138 (nënvizoi H. I.); po kështu mendojnë Brezniku, Sentić, Miljovski etj. në punimet e përmendura dhe në punimet tjera.

zultatet e deritanishme të kërkimeve demografike dhe sociologjike në rrafshin teorik dhe empirik veçanërisht kanë treguar se punësimi dhe arsimi i femrës janë një ndër faktorët kryesorë të transformimit të jetës familjare dhe shoqërore, të institucioneve e normave sociale, edhe të rënies së fertilitetit.²⁶ Femra e punësuar dhe e arsimuar ka qëndrim krejtësisht tjetër ndaj orarit të kohës së vet, të cilit i kushton kujdes të veçantë; në këtë situatë ajo objektivisht nuk mund të preokupohet me funksionin e saj biologjik — me lindjen dhe ngritjen e fëmijëve, si funksion primar, por para së gjithash me funksionin e kohës së punës dhe të kohës së lirë, duke i theksuar natyrisht aspiratat dhe qëllimet e saja jashtë suazave familjare të jetës dhe bashkësisë lokale. Pikërisht këto motive, si dhe niveli më i lartë i arsimit edhe shpjegojnë nivelin e ulët të natalitetit dhe rënien e hershme të tij te femrat shqiptare të strukturave përkatëse edhe në Jugosllavi edhe në Shqipëri. Sado që femra e territoreve rurale të Shqipërisë në masë të mirë është e angazhuar në kuadër të kooperativave bujqësore, ajo e gjen angazhimin e saj jashtë shtëpisë, ekonomikisht pavarësohet dhe natyrisht përcaktohet për numër më të vogël të fëmijëve dhe familje më të vogël, duke praktikuar mjete »tradicionale« ose »moderne« kundër mbarësimeve të padëshiruara; kjo u dëshmuar edhe nga anketa (Tabela 3 dhe 5), ku femrat e mbajtura në bujqësi edhe në Kosovë edhe në Vojvodinë kanë më shumë fëmijë se femrat aktive në këtë degë. Këtë e vërtetojnë qartë edhe të dhënat se në vitin 1978 nga 26 rrethe në Shqipëri natalitet më të lartë prej 34,7 deri 35,1 promil kishin vetëm katër rrethe (Puka, Kukësi, Gramshi dhe Dibra) ndërsa në vitin 1979 nga 22 komuna të Kosovës (me më se 95% të banuara me shqiptarë) shkallë më të lartë të natalitetit midis 36,2 dhe 40,0 promila kishin katër komuna (Gllogovci, Rahoveci, Suhareka dhe Sërbica) dhe katër komuna të tjera kishin natalitet rreth 35,0 promila (Vuçiterna, Gjakova, Kaçaniku dhe Podujeva).

Në anën tjetër, *fshati i cili nuk e ka përjetuar të ashtuquajturën »thyerje« demografike dhe strukturën agrare të popullsisë së tij, gjithmonë kanë qenë dhe kanë mbetur forcë vitale e popullsisë dhe e shoqërisë dhe*

²⁶ Shih: O. Burić, *Promene u porodičnom životu pod uticajem ženine zaposlenosti*, Centar za proučavanje društvenih odnosa, Institut društvenih nauka, Beograd 1968; Z. Grebo, »Materinstvo i rad — stvarna ili prividna dilema u porodici zaposlene žene«, *Sociologija*, nr. 4, 1975; A. Pushka, »Uticaj zaposlenosti stanovništva na natalitet (primer sa Kosova)«, *Stanovništvo*, nr. 1 — 4, 1979 — 1981.

e kundërta, natyrisht; përjashtim në Jugosllavi paraqesin disa territore të pazhvilluara, fshatare dhe kryesisht agrare, siç janë Serbia Lindore dhe grupi i fshatrave të Sllavonisë dhe të Vojvodinës (e ashtuquajtura murtaja e bardhë ose sistemi i një fëmije).²⁷ Mirëpo, te shqiptarët fshati ende ka mbetur formë dominante e popullimit (më 1981 p.sh. 71,0% të shqiptarëve në Kosovë jetonin në fshat, më 1971 76,5% dhe më 1961 83,2%), pa çrregullime në strukturat bazë demografike (sipas moshës dhe gjinisë) dhe me emigrime jo aq të shprehur selektiv, ndërsa një numër i madh i funksioneve shoqëro-ekonomike të femrës ende janë të lidhura për suaza familjare të jetës dhe bashkësi rurale, pastaj stabiliteti relativisht i madh i martesave dhe i familjeve etj. — krejt këto janë parakushte për natalitet të lartë.²⁸ Te pjesa e zhvilluar e popullatës, te ajo urbane dhe joagrarë, numri i lindjeve është rregullisht më i vogël, sepse mbi bazën e shoqërorizimit të jetës e të punës, funksioneve të ndryshme të familjeve dhe daljes së gruas nga suazat e saja (punësimi, sigurimi social, ndryshimi i personalitetit, institucionet arsimore e të fëmijëve, mundësia e shfrytëzimit të kohës së lirë etj.), pastaj të rritjes së shpenzimeve rreth ngritjes dhe shkollimit të fëmijëve etj., janë krijuar pikëpamja dhe vlera të tjera; këtu shoqëria me mekanizmat dhe institucionet e saja është e orientuar drejt shkatërrimit të familjes, madje edhe drejt çrregullimeve serioze në marrëdhëniet

²⁷ Hulumtimet tregojnë se rënia e natalitetit në këto territore ka pasur para ndryshimeve shoqëro-ekonomike për shkak të ndikimit të faktorëve specifikë, por me përmbajtje ekonomike — që të mos shkaktohet ndarja e pasurisë me rritjen e numrit të pasardhësve (*Ferilitet stanovništva u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd 1971, fq. 356 — 357; *Ferilitet stanovništva i planiranje porodice u Jugoslaviji*, CID, IDN, Beograd 1980, fq. 66 — 67). Mirëpo, ka mendime se rënia e hershme e natalitetit në kushtet e moszhvillimit në Serbinë Lindore është e lidhur me zbatimin e gjerë të abortimeve nga personat joprofesionistë për shkak të frikës nga luesi, pra nga sifilisi (V. Mihailović, *Istorija polnih bolesti u Srbiji do 1912*; R. Njegić, »Pojava depopulacije u NR Srbiji«, *III. godišnji sastanak Jugoslovenskog statističkog društva*, Zagreb 1955; sipas M. Rašević, *Determinantne feriliteta stanovništva u Jugoslaviji*, fq. 59).

²⁸ Nga gjithsej 11.840 martesa legjitime te shqiptarët e Jugosllavisë në vitin 1970, u shënuan gjithsej 160 shkurorëzime (M. Sentić, »Nupcijalitet i divorcijalitet stanovništva različitih nacionalnosti«, në studimin *Demografska kretanja i karakteristika stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, fq. 51 — 56). Është e sigurt se numri i shkurorëzimeve është më i madh, mirëpo, për shkak të numrit të konsiderueshëm të martesave jo të kurorëzuara, shkurorëzimet mbesin të paevidentuara në shërbimet dhe në organet përkatëse. Por, është fakt se te kjo kombësi shkalla e divorcionalitetit është e vogël në raport me nacionalitetet e tjera.

e brendshme familjare, me ç'rast është e madhe norma e shkurorëzimeve (shpesh pa pasardhës) dhe celibati, pastaj drejt hyrjes së vonshme në martesë, ku shumë çiftë bashkëshortorë nuk dëshirojnë fëmijë ose vonë i nisin dhe herët i përfundojnë lindjet etj.²⁹

Ndër nacionalitetet në Jugosllavi, shqiptarët, romët, turqit, por edhe myslimanët kanë shkallë më të lartë të natalitetit (Tabela 1, 10 dhe 11). KSA e Kosovës (ku jetojnë rreth 74,0% të numrit të përgjithshëm të shqiptarëve të Jugollavisë) dhe vetë republikat si tërësi në të cilat shqiptarët jetojnë në numër të konsiderueshëm në pikëpamje shoqëro-ekonomike janë më pak të zhvilluara dhe zyrtarisht kanë status të territoreve të pazhvilluara (Maqedonia, Mali i Zi), mirëpo pjesët e republikave të cilat shqiptarët territorialisht kompakt i popullojnë janë edhe më pak të zhvilluara në të gjithë indikatorët (Maqedonia Perëndimore, pjesa jugore e Serbisë, juglindja e Malit të Zi); në hapësirat e pazhvilluara gati të gjitha nacionalitetet kanë shkallë më të lartë të natalitetit, gjë që qysh më herët na është bërë me dije në studimet demografike.³⁰ Moszhvillimi manifestohet përmes normës së ulët të punësimit në sektorin shoqëror të veprimtarisë dhe veçanërisht të popullatës femërore, përqindjes së lartë të popullsisë aktive e të mbajtur në bujqësi,³¹ të ardhurave të vogla për krye të banorit, përqindjes së lartë të analfabetëve në popullsinë e rritur, shkallës së lartë të mortalitetit të foshnjeve

²⁹ »Është shkaktuar rritja e patologjisë familjare në shumë drejtime: është rritur numri i martesave të shkurorëzuara (11% për Jugosllavinë, rreth 25% për Beogradin), është e madhe përqindja e familjeve të braktisura (e fshatarëve që vijnë në qytet, e punëtorëve që shkojnë në botën e jashtme etj.), është e lartë përqindja e familjeve jashtë martesave dhe e fëmijëve jashtë martesave (deri 9% në Jugosllavi, në Serbi me se 15% etj.), në rritje është numri i neurozave, sidomos te nënat dhe fëmijët, numri i fëmijëve të braktisur në pikëpamje edukative dhe i delikuentëve nga radha e të miturve gjithashtu nuk është i vogël etj. Veçanërisht vërehet rritja e ekonomive familjare vetjake (më se 15%), që tregon se shumë sish më nuk dëshirojnë të themelojnë familje, sepse frikësohen nga të gjitha vështirësitë që i sjell ajo, por edhe shumë çiftë bashkëshortorë nuk dëshirojnë fëmijë (22% të çiftëve bashkëshortorë pa fëmijë)« (M. Mladenović, *Porodica između usamljenosti i društvenosti*, Savremena administracija, Beograd 1976, fq. 10).

³⁰ *Demografski razvitak nacionalnosti u SR Srbiji*, CDI, IDN, Beograd 1967 (studim intern, 500 faqe); M. Rašević, *Po aty*, fq. 135 — 137; *Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd 1971, fq. 89 — 93, 147 — 155).

³¹ Në Kosovë p.sh. më 1961 përqindja e popullsisë bujqësore të shqiptarët ishte 75,8%, të serbët 56,1%, ndërsa të malazezët 37,0% (*Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji*, fq. 153), kurse më 1971 kjo përqindje ishte: të shqiptarët 56,7%, të serbët

etj.³² Të përmendim p.sh. vetëm numrin e të punësuarve për disa nacionalitete në Jugosllavi, si tregues shumë të rëndësishëm të nivelit të zhvillimit. Më 31. III. 1981 raporti i numrit të banorëve dhe i numrit të të punësuarve në punën e bashkuar ishte ky: malazeztë 579.043:171.915 (çdo i 3,3-ti i punësuar), maqedonët 1.341.598:391.013 (çdo 3,4-ti), serbët 8.140.507:2.222.338 (çdo i 3,6-ti), turqit 101.291:13.234 (çdo i 7,6-ti), romët 168.197:17.934 (çdo i 9,3-ti) shqiptarët 1.730.878:173.944 (çdo i 9,9-ti i punësuar).³³ Por edhe kur të vështrohet raporti i kontingjentit të popullsisë së periudhës së punës e të asaj të aftë për punë dhe i numrit të personave të punësuar, situata

Tabela 10

Numri mesatar i fëmijëve të lindur të gjallë sipas kombësisë së popullsisë femërore, sipas republikave dhe krahinave, sipas regjistrimit të vitit 1961 (kohorta 35 — 39 vjet)

Kombësia	B e H	Mali i Zi	Kroa- cia	Maqë- donia	Sillo- venia	Serbia pa kra- hina	Vojvo- dina	Koso- va
Serbe	3,5	2,2	2,4	2,9	1,8	2,3	2,3	4,2
Kroate	3,2	2,1	2,2	2,2	2,1	1,6	2,2	4,6
Silovene	1,8	2,0	1,7	(1,8)	2,1	1,5	1,8	(1,9)
Maqedone	(2,5)	(2,7)	2,1	3,7	(2,3)	2,3	3,3	3,0
Malazeze	2,5	3,5	2,1	2,6	(2,1)	2,1	2,7	3,9
Myslimane	4,9	5,4	(3,5)	4,7	...	5,2	(3,6)	4,7
Jug. e papërc.	4,0	(2,9)	2,1	(3,7)	(2,5)	2,9	2,0	4,9
Shqiptare	(3,6)	5,0	3,9	5,3	...	5,3	(4,5)	5,5
Turke	(3,7)	(6,7)	(4,8)	5,5	...	5,5	...	5,4

Vërejtje: Kllapat shënojnë numrin e banorëve të nacionaliteteve prej 11 deri 100, ndërsa shenja »...« shënon numrin e banorëve prej 1 deri 10, që do të thotë se statistikisht nuk është sinjifikant.

Burimi: M. Rasheviq, *Determinanta fertiliteti stanovništva u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd 1971, fq. 135.

43,5%, te malazeztë 18,4%, ndërkaq te shqiptarët në Maqedoni dhe në Mal të Zi ishte madje më se 59%, te maqedonët në Maqedoni 40,3%, te malazeztë në Mal të Zi 42,8% etj. (D. Došić, »Stanovništvo po nacionalnosti prema atktivnosti i zanimanju«, në studimin *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, fq. 131 — 139).

³² Më hollësisht në studimin: *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, CDI, IDN, 1978.

³³ Burimi: për numrin e banorëve: Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, Konačni rezultati, *Statistički bilten* 1295, SZS, Beograd, maj 1982; për numrin e të punësuarve: Savezni zavod za statistiku, *Saopštenje br. 449*, 19. oktobar, Beograd 1984.

gjithashtu nuk është aspak e kënaqshme. Para 15 e 20 vjet gjendja në sferën e punësimit në ekonominë shoqërore sipas kombësisë ka qenë edhe më e pavolitshme te shqiptarët, romët, turqit dhe myslimanët në disa terriore.

Tabela 11

Popullsia femërore (në vend) e moshës 15 e më tepër vjet sipas kombësisë dhe numrit të fëmijëve të lindur të gjallë në Kosovë (regjistrimi i vitit 1981)

	Kroate	Malazeze	Myslimane	Rome	Serbe	Shqiptare	Turke
Gjithsej	2.868	10.669	17.976	8.371	75.906	324.045	3.997
	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Nuk ka	833	3.861	5.483	2.406	23.094	108.237	1.403
lindur	30,0	36,1	30,5	28,7	30,4	33,4	35,1
1	198	946	1.290	743	6.099	19.360	280
	7,3	8,8	7,1	8,8	8,0	5,9	7,0
2	262	1.665	1.698	716	13.624	22.583	452
	9,7	15,6	9,4	8,5	17,9	6,9	11,3
3	247	1.342	1.839	688	10.854	24.546	438
	9,2	12,5	10,2	8,2	14,2	7,5	10,9
4	217	943	1.719	646	7.134	25.384	381
	8,0	8,8	9,5	7,7	9,3	7,8	9,5
5	155	626	1.477	649	5.063	24.541	301
	5,7	5,8	8,2	7,7	6,6	7,5	7,5
6 e më							
tepër	1.286	774	4.470	2.523	10.038	99.394	742
fëmi	28,4	6,0	25,9	29,9	12,9	30,4	18,3

Burimi: Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 1981, *Zemlje stare 15 i više godina prema vitalnim, etničkim, obrazovnim i ekonomskim obeležjima u SAP Kosovu*, Bilten 47, Pokrajinski zavod za statistiku, Prishtina, 1984, fq. 24.

Niveli i lartë i natalitetit dhe gjendja e pavolitshme e strukturave demografike përpara dhe sot në Kosovë dhe veçanërisht te popullata e saj shqiptare, rome, myslimane dhe turke mund të shpjegohet me faktin se *kjo Krahinë jo vetëm që hyri vonë në rrjedhat e industrializimit dhe të urbanizimit të jetës, por edhe pse struktura e ekonomisë së saj ishte dhe mbeti mjaft e njëanshme: industria ekstraktive në bazë të plumbit dhe zinkut dhe energjetika në bazë të thëngjillit gëlltitën dhe ende*

gëlltisin pjesën më të madhe të investimeve.³⁴ Mirëpo, edhe zhvillimi ekonomik i mëvonshëm, pak më i shpejtuar nuk ka mundur të ketë ndikim të madh në transformimin e lëvizjes së popullsisë dhe të strukturës së saj ekonomike, meqenëse pjesa më e madhe e investimeve ende kufizoheshin në industri ekstraktive dhe energjetikë, të cilat, siç dihet, kanë efekte të vogla në akumulim, të ardhura dhe punësim, për çka janë grumbulluar tepricat e fuqisë punëtore në bujqësi dhe janë ashpërsuar problemet socialo-ekonomike në fshat;³⁵ duhet të theksohet edhe fakti se në përcaktimet e tilla investuese në masë të mirë ka qenë i përfaqësuar edhe interesi i tërë vendit.³⁶ Kjo industri ka punësuar kryesisht fuqinë punëtore mashkullore, ndërsa kapacitetet e pamjaftueshme të industrisë përpunuese në mënyrë të pavolitshme janë manifestuar në punësimin e fuqisë së re punëtore të gjinisë femërore. Ndryshimet që pasuan në zhvillimin shoqëroro-ekonomike nga fundi i viteve të 60-ta dhe gjatë viteve të 70-ta nuk i përfshinë sa duhet ato shtresa dhe grupe sociale të cilat edhe janë bartëse kryesore të natalitetit të lartë, e kjo është popullata rurale (rreth 70%), sidomos pjesa e saj femërore e kombësisë shqiptare. Në Kosovë dhe viset e tjera që janë të banuara me popullsi shqiptare në Jugosllavi shumë kohë dominon forma e imët e popullimit, deri vonë edhe autarkia e theksuar ekonomike dhe demografike, mobiliteti i ulët hapësinor dhe social i femrës, mungesa e sistemeve themelore infrastrukturale (elektrifikimi, rrugët), të institucioneve të standarit jetësor dhe shoqëror (shkollat, ambulancat, shtëpitë e kulturës, bibliotekat, postat etj.), pastaj mbrojtja shëndetësore etj., ndërsa ende në fshatin kosovar nuk janë zgjidhur problemet e sigurisë sociale të bujqve: sigurimi pensional dhe invalidor dhe

³⁴ M. Limani, *Investicije i privredni razvoj Socijalističke Autonome Pokrajine Kosova*, Priština 1980; N. Bashota, »Ekonomia e KSA të Kosovës dhe transformimi i saj në shoqërinë socialiste«, *Përparimi*, nr. 6, Prishtinë 1984, fq. 807—854.

³⁵ H. Islami, »Poljoprivredno stanovništvo Kosova«, *Sociologija sela*, nr. 55—56, Zagreb 1977, fq. 37—47.

³⁶ Shih më hollësisht: Xh. Bakraçi, »Pozita e KSA të Kosovës si faktor i diferencimeve interregjonale«, *Economia*, nr. 2, Enti për Kërkime ekonomike, Prishtinë 1973, fq. 157—159; *Aktuelni problemi proizvodne strukture SAP Kosova*, Ekonomski institut, Beograd 1970, fq. 42 e tutje; N. Bashota, Po aty, fq. 822 e tutje; N. Bashota, »Uvodna razmatranja o strukturnoj orijentaciji i ubrzanom razvoju nerazvijenih«, *Časopis za kritiko znanosti*, nr. 51—52, Ljubljana 1982, fq. 41.

nuk janë evidentuar problemet e analfabetizmit real (në 1981 më se një e treta e popullsisë së rritur nuk ka ditur shkrim-lexim, ndërsa më 1971 më se gjysma).³⁷

Përqindja e femrave ekonomikisht aktive të kombësisë shqiptare është shumë e ulët, që e bën atë ekonomikisht të varur dhe, u mor vesh, në kushtet e tjera të pavolitshme, më tepër të preokupuar me funksionin riprodhues. Në Kosovë, ta zëmë, më 1981 në fshat vetëm rreth 4,0% të femrave ishin aktive (në qytet 14,7%), ndërsa vetëm çdo e njëzeta femër ishte e punësuar në sektorin shoqëror dhe vetëm pak më pak se gjysmën e numrit të gjithmbarshëm i femrave të punësuar e përbëjnë femrat shqiptare; kjo gjendje dhe këto raporte para 10 e 15 vjet ishin edhe më të pavolitshëm³⁸. Punësimi edhe ashtu modest i femrave të punësuar në sektorin shoqëror, sidomos të atyre shqiptare, është i përqëndruar në qytete, kurse femra fshatare është krejt e lënë pas dore në këtë proces.³⁹ Pikërisht për këto arsye, një numër i madh i funksioneve shoqëro-ekonomike të femrës nuk ka mundur të dalë nga suazat familjare, oborri ekonomik dhe bashkësia fshatare në përgjithësi; gruaja ka mbetur ende e lidhur për punët e shtëpisë dhe me riprodhimin biologjik, ndërsa nevoja për ndryshimin e sjelljes riprodhuese, racionalizimin e saj dhe kalimin nga fertiliteti »i pakontrolluar« në fertilitet »të kontrolluar«, si dhe për humanizimin e raporteve midis gjinive, kërkon ndryshimin rrënjësor të pozitës së gjithmbarshme të femrës në familje dhe shoqëri dhe shoqërizimin e jetës e të punës së familjes. Të gjithë indikatorët socio-ekonomikë dëshmojnë se lidhja midis funksionit ekonomik të familjes dhe funksionit të saj reprodutiv është shumë e ngushtë. Prandaj, *roli i femrës kosovare dhe i asaj shqiptare dhe i familjes së tyre në*

³⁷ Më gjerë në: H. Islami, »Socijalno-demografske promene u kosovskom selu«, në librin *Problemi socijalističkog razvoja poljoprivrede i sela*, Izd. Centar Komunist dhe Jugoslovenski centar za teoriju i praksu samoupravljanja »E. Kardelj«, Beograd — Ljubljana, 1983, fq. 641 — 657; H. Islami, »Kretanje nepismenosti u Albanaca u Jugoslaviji«, *Sociologija*, nr. 2 — 3, Beograd 1978, fq. 313 — 322; H. Islami, »Nepismenost u današnjem kosovskom selu«, *Sociologija sela*, nr. 77 — 78, Zagreb 1982, fq. 219 — 232.

³⁸ Në vitin 1961 p.sh. përqindja e femrave në grupin e punëtorëve dhe nëpunësve në Kosovë sipas kombësisë dukej kështu: te shqiptarët 5,3%, te serbët 19,5% dhe te malazezët 27,5%, ndërsa në Maqedoni: te shqiptarët 4,7% dhe te maqedonët 15,7% (*Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd 1971, fq. 153).

³⁹ Përveç disa objekteve të ekonomisë së vogël në 2 — 3 fshatra, vetëm në vitin 1985 u ngritën disa kapacitete industriale në fshatrat Junik dhe Letnicë, ku ka mundur të punësohet edhe një numër i caktuar i femrave.

procesin e përtëritjes biosociale objektivisht nuk ka mundur të ndryshohej shumë, ashtu siç është ndryshuar në territoret e zhvilluara të vendit dhe, më shumë, në vendet e zhvilluara të Evropës. Megjithatë, hulumtimet anketuese tregojnë se edhe femrat e territoreve me fertilitet të lartë në Jugosllavi, krahas depërtimit të ndryshimeve shoqëro-ekonomike dhe të krijimit të pikëpamjeve mbi këtë bazë, formojnë qëndrime mbi madhësinë e vogël »ideale« të familjel.⁴⁰

IV

Pikëpamjet pesimiste të Tomas R. Maltusit (1766—1834), priftit dhe ekonomistit anglez, sa i përket zhvillimit të popullsisë dhe të të mirave jetësore në të ardhshmen u paraqitën në truallin evropian në kohën kur revolucioni industrial, tekniko-shkencor, mjekësor, i komunikacionit hapën perspektiva të gjera për zhvillimin e njerëzimit. Maltusi, duke konsideruar lindjen si madhësi të pandryshuar në hapësirë dhe kohë, e cila, sipas tij, nuk varet nga ndryshimi i kushteve shoqëro-historike dhe i institucioneve, doli me tezën mbi ligjin »konstant natyror« të popullsisë, e cila nuk ka mbështetje shkencore dhe humanitare, e as masat që i preferonte ai dhe ithtarët e tij të mëvonshëm në favor të kufizimit të rritjes së popullsisë për arsye gjëja të kufizimit të mjeteve për ekzistencë dhe të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror; parimeve të Maltusit e të maltuzianëve mbi popullsinë rreptësisht iu kundërvunë Marksi dhe Engelsi dhe tërë doktrina marksiste. Pas Maltusit dhe tezës së tij, paraqitet doktrina tjetër anti-shkencore, antihumane dhe dogmatike, *neomaltuzianizmi*, madje në formë të *neomaltuzianizmit të hershëm*, që nga vdekja e Maltusit dhe zgjat deri në Luftën e Dytë Botërore, dhe në formë të *neomaltuzianizmit modern*, i cili del në skenë pas kësaj lufte. Doktrina neomaltuzianiste është identike me teorinë maltuziane, ku, për të aritur deri te qëllimi, dallimet janë vetëm në mjetet dhe masat konkretisht të ndërmarra.⁴¹ Është interesant se idetë neomaltuzianiste paraqiten në kohën e perspek-

⁴⁰ Shih: G. Todorović, »Idealni i željeni broj dece u porodici«, *Stanovništvo*, nr. 3—4, 1971, fq. 297—311; G. Todorović, »Idealna veličina porodice na selu i u gradu«, në librin *Izgradnja društvenih stavova o populacionoj politici u Jugoslaviji*, Savezna konferencija SSRNJ dhe Savet za planiranje porodice u Jugoslaviji, Beograd 1975, fq. 286—294.

⁴¹ Më hollësisht për këtë shih: A. W. — Baletić, *Demografija. Stanovništvo i ekonomski razvitak*, Školska knjiga, Zagreb 1982, fq. 43—69; shih gjithashtu: Z. Pjanić, *Problem stanovništva u ekonomskoj teoriji*, Nolit, Beograd 1957.

tivës së qartë optimiste të njerëzimit, meqenëse revolucioni industrial krijoi mundësi të mëdha për zhvillimin e popullsisë (rritja e sasisë së ushqimit dhe përmirësimi i përbërjes së saj në bazë të rritjes së rendimenteve të prodhimitarisë bujqësore me zbatimin e proceseve inovative në sferën e mekanizimit dhe të kulturave agrare). Dhe derisa kërkesat maltuziane ishin që lindjet dhe numri i popullsisë të zvogëlohen me apstenim moral dhe ngurrim seksual, me shtyrjen e martesave dhe me celibat si pengesa preventive, në një anë, dhe me epidemi, uri dhe luftëra si pengesa pozitive, në anën tjetër — ndërkaq, botëkuptimet neomaltuziane insistojnë që problemet ekzistuese socialo-ekonomike të zgjidhen me kufizimin e lindjeve dhe pengimin e rritjes së numrit të popullsisë, duke zbatuar mjete dhe metoda »artificiale« — kontracepcionin, abortimet, madje edhe sterilizimin.⁴²

Në fillim të viteve të 80-ta të këtij shekulli, me rastin e nivelit të shkallës së natalitetit dhe të rritjes së numrit të popullsisë së Kosovës⁴³ dhe të popullsisë shqiptare në Jugosllavi,⁴⁴ paraqiten edhe disa teza të përshkruara nga fryma neomaltuziane. *Autorët e këtyre tezave insistojnë në planifikimin e familjes dhe në kufizimin e mbarësimeve e të lindjeve me qëllim që të zvogëlohet rritja e popullsisë, e cila, sipas tyre, paraqitet si pengesë në zhvillimin shoqëroro-ekonomik; natalitetin e lartë ata e lidhin me komponentën etnike dhe modelet e trashëgimisë e të kulturës tradicionale, duke i vënë kështu në rend të parë ndikimin e institucioneve të veçanta etno-vlerore, të elementeve specifike të vetëdijës, madje edhe të interesave dhe të ideologjisë specifike, ndërsa ndikimin e faktorëve shoqërorë dhe ekonomikë e minimizojnë ose e vënë në dyshim. Mirëpo, këtyre botëkuptimeve i kundërvihen rreptësisht doktrina marksiste, shkenca marksiste demografike dhe tërë qasja jugosllave*

⁴² UN: *Višejezički demografski rečnik* (srpskohrvatska verzija), Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd 1971, pika 906; shih edhe në: R. Pressat, *Dictionnaire de démographie*, Presses universitaires de France, Paris 1979, fq. 138 — 139.

⁴³ Mbi tempon e rritjes demografike në Kosovë shih: H. Islami, »La croissance démographique du Kosovo«, *Population*, No 4 — 5, Institut national d'études démographiques, Paris 1979, fq. 915 — 919; H. Islami, »Le développement démographique du Kosovo (Yougoslavie)«, *Revue géographique de l'Est*, No 1 — 2 (Numéro spécial), Nancy 1979, fq. 78 — 100.

⁴⁴ Shih për këtë: H. Islami, »La population albanaise de Yougoslavie: accroissement numérique et répartition spatiale, *Population*, No 1, Institut national démographiques, Paris, 1983, fq. 166 — 173.

e planifikimit të familjes dhe e »kontrollit« të lindjes.⁴⁵ Koncepti jugosllav, planifikimin e familjes e vë në kontekst të zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëro-ekonomik, duke i respektuar mbi të gjitha porositë humanitare dhe të drejtat e njerëzve që lirisht të vendosin për numrin e fëmijëve dhe intervalin kohor midis lindjeve.⁴⁶ Kushtetuta e RSFJ-së dhe kushtetutat e RS-ve dhe KSA-ve të vitit 1974, si dhe të gjitha kushtetutat progresive në botë, ia pranojnë këtë të drejtë njeriut dhe e theksojnë karakterin decentralizues të përtëritjes njerëzore; me këtë flaket ndikimi i drejtpërdrejtë i shoqërisë në lindje dhe procesi i riprodhimit biologjik bëhet karakteristikë e shoqërisë socialiste të tipit vetëqeverisës. Duke pasur parasysh faktin se faktori personal luan rol gjithnjë më të rëndësishëm sa i përket mbarsimit, numrit të lindjeve dhe intervalit suksesiv midis tyre dhe madhësisë së familjes, neni 191 i Kushtetutës së RSFJ-së thotë: »Është e drejtë e njeriut që lirisht të vendosë për lindjen e fëmijëve. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm për shkak të mbrojtjes së shëndetit«.

Në vitin e 60-ta në botë u proklamua dhe fuqimisht u afirmua parimi mbi të drejtën e njeriut që lirisht të vendosë për pasardhësit e tij, parim ky që, përveç të drejtave të njeriut për jetë dhe liri, hyn në radhën e të drejtave më elementare njerëzore; këto parime u inkuadruan në të gjitha deklaratat dhe proklamatat

⁴⁵ »Duhet, para së gjithash, të theksohet se koncepti ynë i planifikimit të familjes është në kundërshtim të rreptë me botëkuptimin dhe qasjen neomaltuziane, sipas së cilës ajo kuptohet si kufizim i lindjeve me qëllim që të zvogëlohet rritja e popullsisë (sidomos në vendet në zhvillim), përkatësisht, me fjalë të tjera, si »ilaç« për zgjidhjen e të gjitha problemeve ekonomike dhe sociale. Ngëcja në zhvillimin e shumë vendeve në botë, zhvillimi jo i shpejtë aktual, ndërkaq në instancë të fundit edhe »eksplozioni demografik« i kanë rrënjët e tyre në sundimin kolonial për një kohë të gjatë, në marrëdhëniet jo të drejta ekonomike ndërkombëtare, në çmimet e ulëta të atyre prodhimeve që i kanë vendet më pak të zhvilluara. Zvogëlimi i rritjes së popullsisë nuk i zgjidh problemet e përmendura vetvetiu, por është i domosdoshëm zhvillimi sa më i shpejtë i vendeve më pak të zhvilluara dhe vetëm në kushte të tilla mund të pritet se do të zgjidhen edhe problemet demografike« (D. Breznik, »Demografska kretanja u SR Srbiji i mere za rešavanje problema«, *Stanovništvo*, nr. 3—4. 1975 dhe 1—2, 1976, fq. 28—29 (nëvizoi H. I.) (studimi është hartuar për nevojat e Entit të Planifikimit Shoqëror të RS të Serbisë).

⁴⁶ *Rezolucija o planiranju porodice*, Savezna skupština, Beograd, 25. aprila 1969 (Ac nr. 1185). Rezoluta nuk është proklamuar për qëllime demografike, por për shkaqe humanitare me synim që të përmirësohet pozita dhe shëndeti i femrës, si dhe pozita e brezeve të ardhshëm. Alineja e parë e Rezolutës thotë: »Realizimi i mundësive të prindërve që vetë të përcaktojnë numrin e fëmijëve dhe intervalin midis lindjeve është një ndër të drejtat dhe obligimet elementare njerëzore«.

ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Në bazë të të ashtuquajturës proklamatë e shefave të shteteve, që e nënshkruan edhe shumë burra të shteteve, ndër të cilët edhe kryetari Tito, në vitin 1966 sekretari i përgjithshëm i OKB U Tante proklamoi të drejtën e njeriut që lirisht të vendosë për lindjen e fëmijëve dhe intervalin midis lindjeve si një nga të drejtat elementare njerëzore.⁴⁷ Kjo e drejtë më vonë do të hyjë në *Rezolutën mbi të Drejtat e Njeriut* në Teheran në vitin 1968, si dhe në kushetuta të shumë vendeve të botës.

Jugosllavia si vend socialist dhe vetëqeverisës deri në vitin 1967 nuk ka pranuar të bëhet anëtare e Federatës Ndërkombëtare për Planifikimin e Familjes, derisa në Statutin e saj, me kërkesat e pjesës progresive të botës, nuk janë ndryshuar nenet me përmbajtje kryesisht neomaltuziane, edhe pse iniciativa për anëtarësimin e saj në këtë asociacion ishte dhënë qysh në vitin 1957; vetëm pas ndryshimeve të bëra në këto nene, Pleqësia Federative e Planifikimit të Familjes të Jugosllavisë bëhet anëtare e organizatës së përmendur.⁴⁸

Gjatë viteve të 60-ta dhe të 70-ta të shekullit XX në shumë tubime shkencore, kongrese dhe konferenca mbi popullsinë me karakter ndërkombëtar, janë shtruar edhe çështjet e natalitetit e të fertilitetit të lartë dhe të ulët, përkatësisht të rritjes së lartë dhe të ulët të popullsisë dhe u paraqitën qëndrime të ndryshme mbi rrugët e zgjidhjes së tyre. »Sipas qëndrimeve më shpesh të përfaqësuara, rritja e shpejtë e popullsisë është e lidhur ngushtë me zhvillimin shoqëror dhe ekonomik dhe rritje mesatare të popullsisë është e mundur të arrihet vetëm me intensifikimin e zhvillimit, të rritjes së arsimit, me nivelin e lartë të standardit jetësor, me ndryshimet e shpejta shoqërore, me marrëdhëniet e drejta ekonomike në botë, me raportet e barabarata në familje etj. Zgjidhja e problemit të popullsisë është e mundshme vetëm në kuadër të zhvillimit shoqëro-ekonomik dhe se asfarë zgjedhjeje e pavarur e tij, p.sh. e ashtuquajtura »zgjidhja demografike«, nuk do të sjellë rezultate të dëshiruara.«⁴⁹

Pikëpamja se proceset dhe ndryshimet demografike janë fuqimisht të kushtëzuara nga zhvillimi shoqëro-ekonomik, i cili i ndryshon edhe të gjitha determinantet e tjera të sjelljes në riprodhim, e hasim edhe në *Planin Botëror të Aksionit* në fushën e popullsisë si dokument

⁴⁷ Sipas: N. Petrić, *Pravo čoveka da slobodno odlučuje o rađanju dece u SFRJ* (Povodom međunarodne godine žena — OUN, 1975), Beograd 1976, fq. 27.

⁴⁸ N. Petrić, *Po aty*, fq. 23, 61.

⁴⁹ Grup autorësh, *Fertilitet stanovništva i planiranje porođice u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd 1980, fq. 8.

themelor të Konferencës III mbi Popullsinë (Bukuresht, 1974). Edhe pse në këtë Konferencë u paraqitën mospajtime të ndryshme, në Planin e Aksionit politika populllative u shtrua vetëm në kontekst të politikës së zhvillimit shoqëroro-ekonomik, duke i respektuar efektet indirekte të ndikimit të këtij zhvillimi në procesin e përtëritjes së popullsisë dhe duke pasur parasysh konsideratat humane në kuadër të humanizimit të raporteve midis gjinive dhe të raporteve të përgjithshme njerëzore. Si faktorë vendimtarë në zvogëlimin e fertilitetit, në dokumentin e përmendur shtrohet çështja e emancipimit social, ngritja e standardit jetësor dhe shoqëror të popullsisë, mbrojtja e nënave dhe e fëmijëve, zvogëlimi i mortalitetit dhe sidomos i mortalitetit të foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël, zgjerimi i kushteve urbane të jetës në rajonet fshatare etj. Plani Botëror i Aksionit edhe pse sugjeron se politika populllative është e drejtë sovraane e çdo vendi dhe populli, prapëseprapë si parime të përbashkëta i thekson qëndrimet humanitare dhe lirinë e vendosjes për numrin e fëmijëve dhe intervalin midis lindjeve si të drejtë elementare njerëzore të individit dhe të çiftëve bashkëshortorë.⁵⁰

Në kuadër të humanizimit të raporteve midis gjinive, të mbrojtjes së shëndetit dhe përpjekjeve që individi, çiftët bashkëshortorë, familja dhe popullsia të mbizotërojnë mbi riprodhimin e vet, planifikimi i familjes sot nga aspekti shkencor, human dhe interesi i gjerë shoqëror konsiderohet i pranueshëm dhe qëllim i dëshirueshëm; është fjala për synimet që çdo fëmijë i lindur të jetë edhe i dëshiruar, por planifikimi i familjes »nuk nënkupton përpjekjen për më shumë ose më pak fëmijë, por përpjekjen për ta mbizotëruar edhe riprodhimin biologjik«.⁵¹ Tendencës drejt »orientimit« dhe »centralizimit« të materies kaq të ndërlikuar dhe inti-

⁵⁰ Plani Botëror i Aksionit në fushën e popullsisë u botua në shumë gjuhë botërore; në gjuhën serbokroate u publikua në *Bilten Odbora za Svetsku godinu stanovništva*, nr. 3, Beograd 1975, fq. 61 — 116 dhe në *Stanovništvo*, nr. 3 — 4, 1973 dhe 1 — 2, 1974, Beograd, fq. 227 — 243.

⁵¹ D. Breznik, »Demografska kretanja u SR Srbiji i mere za rešavanje problema«, *Stanovništvo*, nr. 3 — 4, 1975 dhe 1 — 2, 1976, fq. 29 (nënvizoi H. I.).

Duke përfaqësuar këtë qëndrim, aktivistja e dalluar e FAG-ut dhe krijuesja e angazhuar për përmirësimin e pozitës së tërësishme të femrës në familje dhe shoqëri, Vida Tomshiq thekson: »Planifikimi i familjes nuk ka për qëllim kuantitetin, e as nuk përpiqet për më pak ose për më shumë fëmijë. Planifikimi i familjes kupton ndryshimin dhe kualitetin e marrëdhënieve njerëzore në riprodhim biologjik.

Mundësia më e madhe ose më e vogël e mjeteve për planifikimin e familjeve nuk krijon motivacione për kufizimin e lindjeve. Motivimi për këtë krijohet nga kushtet e përgjithshme shoqërore. Kur nga këto kushte krijohet motivimi për më pak

me dhe krijimit të paradispozitave psikologjike e të vetëdijes në kuptim të përqafimit të qëndrimeve mbi ri-prodhimin e popullsisë, duhet t'i paraprijë krijimi i kushteve të caktuara sociale, materiale, arsimore, shëndetësore etj. Elementet e vetëdijes, të cilat në procesin e lindjes dhe në rrjedhat demografike në përgjithësi manifestohen përmes nevojave, aspiratave, dëshirave, qëllimeve dhe interesave, motivacioneve, sjelljeve, sigurisë sociale, vlerave, qëndrimeve ndaj jetës seksuale etj., janë produkt i kushteve të përmendura jetësore. *Vetë pozita ekonomike, sociale dhe arsimore e individit, familjes dhe grupit të caktuar shoqëror përcakton normat shoqërore-demografike të sjelljes riprodhuese të popullatës; dëshira të lindura për pasardhës, përkatësisht, për numër më të vogël apo më të madh të fëmijëve nuk ka, por ato krijohen gjatë ciklit jetësor.* Vetëdija mbi natalitetin e ulët dhe familjen e vogël nuk mund të arrihet me përhapjen e propagandës në favor të zvogëlimit të tyre, duke zbatuar metodat dhe mjetet »artificiale« për rregullimin e lindjes dhe duke theksuar efektet negative të shkallës së lartë të natalitetit, e cila relativizon rezultatet e zhvillimit shoqëro-ekonomik. Por edhe kjo nuk do të thotë se popullatës nuk duhet t'u ofrohen njohuri mbi mundësitë e kontrollit të lindjes për ata çiftë bashkëshortorë të cilët këtë e dëshi-

ose më shumë fëmijë — aksioni shoqëror për planifikimin e familjes mund të ndikojë dukshëm në humanizimin e raporteve, në konsumimin më të vogël ekstensiv të shëndetit dhe të jetës së nënës dhe të fëmijës, në jetën e lumtur të fëmijëve të dëshiruar, pra ky aksion mund ta zbulojë konservativitetin dhe johumanitetin në marrëdhëniet ekzistuese shoqërore. Prandaj, ky aksion është pjesë përbërëse e përpjekjeve për marrëdhënie humane socialiste« (V. Tomšić, »Planiranje porodice i populaciona politika«, në librin *Izgradnja društvenih stavova o populacionoj politici u Jugoslaviji*, Savezna konferencija SSRNJ i Savet za planiranje porodice u Jugoslaviji, Beograd 1975, fq. 583).

Po këtë mendim e mbron autorja e njohur e punimeve për të drejtat e njeriut që lirisht të vendos për lindjen e fëmijëve dhe aktivistja e udhëheqësja në Pleqësinë Federative për Planifikimin e Familjes në Jugosllavi, Nevenka Petrić, e cila nënvizon:

»Në Jugosllavi nuk nisemi nga numri ideal mbi madhësinë e familjes. Si qëllim i drejtpërdrejtë dhe ideal vleror janë pranuar raportet e caktuara në shoqëri, në familje, veçanërisht raportet humane midis meshkujve dhe femrave dhe krejt kjo bazohet në të drejtat vetëqeverisëse të prodhuesve në punën e bashkuar. Në vetë konceptin e prindërisë së lirë dhe përgjegjëse zgjidhet konflikti, i cili, në të vërtetë, vetëm duket kështu (nuk ekziston), midis realizimit të të drejtave të njerëzve për vendosjen e lirë mbi lidhjen e fëmijëve dhe mundësie të ndikimit të shoqërisë në lëvizjet demografike« (N. Petrić, »Društveno-politički aspekti planiranja porodice u Jugoslaviji«, në studimin *Fertilitet stanovništva i planiranje porodice u Jugoslaviji*, fe, 150, nënvizoi H. I.).

rojnë, mirëpo edhe kjo, në anën tjetër, nuk mund t'i jap askujt të drejtë që arbitrarisht të interevenojë në këtë sferë jashtë interesit të vërtetë të individëve si aktorë të drejtpërdrejtë të riprodhimit.⁵²

Elementet e përmendura të vetëdijes dhe normat etike sa i përket martesës, familjes dhe lindjes, as nuk krijohen e as nuk ndryshohen nga »kontrolli« i lindjes dhe planifikimi i familjes përmes zbatimit të këtyre apo atyre mjeteve të dhunës, por vetëm me ndryshimin e sistemit të gjerë socialo-ekonomik. Variablet e vetëdijes, përkatësisht, pikëpamjet dhe sjelljet ndaj riprodhimit njerëzor, ashtu siç krijohen në sistemin e caktuar socialo-ekonomik, gjithashtu edhe transformohen nga modernizimi i këtij sistemi. Vetëm mbi bazën e një sistemi të tillë të ndryshuar krijohen pikëpamjet dhe normat e reja sociale mbi martesën dhe kohën e hyrjes në të, numrin e fëmijëve dhe intervalin kohor midis lindjeve dhe mbi madhësinë e familjes, ndërsa përqafimi dhe zbatimi i kontrollit të lindjes në martesë bëhet »stil« i jetës.⁵³

Në sferën më intime dhe më të decentralizuar shoqërore të jetës së njeriut, çfarë është riprodhimi i tij, nuk mund të ndikohet me masa dhe mjete jashtëzhvillimore dhe se problemet shoqëro-ekonomike nuk mund të zgjidhen përmes »rrugëve demografike«.⁵⁴ Në historinë demografike nuk është shënuar deri tash se

⁵² »Njohja e mënyrave dhe e motiveve të riprodhimit të popullsisë nuk jep të drejtë që arbitrarisht të intervenojmë në këtë proces, jashtë interesave reale të të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces. Pikërisht ky interes i vërtetë i pjesëmarrësve në riprodhim është ai i cili vendos për nivelin e riprodhimit, por edhe i cili manifestohet vetëm përmes vendimit të individit mbi nivelin e riprodhimit. Pra, me të gjitha masat e përmendura e masat e tjera, ne realizojmë pozitën më të mirë sociale të individit në shoqëri e jo këtë apo atë politikë popullore« (D. Đozić, »Mogućnosti zasnivanja populacione politike«, *Sociologija*, nr. 3, Beograd 1985, fq. 385).

⁵³ Për humanizimin e raporteve midis gjinive, prindërisë së lirë dhe përgjegjëse dhe për realizimin e politikës popullore si pjesë përbërëse të politikës së gjerë shoqëro-politike, supozimet dhe qëllimet me rëndësi të gjerë shoqërore, sipas V. Tomshicit janë: zhvillimi i shpejtë i forcave prodhuese, përparimi i marrëdhënieve prodhuese, barabarësia e plotë e femrës përmes pjesëmarrjes në prodhim dhe qeverisje, marrëdhëniet e reja martesore dhe familjare (pavarësia ekonomike dhe shoqërore e anëtarëve të familjes), raportet e reja në shoqëri, të cilat do të ndikojnë vendosmërisht në politikën sociale dhe në zhvillimin e shërbimeve të posaçme shoqërore etj. (V. Tomšić, *Po aty*, fq. 587).

⁵⁴ Përveç pikëpamjeve të përmendura të prof. Breznikut dhe të hulumtuesve në Qendrën për Kërkime Demografike të Institutit të Shkencave Shoqërore të Beogradit, qëndrimin se problemet shoqëro-ekonomike nuk zgjidhen përmes rrugëve demografike, e përfaqësojnë edhe shumë demografë të shquar të vendit tonë. Kështu prof. Grebo thekson: »Me rastin e për-

planifikimi i familjes jashtë kontekstit të zhvillimit ka kushtëzuar prosperitetin ekonomik dhe social të një vendi apo të një populli, por ka ndodhur vetëm e kundërta: transformimi i gjerë ekonomik dhe shoqëror ka përcaktuar qëndrimet përkatëse të individit dhe të çiftëve bashkëshortorë, të cilët në rrafshin e riprodhimit dhe të politikës demografike kanë dhënë rezultate të dëshiruara.⁵⁵ Në përtëritjen e popullsisë mund të ndikohet vetëm në mënyrë indirekte, përmes krijimit të kushteve shoqëro-ekonomike të jetës dhe masave të politikës sociale, ekonomike, shëndetësore, arsimore dhe të politikave të tjera zhvillimore. Ndërmarrja e masave të drejtpërdrejta nuk është e lejueshme as në pikëpamje shkencore, as shoqërore e as humanitare dhe intervenimi i shoqërisë nuk mund të shndërrohet në manipulim burokratik në këtë lëmë kaq delikat; një qasje e tillë nuk përkon me natyrën e njeriut, ndjenjat dhe arsyen e tij. Shoqria me institucionet e saja mund të ndërtojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të llogaritë në sukses të masave të ndërmarra vetëm nëse individët dhe opinioni i gjerë këtë e pranojnë, siç është rasti p.sh. me përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullit (vaksionimi i obligueshëm i popullsisë me qëllim që të pengohen apo të eliminohen sëmundjet infektive e të tjera), pastaj me shkollimin e obligueshëm fillor etj. Shembull tipik për mësim për mospësuksin e politikës popullore dhe implikimet politike lidhur me këtë,

caktimit të masave të politikës demografike duhet patjetër të ekzistojë vetëdija dhe njohuria e qartë se problemet shoqërore nuk mund të zgjidhen përmes rrugës demografike, por me zhvillim ekonomik dhe social, si dhe me zhvillim të përhershëm të marrëdhënieve socialiste vetëqeverisëse» (Z. Grebo, *Covjek, radanje i društvo*, Svjetlost, Sarajevo 1975, fq. 266). Edhe demografi dhe profesori i shquar suedez E. Hofsten, lidhur me këtë, thekson se »zhvillimi shoqëror dhe ekonomik është parakusht i domosdoshëm për rënien e shpejtë të numrit të lindjeve në vendet të cilat sot i karakterizon rritja e shpejtë e popullsisë» (E. Hofsten, »Spor oko planiranja porodice«, *Ekonomiska misao* nr. 3, Beograd 1974, fq. 111).

⁵⁵ Në zvogëlimin e shkallës së natalitetit prej 34 promila në vitin 1947 në 17 promila në vitin 1957, duke zbatuar politikën restriktive popullore përmes liberalizimit të abortimeve, kontracepcionit dhe sterilizimit për shkaqe eugjenike (Ligji mbi mbrojtjen eugjenike, i nxjerrë më 1948), më së shumti ka arrihur Japonia. Mirëpo, këto përpjekje të shoqërisë japoneze kanë dhënë rezultate pikërisht për atë se Japonia qysh atëherë ishte vend i industrializuar dhe mjaft i urbanizuar (me më së 65% të popullsisë urbane) dhe i zhvilluar në pikëpamje kulturore dhe shëndetësore; në hapësirë edhe ashtu të ngushtë (372.000 km²) në këtë vend sot jetojnë rreth 120 milionë banorë, me dendësi prej 320 banorësh në 1 km² dhe nuk shtrohet çështja e ekzistencës së popullatës.

është India.⁵⁶ Në këtë vend u ndërmorën aktivitete të gjera në sferën e »kontrollit« të lindjes, por me këtë politikë jo vetëm që u cenuan të drejtat dhe liritë elementare njerëzore, por edhe rezultatet ishin shumë modeste: nataliteti edhe më tutje mbeti në nivel mbi 40 promila. Për këtë arsye, ithtarët e flakët të dikurshëm të zgjidhjes së problemeve shoqëro-ekonomike përmes frenimit të »eksplosionit demografik« e ndërruan mendimin dhe në Konferencën e Tretë Botërore mbi Popullsinë në Bukuresht më 1974 u angazhuan që problemet populative të zgjidhen vetëm në kuadër të planeve të zhvillimit intensiv shoqëro-ekonomik.⁵⁷

Cenimi i lirive dhe i të drejtave nuk jep rezultate, natyrisht, as në drejtim të kundërt — në rritjen e natalitetit, por mund të jetë vetëm kontraproduktiv. Zbatimi i masave stimulative, nxjerrja e dekreteve, ndalimi i abortimeve dhe përdorimi i mjeteve kontraceptive në gjysmën e dytë të viteve të 60-ta e më vonë, siç është e njohur, nuk kanë dhënë rezultate afatgjate në Rumani, Bullgari, Hungari, Çekoslovakia etj.⁵⁸ Shkalla e natalitetit nuk ka mundur të mbahet në nivel të lartë për një kohë të gjatë, përkundër dëshirave dhe përpjekjeve, të lidhura për politikën populative të tipit, ekspansionist dhe fashist, as në Itali midis dy luftërave.⁵⁹ Pse poli-

⁵⁶ Në këtë vend (në 560.000 fshatra), qysh në fillim të viteve të 50-ta, u ndërmor një fushatë e gjerë e planifikimit të familjes përmes pengimit të mbarësimeve dhe lindjeve. Për këtë qëllim u organizuan 9.000 klinika të cilat gratis distribuuan mjete kundër mbarsimeve dhe 138 klinika për sterilizim gratis. Prej vitit 1956 sterilizimi me vullnet u bë në rreth 5 milionë njerëz dhe u realizuan rreth 6 milionë abortime në vit (D. Valentej, »Problemi stanovništva nedovoljno razvijenih zemalja i kritika »demografskog« puta njihovih rešenja«, *Stanovništvo*, nr. 2—3, Beograd 1965, fq. 105; B. L. Raina, »Population Policy in India«, *IUSP Konferenca*, London 1969; sipas A. W. — Baletić, *Po aty*, fq. 413 — 415.

⁵⁷ J. D. Rockefeller 3rd, »Population Growth: The Role of Developed World«, *Lecture Series on Population*, International Union for the Scientific Study of Population, Bucharest 1974; sipas A. W. — Baletić, *Po aty*, fq. 67.

⁵⁸ Në këto vende nataliteti sillej kështu: në Rumani: më 1966 14,3, më 1967 27,1 (rritje), më 1972 18,0 dhe më 1981 18,0 promila (rënie); në Bullgari: më 1967 16,2, më 1973 16,3 (rritje) dhe më 1981 14,1 promil (rënie); në Hungari: më 1965 13,0, më 1967 14,5, më 1976 17,5 (rritje), më 1973 15,0 dhe më 1981 13,3 promila (rënie); në Çekoslovakia: më 1967 15,1, më 1976 19,2, më 1973 18,8 (rritje) dhe më 1981 15,5 promila (rënie). Në Hungari dhe Çekoslovakia shkalla e natalitetit tanimë është kthyer në nivelin që ishte para masave të ndërmarra.

⁵⁹ Në periudhën 1921—1923 shkalla e natalitetit në këtë vend arriti në 29,1 promil (si më e larta), por pas kësaj kohe përsëri tregoi tendencën e zvogëlimit: në periudhën 1926—1930 ishte 26,7 dhe në periudhën 1931—1935 bie në 23,8 promila (*Le mouvement naturel de la population dans le monde de 1906 à 1936*, Institut national d'émographiques, Paris 1954, fq. 74).

tika populative në sferën e zvogëlimit të natalitetit dhe rezultate në Japoni, u bë fjalë më parë.

Meqenëse numri më i madh i fëmijëve lind në martesë (në Jugosllavi p.sh. më se 92%),⁶⁰ *martesa dhe familja janë suazë themelore e riprodhimit të popullsisë*. Prandaj, shkalla e përgjithshme e natalitetit dhe shkallët specifike të fertilitetit të popullatës femërore janë nën ndikim të fuqishëm të strukturës dhe të variablave martesore: përqindja e të pamartuarve dhe e të pamartuarave dhe e të shkurorëzuarve e të shkurorizuarave në Jugosllavi është jo vetëm mjaft e madhe, por edhe në rritje të vazhdueshme. Sipas regjistrimit të vitit 1971 në grupin e popullsisë 15—59 vjet pjesëmarrja e të pamartuarve ishte 34,7% dhe e të pamartuarave 25,6%, ndërsa përqindja e meshkujve të shkurorëzuar ishte 1,07% dhe e femrave të shkurorëzuara 2,60% të moshës 15—59 vjet; numri i meshkujve të shkurorëzuar ishte 80.102, kurse i femrave 189.515.⁶¹ Nga 182.704 martesë të shkurorëzuara në Jugosllavi në vitin 1970, 20.473 martesë janë shkurorëzuar (11,2%). Sipas kombësisë së grave, numri më i madh i shkurorëzimeve u takonte serbëve (9.028), kroatëve (5.223), sllovenëve (1.828) dhe jugosllavëve (1.279).⁶²

Duke pasur parasysh faktet e përmendura, me qëllim që të rehabilitohet riprodhimi atje ku konsiderohet se ai zhvillohet në vëllim të ngushtuar, shtrohet pyetja: a është normale dhe e lejueshme që shoqëria me institucionet dhe masat e saja t'i detyrojë të gjitha femrat të martohen (pra, ta ndërprejnë celibatin), në një anë, dhe ta pengojë shkurorëzimin, i cili, përveç tjerash, shprehet në mënyrë patologjike te gruaja, burri, fëmijët, familja dhe vetë shoqëria, në anën tjetër? Po të kishte pasur shoqëria sukses në këtë drejtim, jo vetëm që do të zvogëloheshin ose së paku të zbuteshin problemet e patologjisë familjare, por edhe nataliteti do të ishte rritur. Mirëpo, deri tash nuk është e njohur se një shoqëri prognosive i ka detyruar individët të martohen dhe çiftat bashkëshortorë të lindin fëmijë (nëse lindja është fiziologjikisht e mundshme) ose ta pengojë shkurorëzimin duke ashpërsuar masat përmes legjislacionit. Shoqëria, duke përfshirë edhe shoqërinë tonë socialiste vetëqeverisëse, këtë materie ua ka lënë në dispozicion vetë

⁶⁰ D. Breznik, *Demografija. Analiza, metodi i modeli*, CDI, IDN, Beograd 1977, fq. 455.

⁶¹ M. Sentić, »Struktura prema bračnom stanju«, në studimin *Razvitak stanovništva Jugoslavije u posleratnom periodu*, CDI, IDN, Beograd 1974, fq. 132 — 133.

⁶² M. Sentić, »Nupcijalitët i divorcijalitët stanovništva različitih nacionalnosti«, në studimin *Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti*, CDI, IDN, Beograd 1978, fq. 51 — 56.

individëve dhe çiftave bashkëshortorë që lirisht të vendosin, duke konsideruar se këto janë probleme të tyre personale.

Përveç stabilitetit të martesave dhe të familjeve, për nivelin e natalitetit dhe të fertilitetit në një popullatë, *rëndësi të veçantë ka fshati si formë e popullimit, natyrisht fshati i cili nuk është gjendur nën çrregullime të fuqishme të strukturave bazë demografike dhe të »thyerjes« demografike.* Prandaj, nëse një shoqëri dëshiron të ndërmarrë diçka në drejtim të ruajtjes së forcës së saj vitale, duhet ta ruajë dhe ta zhvillojë fshatin, gjë që e pranon tërë popullsia rurale, e cila, shpeshherë, edhe dominon numerikisht. Shoqëria jugosllave, me mekanizmat e saja, sikur e la herët pas dore fshatin, gjë që në shumë terriore tonat bëri të shkaktohej rënia e natalitetit dhe shtimi negativ natyror e shpopullimi i theksuar, ndërsa në një të ardhshme shumë të afërt, në një numër të mirë të fshatrave të Jugosllavisë, do të ndodhë të shuhet edhe jeta.⁶³

Kur është fjala për politikën populllative, nuk ka arsye që të mos pranohet mendimi i prof. Breznikut, njërit ndër demografët më të shquar të vendit tonë e më gjerë (drejtor shumëvjeçar i Qendrës së Kërkimeve Demografike në Beograd), i cili nënvizon: »Te nxjerrja dhe realizimi i masave të politikës populllative, bashkësia shoqërore duhet patjetër t'i respektojë të drejtat elementare njerëzore, ku edhe e drejta e individëve dhe e bashkëshortëve që vetë të përcaktojnë se çfarë numri të fëmijëve do të kenë, hyn në radhën e të drejtave elementare njerëzore. Shtrohet pyetja: si duhet të shikohet paraqitja e konflikteve, që shkaktohen kur realizimi i të drejtave mbi lindjen e lirë nuk është në pajtim me interesat shoqërore (fertiliteti shumë i ulët me tendencë shpopullzuese ose fertiliteti shumë i lartë me pasojë të dëmshme në shëndetin e popullsisë femërore, por edhe të fëmijëve etj.). Sipas mendimit tonë, *nuk vijnë në konsiderim kurrfarë masash të drejtpërdrejta të bashkësisë shoqërore në këtë sferë, por është e domosdoshme që bashkësia shoqërore në një mënyrë tjetër (me masa të politikës sociale dhe ekonomike, me edukim, me*

⁶³ Nga gjithsej 27.500 fshatra, sa i ka Jugosllavia, në rreth 20.000 sosh ka rënë numri i popullsisë, ndërsa së shpejti në rreth 10.000 fshatra do të shuhet jeta dhe do të mbesin vetëm si nocione gjeografike (S. Suvar, *Između zaseoka i megalopolisa*, Centar za sociologiju sela, Zagreb 1973, fq. 186 — 187; V. Puljiz, »Teze o socijalnim promjenama i agrarnom razvoju«, në librin *Problemi socijalističkog razvoja poljoprivrede i sela*, Izd. Centar Komunist i Jugoslovenski centar za teoriju i praksu samoupravljanja »E. Kardelj«, Beograd — Ljubljana, 1983, fq. 583; V. Cvjetičanin, S. Livada, V. Puljiz, D. Stefanović, »Ruralna sociologija i razvoj poljoprivrede«, në librin e përmendur, fq. 608).

aktivitet të shërbimeve shëndetësore, me mbrojtje të fëmijëve e të nënave etj.), të ndikojë që zhvillimi i popullsisë të shkojë në atë drejtim i cili është në pajtim me interesat shoqërore».⁶⁴

Sot ekziston pajtueshmëri e plotë se duhet të bëhen përpjekje të mëdha që të zvogëlohet mortaliteti i popullsisë të të gjitha grup-moshat e të dy gjinive atje ku ai është ende i lartë. Ky është qëllim përgjithësisht i dëshiruar i shkencës së mjekësisë dhe i tërë gjinisë njerëzore, pa marrë parasysh përkatësinë raciale, nacionale, apo fetare. Te shqiptarët duhet insistuar që mortaliteti i foshnjëve, si indikator shumë i rëndësishëm i nivelit të natalitetit, të zvogëlohet sa më shumë që është e mundur, sepse në shumë territore që i banojnë ata është ende mjaft i lartë, mbi 70 promila mesatarisht në vit në fillim të viteve të 80-ta, por ka rajone fshatare dhe komuna të Kosovës ku ky mortalitet është edhe mbi 100 promila.⁶⁵ Prandaj, kur të kihet parasysh fakti se mortaliteti i foshnjëve në disa vende ka rënë në nivelin prej 10 deri 12 promila dhe në Slloveni, Kroaci, Vojvodinë etj. sillet rreth 15 promila, ky mortalitet te popullsia e Kosovës dhe te popullsia shqiptare në Jugosllavi, si në pikëpamje relative ashtu edhe në pikëpamje absolute, vlerësohet si shumë e lartë dhe si i tillë paraqet një problem të madh shëndetësor, social dhe human dhe njëkohësisht faktor të shkallës së lartë të natalitetit. Ende te kjo popullatë një numër i madh i lindjeve realizohet jashtë themelatave shëndetësore dhe

⁶⁴ D. Breznik, »Demografska kretanja u SR Srbiji i mere za rešavanje problema«, *Stanovništvo*, nr. 3—4, 1975 dhe 1—2, 1976, fq. 29.

Duke folur për dallimet në nivelin e fertilitetit të popullsisë së Jugosllavisë sipas nacionaliteteve, drejtori i Qendrës për Kërkime Demografike të Institutit të Shkencave Shoqërore të Beogradit, prof. Brezniku e thekson edhe këtë: »Jam kundërshtar i disa deklaratave — që popullsia e kombësisë me fertilitet të lartë duhet ta zvogëlojë fertilitetin. Mendoj se një shoqëri mund të ketë qëndrime të përbashkëta, por edhe të ndryshme rreth nivelit të riprodhimit, varësisht nga kushtet që ekzistojnë në disa territore. Megjithëse, edhe pos kësaj, disa qëndrime mund të jenë të përbashkëta, p.sh., që zhvillimi demografik të jetë në pajtim me zhvillimin socialo-ekonomik, pastaj atë që e ka proklamuar Kushtetuta jonë, atë në nivel të të drejtave të individit, të njeriut — që njeriu lirisht të vendosë për lindjen e fëmijëve, me kusht që kjo të mos jetë në dëm të shëndetit. Në të ardhshmen, mendoj se — në instancë të fundit edhe planet dhe konceptcionet tona për këtë flasin — priret që niveli më i barabartë (ekonomik dhe social) të ndikojë në zvogëlimin e dallimeve sa i përket fertilitetit« (Diskutimi në Qendrën Marksiste të KQ të LK të Serbisë në temën »Demografsko izučavanje nacionalnosti«, *Marksistička misao*, nr. 3, Beograd 1979, fq. 171—172, (nënvizoi H. I.).

⁶⁵ *Komunat e KSA të Kosovës më 1982*, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1983, fq. 34.

pa ndihmë profesionale (më 1980 në Kosovë p.sh. 47,0%) dhe e ulët është përqindja e të shëruarve para vdekjes (në Kosovë në vitin 1980 61,6%).⁶⁶ Zvogëlimi i mortalitetit të foshnjeve dhe të fëmijëve të vegjël, rritja e numrit të lindjeve dhe shërimi në institucionet shëndetësore etj. mund të arrihet me zgjerimin e shërbimeve shëndetësore (ngritja e ambulancave, stacionarëve, spitaleve etj.) dhe me përmirësimin e kushteve socialo-materiale të popullatës (ushqimi, banimi, veshëmbathja, mbrojtja e fëmijëve dhe e nënave etj.), sidomos të popullatës fshatare, sepse pikërisht atje gjendja nuk është e kënaqshme, por, në anën tjetër, duhet gjithashtu të bëhen përpjekje që me aktivitete sistematike shëndetësore, edukative dhe arsimore të eliminohen zakonet klasike sa i përket kujdesjes ndaj foshnjeve, të sëmurëve, ushqimit të tyre etj., siç është vepruar menjëherë pas luftës në kuadër të kurseve të ndryshme, por pak apo shumë të organizuar në mënyrë fushate. Në këtë mënyrë do të ngrihet vetëdija për ruajtjen e shëndetit, për shërim dhe lindje në organizata shëndetësore dhe për vlerësimin e drejtë të jetës në përgjithësi, e krejt kjo së bashku do të ketë efekte të mëdha në zvogëlimin e natalitetit.

V

Eksperienca e zhvillimit demografik të vendeve të zhvilluara, të cilat e kanë kaluar transicionin demografik, tregon se ligjësitë e zhvillimit të popullsisë nuk janë të përhershme, por varen nga ndryshimi i kushteve shoqërore në kohë dhe hapësirë. Historia demografike e vendeve sot të zhvilluara dhe prosperiteti i tyre ekonomik dhe shoqëror i demantuan në themel pikëpamjet pesimiste të Maltusit e të maltuzianizmit, të neomaltuzianizmit të hershëm dhe bashkëkohor lidhur me martesën, familjen dhe lindjen dhe në instincë të fundit me rritjen e numrit të popullsisë. Para gati një shekulli e gjysmë p.sh. *rënia e shkallës së natalitetit në vendet e zhvilluara të Evropës Perëndimore pasoi jo me zgjerimin e zbatimit të mjeteve kontrceptive, por pikërisht me ndryshimet radikale të kushteve jetësore, të cilat fuqimisht i ndryshuan normat e sjelljes riproduktive. Identike është situata edhe me territoret dhe shtresat e zhvilluara të popullsisë në Jugosllavi, në të cilat krijesat e revolucionit industrial depërtuan më herët, ku na-*

⁶⁶ Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës VIII, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë 1983, fq. 34; Razvoj Jugoslavije 1947-1981, Savezni zavod za statistiku dhe Savezni zavod za društveno planiranje, Beograd, maj 1982, fq. 205.

taliteti nisi spontanisht të binte qysh nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, pra pa zbatimin e ndonjë politike popullative. Është e njëjtë gjendja edhe me zvogëlimin e natalitetit e të fertilitetit të popullsisë së Kosovës, të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, të popullsisë së Shqipërisë, të popullsisë së kombësisë muslimane në vendin tonë etj., vetëm shkallët e tyre duhet të vështrohen të diferencuara sipas karakteristikave regjionale, sociale, profesionale, arsimore etj.; popullata e Shqipërisë diçka më herët ka hyrë në procesin e transicionit demografik edhe në sferë të mortalitetit edhe në lëmë të natalitetit.⁶⁷ Shkallën e lartë të natalitetit të tërësia e popullatës shqiptare, por me tendencë gjithnjë të rënies, duhet të shikohet edhe përmes faktit se menjëherë pas Luftës së Dytë ishte në nivel shumë të lartë (rreth 45 promila).

Transicioni demografik në sferën e natalitetit dhe të variablave të tjera demografike të popullata shqiptare, nuk ka dyshim se po vazhdon intensivisht, por duhet të kishin konsiderata edhe ndaj vetë karakterit të ndërlikuar të proceseve demografike dhe të retardacionit të tyre dhe veçanërisht ndaj natalitetit si dukuri afatgjate dhe shumëdimensionale. Në frymën e formulimeve të Vogellnikut se «në demografi vitet konsiderohen si decenie, ndërsa deceniet si shekuj»,⁶⁸ transformimet e arritura dhe ato aktuale shoqëro-ekonomike nuk mundën njikohësisht ta ndryshojnë riprodhimin e popullsisë dhe tërë kompleksin demografik dhe, u mor vesh edhe atë social, sepse këto procese sipas natyrës së tyre të ndërlikuar, nuk janë të automatizuara.⁶⁹ Rezultatet tanimë të arritura dhe ato që do të realizohen në lëmin e punësisë, të arsimit, të emancipimit kulturor dhe ekonomik të femrës, zgjerimi i strukturave dhe i krijesave kualitative të urbanizimit dhe të sistemeve infrastrukturale, rënia e mortalitetit të foshnjëve dhe e fëmijëve të vegjël përmes mbrojtjes shëndetësore të popullsisë etj. të popullata shqiptare do kenë efekte të mëdha në drejtim të zvogëlimit të natalitetit. Gjeneratat të cilat tashmë kanë hyrë ose së shpejti do të hyjnë në periudhën fertile të jetës, nuk ka dyshim se do të krijojnë pikëpamje krejtësisht të tjera mbi lindjen, jetën dhe vdekjen. Në rrethana të tilla domosdo fuqimi-

⁶⁷ A. Sauvy, «La population de l'Albanie en transition», *Population*, No 1, Institut national d'études démographiques, Paris 1976, fq. 193 — 195.

⁶⁸ D. Vogellnik, «Slovenski demografski trenutek: 1750—2000», *Ekonomika revija*, št. 3 — 4, Ljubljana 1982, fq. 541.

⁶⁹ «Madje edhe po të zvogëlohej shpejt numri i lindjeve në një grua deri te numri i cili është i nevojshëm për riprodhim, ende do të ekzistojë një periudhë e gjatë e rritjes së shpejtë të popullsisë — p.sh. 50 deri 75 vjet» (P. Hofsten, *Popaty*, fq. 109).

sht do të rritet vetëdija mbi planifikimin e madhësisë së familjes dhe përqaftimin e kontrollit të lindjes në martesë si »stil« të jetës.⁷⁰ Kjo është ligjësi objektive e zhvillimit shoqëror, e vërtetuar në shembullin e të gjitha popullatave dhe shoqërive sot të zhvilluara. Prandaj, niveli i lartë i natalitetit dhe rënia e ngadalshme të tij, duhet lidhur vetëm për grupet e caktuara shoqërore, me shtresëzimin socialo-klasor dhe strukturat përkatëse demografike brenda tyre, e kurrësi me tërë popullatën e kombësisë shqiptare. Lëvizja e natalitetit dhe zhvillimi i gjithmbarshëm i popullsisë së popullit shqiptar është, pra, në përputhshmëri të plotë me mekanizmat dhe ligjësitë biologjike dhe sociale dhe në pajtueshmëri të plotë me postulatet dhe bazat e teorisë demografike.⁷¹

* »Se a do të ndryshohen qëndrimet e familjes dhe të një-rëzve në përgjithësi sa i përket madhësisë së familjes krahas kushteve të ndryshuara shoqërore dhe ekonomike, kjo varet jo vetëm nga programi ekonomik dhe shoqëror, por edhe nga shumë ndryshime të tjera, të cilat shpeshherë ngadalë zhvillohen, ndonëse këto varen nga vetë progresi. Fjala është për mbrojtjen shëndetësore, veçanërisht të nënës dhe të fëmijës; për mortalitetin e foshnjëve, i cili duhet zvogëluar në nivel sa më të ulët; për lirinë e gruas në kuptim të aktivitetit të saj jo vetëm në familje, por edhe në profesion dhe në jetën shoqëro-politike; për t'u ofruar mundësi njerëzve që në bashkë-sitë e tyre shoqërore dhe në të tjera të vendosin për të gjitha çështjet të cilat janë të rëndësishme për jetën e tyre, për je-tën e familjeve të tyre etj. (Grup autorësh, *Fertiliteti stanovništva i planiranje porodice u Jugoslaviji*, CDI, IDN, Beograd 1980, fq. 8).

⁷¹ Është dogmatik dhe metafizik qëndrimi i disa demogra-fëve të ne se zhvillimi i popullsisë së Kosovës dhe i popullsisë së kombësisë shqiptare »është përjashtim nga teoria demogra-fike«.

Hivzi Islami

THE NATALITY AND IT'S
DETERMINANTS AMONG THE
ALBANIAN POPULATION
IN YUGOSLAVIA

(Summary)

This work deals with the matter of the natural growth of the Albanian population and the determinants which cause the movements of this growth. The treatment of this matter is based on the statistical evidence, on the theoretical results as well as on the empirical ones (the questionnaires) of the demographic investigations, and on the other sources of knowledge about the population growth and the family planning.

The investigations show that the economically undeveloped districts have a higher degree of natality (the charts 1, 2, 10 and 11), that the women who are economically active have less children than those who are economically dependent (the charts 3, 5 and 6), that the women of the agrarian professions (both the active and the dependent ones) have a higher average of fertility than the women of the unagrarian professions (the charts 3, 4 and 6), and that the uneducated women have more children compared to the women of a higher level of education (the charts 7 and 8). Therefore, the thesis of the etnical and religious determinants of the natality — which is supported by some official circles in Yugoslavia that, considering the degree of the natural growth of the Albanian population, are expressing obvious attitudes of neomalthusian character, — does not rely on scientific grounds. The fact that certain levels and structures of society — the villagers, the working class, the administrative workers and the intelligentsia, have different degrees of natality, shows that

the human reproduction depends on the features of the class-levels of the society. The economical, social and educational background of the individual, of his family and of the particular social group he belongs to, determine the demographic — social norm of the reproductional behaviour of the population.

The strong dependance of the degree of the natality on the economical — social factors is proved, among the other evidence, also from the differences in the amount of this degree which exist among the populations of the same nationality and of the same religious background, living on districts of different levels of developement (see charts 1, 2 and 10), of course including here the Albanian population (the charts 2 and 10). The movement of the natality among the Albanians is thus totally in accord with the biological and social laws and fully compatible with the postulates and the basic statements of the demographic theory.

KATALOGU I »THEMËS«
KATALOG »THEME«

Dimitrije Bogdanović

KNJIGA O KOSOVU

Beograd, SANU 1985.

Akademik Dimitrije Bogdanović, koji je teolog i pravnik po obrazovanju, a titule i naučnu afirmaciju zahvaljuje izučavanju srednjovekovne srpske književnosti, poslednjih godina, tačnije od 1982, »prekvalifikovao« se u eksperta za pitanje Kosova. Bogdanović je razvio široku publicističku delatnost vezanu za pitanje Kosova, objavljujući pored *Knjige o Kosovu*, u kojem je ovo pitanje detaljno elaborirano, i niz članaka i prigodnih intervjua. Pored ovog publicističkog angažmana, on je po tom istom pitanju bio i inicijator i sudeonik i mnogih drugih akcija praktičnije naravi. Od ovih akcija valja spomenuti formiranje Kosovskog odbora SANU, u kojem je Bogdanović dobio veoma istaknutu funkciju sekretara. Imajući sve ovo u vidu, za akademika Bogdanovića (uzgred spomenimo da je on redovni član SANU postao nekoliko dana nakon promocije *Knjige o Kosovu*, krajem 1985. godine), može se reći da predstavlja jed-

nu od ključnih ličnosti u jednom pokretu koji se razvija u Srbiji a koji radi na tome formuliše srpski odgovor na pitanje Kosova. Sa karakterom toga pokreta i osnovnim idejama koje zastupa, približe će se govoriti u ovom napisu. Ovde se, predstavljajući autora *Knjige o Kosovu*, može unapred konstatovati sledeće: akademik Bogdanović nije samo glavni javno eksponirani ideolog ovoga pokreta već je i jedan od glavnih operativaca i koordinatora svih akcija koje se preduzimaju (uglavnom pod patronatom SANU, ali i nekih drugih institucija u Srbiji) za pravedno rešavanje pitanje Kosova, za koje se tvrdi da je od velikog značaja za srpski narod.

Objašnjavajući u jednom intervjuu potrebu za osnivanjem Kosovskog odbora, i zadatke koji se pred njim postavljaju u ovom aktuelnom trenutku kosovske krize i u budućnosti, Bogdanović je rekao: »Neznanje je uvek bilo u službi dehumanizacije i porobljavanja; od-

sustvo istorijskog znanja i svesti — uslov da jedan narod izgubi svoj identitet i svoju pamet. Kosovski odbor SANU treba, znači, da nadoknadi neke praznine: da organizuje, ili, makar da podstakne istraživanja mnogih neistraženih pitanja, a rezultate nekih, već istraženih, zaboravljene i potisnute u zadnji plan, da privede ponovo opštoj svesti. (. . .) Nema dovoljno stručnjaka za sve poslove, to znamo, ali to je onda povod za ozbiljne korake da se do većeg broja stručnjaka dođe, da se podigne kadar srpskih albanologa, da se oživi beogradska antropogeografska škola, da se mladi arheolozi, istoričari, sociolozi, etnolozi, lingvisti, usmeravaju i ka toj složenoj naučnoj problematici (pitanju Kosova, Š. M.). Očigledno, sama Akademija ne može mnogo bez univerziteta i naučnih instituta i bez odlučne i nedvosmislene podrške društva. No dužna je ovom narodu i njegovoj budućnosti, da učini sve što može, da bude inicijator, da organizuje i koordinira poslove, da se bori.« (*Književne novine* br. 679, 1. 1. 1985., 10). Ova izjava objašnjava nam razloge zbog kojeg se Bogdanović »prekvalifikovao« u eksperta za pitanje Kosova (takav profil kadrova nedostaje srpskoj nauci), a postaje nam jasniji i karakter njegov angažmana. Prema Bogdanoviću, srpski na-

rod se nalazi u veoma ozbiljnom iskušenju zbog toga što je zaboravio ili potisnuo u drugi plan veliki značaj pitanja Kosova, posledica čega može biti ta da on izgubi svoj identitet i svoju pamet. Tek su događaji na Kosovu 1981. godine, kada je ekskalacija albanskog nacionalizma i iredentizma doživela vrhunac, ukazali na velike propuste srpske nauke i srpske politike, koje se po pitanju Kosova u jednom periodu nisu postavile na ispravan način, sa stanovišta istorijskih i aktuelnih interesa srpskog naroda. Taj propust treba da nadoknadi Srpska akademija, u saradnji sa drugim institucijama, i uz odlučni i nedvosmislenu podršku društva, prema planu koji je u kratkim crtama skiciran u citiranoj izjavi Bogdanovića. S druge strane, trenutak je tako ozbiljan, da se zahteva neka vrsta opšte mobilizacije za odbranu nacionalnih interesa. Zahteva se odlučno, borbeno suprotstavljanje pretenzijama albanskog nacionalizma. Taj borbeni duh, to osećanje mobilisanosti karakteristično za periode predratnih psihotiča jasno dolazi do izražaja u emfatičnoj izjavi Bogdanovića, u istom intervjuu: »Ponekad mi se učini da sam mobilisan, u nekakvom vanrednom stanju kome ne vidim kraja«. (*isto*)

II. Napisana u oklonostima preovladavanja psi-

hoze mobilizacije, *Knjiga o Kosovu* je čitava satkana od mistifikacija koje bi u normalnoj situaciji bile proglašene za nepriemerene duhu našeg vremena. Radi se o tome da su problemi kojima se ova knjiga bavi u suštini anahroni. A pošto se na anahrona pitanja mogu davati samo reakcionarni odgovori, i predloži za rešavanje pitanja Kosova, kojima se pripisuje nekakva urgentna aktuelnost, ne izlaze iz okvira te u biti anahrone tematizacije. Temeljna protivurečnost *Knjige o Kosovu* počiva u toj aktualizaciji anahronog. Prošlost je nadređena sadašnjosti, pa i budućnosti. Svi problemi izviru u prošlosti, pa se onda i okončavaju u njoj, jer se takozvani projekтивni sadržaji knjige, predloži za pravedno rešenje pitanja Kosova u budućnosti, grade na modelu uzorne, zlatne prošlosti, koja je prethodila »mračnom razdoblju« razgradnje tog prvobitnog idealnog stanja. Istorijska nauka neposredno se ovde podupire o mit o zlatnom dobu. Sve je podređeno toj shematičnoj predstavi. Nacionalni, državotvorno-teritorijalni i civilizacijski integritet srpskog naroda formiran je u jednom zlatnom razdoblju u dalekoj prošlosti i tu, u toj njenoj prvoj pojavi, počiva njena nerastvoriva supstancijalnost. Kasniji pokušaji da se taj supstencijalizovani identitet razgradi

doveli su samo da spoljašnjih promena, kao što je to petovekovno ropstvo pod Turcima, ali i tada, kao i kasnije, sve do danas, srpski narod morao potvrđivati svoj davno uobličeni, supstancijalizovani identitet. Takva mitologizacija istorije morala je samu istorijsku tematizaciju dovesti do jednog od čorsokaka u kojima bludi neosmišljeni istorizam. U konačnom ishodu, Bogdanovićeve knjige ne može ponuditi ništa više, sem tlapnje.

Ipak, ta tlapnja nije sasvim besilna i bezopasna. Naprotiv, u kontekstu aktuelne kosovske krize, ona daje jednu zavodljivu dijagnozu te krize. Zašto zavodljivu? Zato što se u *Knjizi o Kosovu* vešto manipuliše sa istorijskim argumentima. Koncipirana tako da odgovori prirodnoj znatiželji onih koji traže objašnjenje za ono što se događa na Kosovu i oko Kosova, ona nudi jedno zavaravajuće naučno, uzročno-posledično objašnjenje, istoriju slučaja: »Zanima vas što se događa na Kosovu? Evo vam naučnog objašnjenja o uzrocima kontrarevolucije na Kosovu!« Na istorijskim argumentima pokazće se da se tu radi o jednoj permanentnoj, viševjekovnoj »kontrarevoluciji«, nasilnoj penetraciji Albanaca u srpske teritorije. Bogdanović, dakle, ne posmatra aktuelnu krizu na Kosovu u njenim sadašnjim, realnim uzro-

cima, kao krizu koja je nastala sada i ovde, kao rezultat unutrašnjih protivurečnosti u razvoju Kosova, i kao refleks ukupne krize jugoslovenskog društva, već uzroke te krize nalazi u bližoj i daljoj prošlosti. Sadašnja kriza za Bogdanovića postaje samo akutni oblik manifestovanja jedne viševekovne permanentne krize, koja je bila čas otvorena a čas latentna. Kosovo je u izvesnom smislu hronična boljka srpske istorije. Uopšte, za Bogdanovića je Kosovo u bukvalnom smislu jedno *bolno pitanje*. I to ne samo za njega lično, zbog toga što ima takva gledišta o istoriji Kosovu, već i za određene istorijske entitete koje prema njegovom supstancijalističkom shvatanju postaju nekakvi veliki, živi nadhistorijski, duhovni »organizmi«. Takvi su »organizmi«, recimo, srpska pravoslavna crkva, pravoslavlje uopšte, srpski narod, srpska nacionalna kultura itd. Kosovo se istorijski i esencijalno određuje kao neodvojivi deo ovih »organizama«. Proces albanizacije Kosova, uzurpacije srpske teritorije od jednog stranog i neprijateljskog elementa, koji je u poslednja tri veka gotovo sasvim izmenio etnički identitet ove pokrajine, postaje stoga tragični, sudbinski događaj za te Bogdanovićeve »organizme«. Jer, albanizacija jednog neodvojivog, pa i po mnogo čemu vitalnog de-

la ovih »organizama«, ne znači za njega samo puko otuđivanje, ili odnarođivanje jedne teritorije, već ga on shvata kao trajno osakaćivanje ili čak kao egzistencijalno ugrožavanje, kao akt od kojeg zavisi konačni opstanak tih »organizama«. Pitanje Kosova tako postaje u bukvalnom, naturalističkom smislu *bolno*, jer se istorijski proces posmatra kao proces rasecanja i komadanja žive organske celine gore spomenutih duhovnih entiteta. Evo kako to izgleda na konkretnom primeru iz Bogdanovićevih tekstova, gde se iz jednog naizgled ne tako važnog problema položaja i značaja srpskih manastira na Kosovu (uzgred, ispravnije bi bilo govoriti o pravoslavnim a ne srpskim manastirima!), izvlače dalekosežni zaključci o ukupnoj ugroženosti, sudbine »organizama«, shvaćenih kao celina koje imaju nekakav puni, »telesni« integritet: »Razmišljanje o ulozi srpskih manastira na Kosovu, kao književnih centara i inače, ne može (se) zaustaviti u okvirima čisto akademske rasprave o prošlosti, već se neminovno nastavlja razmišljanjem o sudbini i ugrožavanju duhovnih i nacionalnih centara Srbije, pa i to ne samo kao spomenika kulture srpskog naroda nego kao živih spomenika jedne nedeljive vizantijsko - južnoslovenske civilizacije Balkana. Logikom istih onih

zakona, po kojima nije dan monaški i književni centar balkanske duhovnosti nije bio niti je mogao da bude izolovan, mora se zaključiti: i sudbina svakog dela tog velikog duhovnog organizma mora se neumitno odraziti na čitavom telu». (D. Bogdanović, *Srpski manastiri na Kosovu kao književni centri*, *Književna reč*, br. 250, 10. 2. 1985., 6; kurziv S. M.).

Zašto je ovakvo tematiziranje pitanje Kosova zavodljivo i opasno? Zavodljivo je zato što se »prodaje« kao »čista nauka«, a opasno zato što podudara sa buđenjem jednog agresivnog resentimana u našoj zemlji. U nekim sredinama, i u nekim društvenim slojevima, u blažoj i jačoj formi širi se desničarsko, reakcionarno i nacionalističko raspoloženje. Ovaj resentiman najuočljiviji je u intelektualnim krugovima i institucijama određenog profila, ali se ono rasprostire i društvenim slojevima kojima socijalizam nikada nije bio na srcu, a koji su danas dobili šansu da javno ili polujavno propovedaju svoje »razočaranje« u jugoslovenski socijalizam. Ove reakcionarne snage, pojedinačno ili kao »udružena opozicija«, već su otvoreno nastupile protiv temeljnih tekovina socijalističke revolucije. U ovom kontrarevolucionarnom resentimanu Bogdanovićevo *Knjiga o Kosovu* pliva kao ri-

ba u vodi. Ona je, dakle, neposredni izraz restauratorskih težnji nazadnjačkih ideologija. Staviše, knjiga ne pokazuje samo prisutnost već i osiljenost i drskost tog resentimana. To što je *Knjiga o Kosovu* opšte objavljena, danas i ovde, iskazuje samopouzdanje i određenu moć srpskog nacionalizma: on danas može javno da zastupa alternativnu političku platformu o Kosovu i u krajne radikalnim i arhireakcionarnim tezama, kakve su one Bogdanovićeve.

U konkretnom slučaju uzroci kolonizacije vide se, pored ostalog, u teškom položaju Albanaca u pasivnim, gorskim područjima na kojima su živeli i što ih je prinuđivalo da se u uzastopnim migracijama, kreću u plodna, ravničarska područja (Metohija, Kosovo, Polog itd.), potiskujući pritom, često ne birajući sredstva, slovenski živalj. Bogdanović, naprotiv, društveno-ekonomskim uzrocima kolonizacije pridaje manji značaj, i prihvata tezu Vase Čubrilovića da je glavni razlog kolonizacije političkog karaktera. »Turci su, naročito od početka XVIII veka iz političkih i strategijskih razloga pomagali kolonizaciju muslimana (čitaj: Albanaca; Š. M.) na osetljivim tačkama i pravcima«. (*Knjiga o Kosovu*, 124). Tursko-albanska koalicijska stvarila je onaj čuveni Čubrilović »albanski klin« kojim su »albanski doseljenici kao živi bedem razdvojili jugoslovensko stanovništvo na severu od onog na jugu«. (*Knjiga o Kosovu*, 125). Slijepčević, naprotiv, iako ističe zaštitu i pomoć turskih vlasti, u albanskoj kolonizaciji ne vidi »deo neke planske politike Carigrada« (Slijepčević, 95).

Uzroci kolonizacije određuju i uzroke iseljavanja Srba sa Kosova i iz drugih oblasti. »Iseljavanje Srba i ostalih balkanskih Slovena iz njihovih

zemalja nije prirodan proces, na čemu se danas sa toliko jednostranosti insistira, već rezultat nasilja koje je nad njima bilo izvršeno«. (*Knjiga o Kosovu*, 264). Dakle, za Bogdanovića, glavni uzrok iseljavanja Srba sa Kosova u periodu od XVIII do XX veka jeste upravo tursko-albanska politika denacionalizacije slovenskih teritorija, i »nasilja kao njen vid i metod«, »koje po svojim obeležjima i razmerama ima karakter genocida«. (*Knjiga o Kosovu*, 125; *Savremenik* 12/1982, 536).

Okarakterisavši ove istorijske procese kao *genocid* izvršen nad srpskim narodom (genocid koji, prema njemu, kontinuirano traje, sa malim prekidom za vreme Kraljevine Jugoslavije, do naših dana), Bogdanović doseljennom albanskom življu na Kosovu, uključivši tu i današnje naraštaje, nameće trajnu hipoteku krivice zbog toga što su nasilnim putem, uz pomoć Turaka, uzurpirali Kosovo, »svetu zemlju srpskog naroda« (*Knjiga o Kosovu*, 266). S druge strane, gaženje prava potištenog srpskog naroda, koji je nasiljem isteran sa svoje zemlje, ne sme prema Bogdanoviću, ostati nesankcionisano. Zato on i podiže optužnicu protiv Albanaca sa Kosova, navodeći dugačak spisak zločina koji su u prošlosti izvršili njihovi preci, ob-

narodujući time jednu »zaista krajnje surovu istoriju tursko-albanskog genocida nad srpskim narodom u toku poslednjih stotinu do dvesta godina« (*Knjiga o Kosovu*, 4). U završnim razmatranjima u knjizi, Bogdanovičeva optužnica istorijske procese povezuje u jednu smislu celinu, u kojoj se prošlost i sadašnjost susreću u apelu za poštovanjem istorijske pravde, odnosno u zahtevu da se preduzmu sankcije protiv uzurpatora srpskih zemalja, a prema načelu *klin se klinom izbijaja*: »Logika po kojoj su za status jedne oblasti presuda samo aktuelna stanja i demografski odnosi bez obzira na to kako su i kada, i u kojim uslovima ta stanja nastala i ti odnosi uspostavljeni — ne može se prihvatiti ni sa humanog, ni sa moralnog ni sa istorijskog stanovišta. Pravo srpskog naroda da živi na svojoj zemlji osporeno je najpre dugotrajnim nasiljem u uslovima turskog ropstva, naročito u XVIII i XIX veku, nasiljem koje po svojim obležjima, razmerama i posledicama ima karakter genocida. Isticanjem demografskog stanja na Kosovu i tvrdnjom da su u pitanju albanske zemlje zato što ih danas velikim brojem naseljava albanska narodnost, ignoriše se činjenica da na toj zemlji, pre svega, živi i srpski narod, i to kao na

svojoj centralnoj i matičnoj istorijskoj zemlji, te da nema prekida u odnosu Srbije prema Kosovu kao srpskoj nacionalnoj teritoriji, niti prekida u borbi za oslobađanje kosovskih Srba i njihov zajednički život sa drugim delovima srpskog naroda. Bez uvažavanja stvarnih istorijskih okolnosti moglo bi se desiti da budu ozakonjene posledice genocida. Time bi, razume se, u samim osnovama bilo narušeno etničko načelo. U ime prava albanske nacionalne manjine na »samoopredeljenje do otcepljenja« bilo bi sankcionisano nasilje nad jugoslovenskim narodima i pogaženo njihovo pravo na samoopredeljenje, pravo da žive slobodno i suvereno u svojoj državi, na svojoj zemlji«. (*Knjiga o Kosovu*, 272—273; upor. i *Sljepčević*, 417).

Mada se u ovom podužem citatu oštrica Bogdanovičevog napada usmerava prvenstveno na neosnovane aspiracije albanskog nacionalizma i iredentizma, jedina intencija toga napada nije ta da se utvrdi kako albanski nacionalizam nema prava, već i to da Albanci sa Kosova, kao nacionalna manjina, nemaju nikakvog ni moralnog ni istorijskog prava da Kosovo smatraju svojim zavičajem i svojom zemljom, zato što na toj zemlji žive po ne-pravu, jer je on tuđa, uzurpirana od njiko-

vih predaka, a uzurpira se i dan-danas, pa bi im se, ako bi se poštovao sud istorijske pravde, mogla dati i šut-karta, da iz nje budu prognani.

XI. Razume se, Bogdanović nije nigde izričito rekao da Albancima treba oduzeti pravo da žive na Kosovu. Štaviše, u svojim napisima on uvek ostavi malo mesta da kaže kako je uspostavljanje dobrih odnosa između srpskog i albanskog naroda njihova »jedina istorijska alternativa« (vidi intervju u *Studentu*, 9). A drugom prilikom, na pitanje kakva je poruka istorijskih saznanja o Kosovu, odgovara: »Poruka je prilično jednostavna: mi živimo u istom prostoru i delimo jednu zemlju, koje ima dosta i za Srbe i Albance. U međusobnoj trpljivosti i poštovanju ljudskih prava, u ostvarivanju civilizacijskih standarda tih prava i u zakonitosti koja je pretpostavka svake i svačije slobode, jedina je perspektiva da se iz jedne stvarne konflikte situacije izade bez štete po narod, koji je u takvim sukobima svagda najveći gubitnik«. (*Književna reč*, br. 272, 10. 2. 1986, 19). Ali, kada se gleda celina Bogdanovićevih pogleda, čovek stekne utisak da on jedno kaže, a drugo misli. Naime, jedina alternativa i jedina perspektiva o kojoj on govori pojavljuje se može biti i u samoj citiranoj izjavi sa zadr-

škom, sa uslovom, da se prethodno namiri šteta narodu koji je u istorijskim sukobima svagda bio najveći gubitak!

I sledeći tu logiku namirenja štete gubitničkom narodu, možda nismo daleko od istine ako konstatujemo da je uslov za pomirenje Srba i Albanaca, odricanje ovih drugih od prava na autonomiju Kosova. Ni ovaj uslov ne formuliše Bogdanović u izričitoj formi, već indirektno. Jedno polaganje u njegovoj knjizi posvećeno je pitanju autonomije Kosova i zaključak je tu negativan: albanskoj manjini ni po kojem osnovu nije trebalo priznati pravo na autonomiju u okviru SR Srbije. Jer, albanska manjina ponela se *nelojalno* prema jugoslovenskoj državi u II svetskom ratu (*Knjiga o Kosovu*, 211). Albanci nisu uzeli aktivnog učešća u NOR, sem malog broja komunista, povratnika iz Albanije ili članova KPJ, koji su imali malog uspeha da pridobiju albanske mase na Kosovu, neprijateljski raspoložene prema Jugoslaviji i oslobodilačkom pokretu. No, i pored te nelojalnosti albanske manjine »Kosovo i Metohija ulaze u novu Jugoslaviju kao autonomna oblast sa perspektivom dalje nacionalne afirmacije i osamostaljivanja Albanaca u socijalističkom sistemu jugoslovenske federacije«.

(isto). Nakon rata »sudbina mađarske i albanske manjine« nije rešavana jednako kao sudbina nemačke nacionalne manjine, koja je iseljena u Nemačku, mada su i ove dve manjine bile skoro jednako nelojalne kao ona nemačka. »Stvarni odnos ovih manjina prema jugoslovenskoj državi u ratu 1941—1945. i njihovo određeno angažovanje u sistemu okupacije i dezintegracije države jugoslovenskih naroda, nisu uzeti u obzir prilikom uređenja njihovog pravnog položaja u novoj Jugoslaviji«. (*Knjiga o Kosovu*, 237).

Zašto su albanska i mađarska manjina u novoj Jugoslaviji dobili poklon koji nisu zaslužili? Razlog je, prema Bogdanoviću, pogrešna, antisrpska politika Komunističke partije Jugoslavije. Zbog toga je on veoma kivan na jugoslovenske komuniste. A zapravo, sve je počelo sa Tucovićevom izdajom nacionalne stvari, kada je nekritički preuzeo tuđa, austro-marksistička shvaćanja o nacionalnom pitanju. »U osnovi Tucovićevih pogleda leži, zapravo, ta zabluda, to otpisivanje Kosova. (...) O »prodoru Arbanasa na istok« on razmišlja kao o jednom prirodnom procesu; za tragične strane tog zbivanja, po njemu, snosi odgovornost isključivo »sistem vladavine u Turskoj, opšta anarhija uprave i nezaštićene raje«.

(*Knjiga o Kosovu*, 213; upor. i Slijepčević: »Srpskim socijalistima nedostajala je konstruktivna nacionalna koncepcija i zdrava nacionalna ideja«, ili: »Oni (socijaldemokrati, Š. M.) nisu shvatili prirodno pravo srpskog naroda da se oslobodi i ujedini na celom svom istorijskom i nacionalnom prostoru«. 309). I upravo su Tucović i srpski socijaldemokrati odredili kasniji stav KPJ prema albanskom pitanju: »Pogledi srpske socijaldemokratije na albansko pitanje ugrađeni su temelje KPJ od njenog osnivanja 1919«. (*Knjiga o Kosovu*, 215). Stoga se u predratnom periodu KPJ javlja kao saveznik Albanaca u borbi protiv Jugoslavije (*Knjiga o Kosovu*, 211; Slijepčević, 307). KPJ stoji na stanovištu da su Kosovo i Metohija, pa čak i Sandžak, u stvari »albanska zemlja«, a to će se stanovište održati i kasnije, sa malim korekcijama, što je onda, nakon rata, rezultiralo davanjem autonomije Albancima, i to autonomije koja je stalno proširivana, najpre sa zamenicama sopstvenog suvereniteta i posebne državnosti, a nakon 1966. i sa donošenjem ustava 1974. godine, mada su ustavne formulacije dvosmislene i kompromisne, i faktički punu državnost i suverenitet. Time se, za Bogdanovića, »pokazalo da problem Kosova i nije

na prvom mestu pitanje neprijateljske delatnosti i kontrarevolucije već mnogo više od toga — problem konstituisanja Pokrajine kao oblika albanske državnosti sa težnjom

ka formiranju samostalne republike u jugoslovenskoj federaciji» (*Knjiga o Kosovu*, 242).

Shkëlzen Maliqi

Rozhe Garodi

MENDIMI I HEGELIT

Rihindja, Prishtinë, 1983,
fq. 247 (Përktheu nga frë-
ngjishtja Muhamedin Ku-
llashi)

Rozhe Garodi, filozof bashkëkohor marksist francez, në këtë vepër na paraqet një studim të plotë e sistematik të pikëpamjeve filozofike të Hegelit. Në mënyrë të shumanshme dhe të suksesshme ndriçon aspekte të veçanta të mendimit kompleks të Hegelit.

Libri përmban pesë kapituj. Atij i paraprin një fjalë e rastit, e shkurtër, por e thukët dhe e qëlluar e shqipëruesit (M. Kullashi), ndërsa në fund është dhënë kronologjia e jetës së Hegelit dhe një regjistër i termave të përkthyer.

Në kapitullin e parë *Jeta dhe çështja e Hegelit*, autori bën fjalë për rrethanat shoqëro-politike e historike të lindjes së veprave të Hegelit, ku posaçërisht theksohet rëndësia e Revolucionit francez të vitit 1789, si dhe e ngjarjeve që pasuan për formimin e mendimit filozofik hegelian.

Revolucionin në fjalë Hegeli e përjeton si përpjekje që njëmendësinë »e pavlerë dhe jonjerëzore« (të shoqërisë feudale), ta zëvendësojë një njëmendësi e re, më humane (e shoqërisë borgjeze). Më tej ai konstaton edhe kundërthëniet e kësaj njëmendësie të re dhe flet për mundësinë që ato të kapërcehen, jo në mënyrë revolucionare, si e kërkon filozofia marksiste, por në kuadër të rendit ekzistues, në kuadër të shtetit (të një monarkie kushtetutare prusiane), që do të ishte njëmendësim i së drejtës e moralit, harmonizim i interesave personale dhe shoqërore.

Kapitulli i dytë që ritullohet *Metoda e Hegelit*, i kushtohet gjenezës dhe thelbit të metodës dialektike hegeliane. Sipas autorit, metoda në fjalë nuk është vetëm përkryerje e përpjekjeve të paraardhësve filozofikë të Hegelit, por edhe shprehje e nivelit të arritur të zhvillimit të shkencave dhe e

kushteve shoqëro-politike e historike të epokës, në të cilën jeton ai.

Në vazhdim Garodi bën fjalë për tërësinë, si njërin ndër nocionet më të rëndësishme të metodës hegeliane. Tërësia, në kuptimin dialektik, nuk është ndonjë harmoni e thjeshtë, por sintezë e unitetit dhe e negativitetit. Metoda shpreh strukturën e tërësisë organike, e cila nuk mund të kuptohet në mënyrë statike, por në lëvizje, në formim e sipër, si e gjallë. Metoda e njohjes, po ashtu, është dialektike, me çka flakët mundësia e intuitës së drejtpërdrejtë ndijore dhe e izolimit absolut të një nocioni. Mirëpo, për të arritur diturinë absolute, Hegeli supozon lëvizjen rrethore, përkatësisht, identitetin e njëmendësisë dhe të të menduarit. Me këtë konstatohet veçoria themelore e metodës hegeliane — se metoda nuk është e jashtme ndaj objektit. Metoda nuk është vetëm mjet për të arritur njohjen, por është edhe vetë mendja, e cila e gjen veten dhe përsëri e njeh vetvetën në çdo gjë.

Në kuadër të këtij kapitulli bëhet fjalë edhe për kundërthënien, si njërin ndër veçoritë themelore, forcën lëvizëse apo shpirtin e metodës hegeliane. Në vazhdim Garodi shpjegon se për Hegelin dialektika është logjikë e relacionit, e konfliktit, e lëvizjes dhe e jetës (finalitetit), për të përfun-

duar me konstatimin se metoda dialektike hegeliane është krijuese, »ligj i zhvillimit të qenies dhe lëvizje e njohjes«.

Këtë kapitull Garodi e përfundon me konstatimin e karakterit kundërthënës edhe të vetë metodës hegeliane. Metoda e Hegelit përfundon në ndërtimin e një sistemi konservator, i cili e justifikon regjimin e vendosur, por ajo në thelb është revolucionare, »në të shprehet dinamizmi i një epoke në të cilën doli në shesh karakteri i përkohshëm dhe i ndryshueshëm i institucioneve sikundër edhe i mendimeve« (fq. 50).

Në kapitullin e tretë *Dialektika e njohjes: Fenomenologjia e frymës*, autori paraqit idetë thelbësore të veprës së parë e shumë të rëndësishme të Hegelit »Fenomenologjia e frymës«. Ai shpjegon se Hegeli për t'iu kundërvënë pikëpamjeve subjektivisteprioriste të Kantit, apo transcendentalistë të Shelingut, njohjen e kupton si proces kontradiktoriale dhe të ndërlikuar dialektik. Për Hegelin nuk ka hendeke të pakapërcyeshëm, si te Kantit, midis »gjësë — në — vete« (thelbit) dhe »gjësë — për — ne« (dukurisë). Sipas tij ky është vetëm dallim në shkallën e arritur të njohjes. Njohja e »gjësë — në — vete« është njohje tërësore e dukurisë.

Garodi, me të drejtë, konstaton se Hegeli, duke iu kundërvënë pikëpam-

jeve të njëanshme të paraardhësve të vet, *dha modelin sesi duhet të zgjidhet çështja e njohjes*. Qëndrimi themelor i filozofisë hegeliane nisët nga teza e mundësisë së njohjes së botës, por që nuk arrihet përmes një akti momental. Njohja është proces i gjatë e i ndërlikuar dialektik. Autori i studimit në fjalë, në vazhdim duke bërë fjalë për këtë vepër të Hegelit, konstaton se ai aty zhvilloi edhe shumë ide të rëndësishme, ndonëse në mënyrë abstrakte dhe spekulative. Ndër këto ide duhet të theksohen këto: *idenë se bota e njeriut është vepër e tij; idenë se s'ka asgjë në këtë botë që të mos jetë e kapshme për mendjen e njeriut; idenë e tjetërsimit dhe se liria e njeriut qëndron në tejkalimin e këtij tjetërsimi dhe idenë se historia e njeriut është histori e çlirimit të njeriut*.

Dialektika e qenies: Logjika është titulli i kapitullit të katërt të këtij studimi të Garodit. Këtu përpunohen veç e veç që të trija pjesët e Logjikës së Hegelit: Teoria e qenies, Teoria e thelbit dhe Teoria e nocionit, duke theksuar unitetin dialektik të qenies dhe të mendimit. Duke iu përmbajtur kësaj teze, klasikun gjerman flak si të paqëndrueshme pikëpamjet dogmatike: të *metafizikës tradicionale* (që njëmendësinë e kupton si të dhënë, të gatshme, të përkryer);

të *empirizmit* (që ka të përbashkët postulatën e ekzistimit të një bote të përkryer, por të kuptuar si ndijore) dhe të *kriticizmit kantian* (që shkaputet nga dogmatizmi i dy të parëve, por që nuk është në gjendje të kapërcejë dyjsinë e subjektivitetit dhe të objektivitetit).

Garodi vëren me të drejtë rëndësinë e konsiderueshme të materialeve që Hegeli i huazon nga të arriturat shkencore të kohës së tij për t'i përpunuar kategoritë dhe për të paraqitur lëvizjen e ligjet e saj. Sipas tij tema më e rëndësishme e pjesës së parë të Logjikës (Teoria e qenies) dhe pa dyshim e tërë Logjikës e sistemit hegelian, është ajo ku bëhet fjalë për ligjin dialektik të kalimit të cilësisë në sasi, për veprimin e ndërsjellë si dhe unitetin dialektik të të kufijshmës dhe të pakufijshmës. Në pjesën e dytë të Logjikës Hegeli zhvillon kundërthënien, parimet dialektike kundruall atyre formalo-logjike etj., vlerën e vërtetë të të cilave e kuptojmë gjatë shpjegimit të raporteve dialektike të dukjes e të qenies, të thelbit e të dukurisë, të së tërës e pjesës, të domosdosë e rastësisë, të shkakut e pasojës e kështu me radhë.

Merita më e madhe e Hegelit qëndron edhe në faktin pse ai e vuri në pah karakterin formal të logjikës së deriatëhershme, në pjesën e tretë të Logji-

kës (Teoria e nocionit). Format e të menduarit nuk i studion përballë njëra-tjetrës, por »në lidhmërinë e tyre të domosdoshme dhe kalimin prej njëres në tjetrën«. Garodi thekson edhe disa mendime të rëndësishme të Hegelit, si, bie fjala, *idenë e veprimit të ndërsjellë midis qëllimeve e mjeteve* (se qëllimi i prodhon mjetet, e mjetet nxisin qëllime të reja), *midis njohjes e veprimit* (nuk ka veprim pa njohje, e as njohje pa veprim) etj.

Kështu autori kapitullin e katërt e përfundon me konstatimin se *Logjika e Hegelit, pavarësisht nga karakteri spekulativ e idealist, pati rëndësi të madhe për zhvillimin e mendimit shkencor modern*. Ai pajtohet me mendimin e Leninit të shfaqur në »Fletoret filozofike«, se »Ideja e lëvizjes së përgjithshme dhe e ndryshimit (1813, është fjala për dialektikën hegeliane të paraqitur në »Logjikë« — Xh. Xh.) është hetuar para zbatimit të saj në jetë dhe në shoqëri. Ajo u shpall për shoqëri (1847, mendohet në »Manifestin e partisë komuniste« të Marksit e Engelsit — Xh. Xh.) para se të provohej në zbatimin e saj mbi njeriun (1859, kur doli »Origjina e llojeve« e Darvinit — Xh. Xh.)« /fq. 183/.

Humanizmi i Hegelit është kapitulli i pestë dhe i fundit i këtij studimi, ku Garodi, duke i shpalluar idetë themelore të

Hegelit, të shfaqura ndër veptra të ndryshme (»Filozofia e historisë«, »Historia e filozofisë«, »Estetika« apo ndonjë tjetër), vë në pah ndjenjën e thellë të tij për historinë. Ndonëse idealizmi e shpie Hegelin ta përmbysë rendin e njëmendësisë, »të nxjerrë apriori historinë nga logjika, në vend se ta nxjerrë logjikën nga një studim i hollësishëm i historisë« /fq. 193/, pikëpamja e tij mbi historinë del shumë më e lartë se e filozofëve të deriatëherëshëm, qofshin ata edhe materialistë.

Historia, për Hegelin, nuk është »grumbull i çfarëdo pikëpamjesh«, por është zhvillim i domosdoshëm. Ajo u nënshtrohet ligjeve, përkatësisht është shkencë. Garodi i shkoqiti këto karakteristika themelore të pikëpamjes së Hegelit mbi historinë:

1. Hegeli e zhvillon një pikëpamje të mëvetësishme mbi historinë, duke e kuptuar atë si rezultat të veprimit dhe të punës së njerëzve. Historia nuk është vepër e individëve, e heronjve, por është vepër e popujve, pikërisht e punës së akumuluar të tyre. Ai e hetoi se kjo punë është punë »e tjetërsuar«, ndonëse nuk e ndriçoi burimin e këtij tjetërsimi.

Hegeli u përpoq ta zgjidhte drejt edhe çështjen e rolit e të individëve e të personaliteteve »të mëdha« në histori. Sipas tij, individët nuk e bëjnë historinë, nuk kanë fuqi ta

ndërrojnë në mënyrë arbitrare rrjedhën e saj, por janë »të mëdhenj«, ngase hetojnë nevojat e kohës dhe u përgjigjen atyre.

2. Ideja e kundërthënies, e luftës që përmban në vete zhvillimi, është karakteristikë tjetër e rëndësishme e pikëpamjes së Hegelit mbi historinë. Historia nuk mund të shpjegohet thjesht me ndryshime sasiore e mekanike, si evolucion linear. Ndryshe nga paraardhësit e tij, thotë Garodi, »Hegeli e shikon përparimin në një mënyrë dialektike me kundërthëniet e tij, me krizat, me luftërat dhe me revolucionet e tij« /fq. 188/.

3. Hegeli kur flet për trajtat e ndryshme të vetëdijes shoqërore (»të frymës«, artin, fenë dhe filozofinë) vazhdimisht thekson veprimin e tyre të ndërsjellë. Ai shkon aq larg sa që heton »shumë mirë marrëdhëniet e varësisë midis kërkesave ekonomike, teknike dhe strukturave politike« /fq. 190/.

Këto teza dhe shumë teza të tjera, konstaton Garodi, »Hegeli, fatkeqësisht, i kompromiton duke i interpretuar në mënyrë idealiste dhe dogmatike« /fq. 192/. Kjo frymë konservatore mund të hetohet edhe kur ai bën fjalë për qëllimin e historisë. Qëllimi i historisë është liria (te Hegeli »vetëdija për lirinë«), e cila njëmendësohet në shtet. Në shtet, në një monarki ku-

shtetutare (prusiane) të tipit napolenian, duhet të arrihet »pajtimi« i lirisë subjektive dhe i lirisë objektive, i individit dhe i shoqërisë. Ndonëse heton kundërthëniet e shoqërisë borgjeze, ndonëse pikëpamja e tij mbi historinë është humaniste, ai na paraqitet si mbrojtës i interesave klasore të borgjezisë e humanizmi i tij është i kufizuar, i mbyllur ndaj ardhmërisë.

Në vazhdim, pasi bën fjalë gjerësisht për artin, fenë e filozofinë si trajta të frymës absolute, Garodi konstaton kundërthënien themelore të filozofisë hegeliane — kundërthënien midis metodës dhe sistemit. Nga kundërthënia në fjalë mund të nxirren interpretime të ndryshme. Ja katër grupe kryesore të këtyre interpretimeve:

Në grupin e parë bëjnë pjesë përfaqësuesit konservatorë të të djathtës hegeliane, të pangjermanizmit dhe të fashizmit totalitar, që sistemin e Hegelit »e kuptojnë si ideologji të justifikimit të asaj që është« /fq. 232/.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë rrymat e disa ideologëve protestanë, madje edhe katolikë, që i kanë përvetësuar këto justifikime të sistemit të Hegelit lidhur me pikëpamjen mbi zotin.

Në grup të veçantë hyjnë interpretimet e ndryshme eksistencialiste, të cilat përvetësojnë vetëm një moment të mendimit

të Hegelit, madje pikërisht vetëdijësimin për kundërthënien, pikëpamjen tragjike mbi botën e njeriut, duke e flakur sistemin dhe unitetin, »pajtimin« e kundërthënies.

Rryma e marksizmit përbën grupin e fundit të këtyre interpretimeve të filozofisë hegeliane. Sipas Garodit, në marksizëm u mundësua tejkalimi i vërtetë i Hegelit, pikërisht duke u bazuar në metodën dialektike të tij. Materializmi filozofik i Marksit integron në vete kontributin e pasur hegelian. Natyrisht, kjo filozofi nuk ka për qëllim të arrijë vetëdijen absolute (si të Hegeli), por të bëhet një moment i vetëdijëimit të botës dhe i ndryshimit të saj (këtë Garodi e ilustron me Tezën e Njëmbëdhjetë të Marksit mbi Fojerbahun).

Në fund të këtij kapitulli dhe të veprës Garodi thekson faktin e madhështisë së veprës së Hegelit, kur thotë se ai »duke ia zbuluar njeriut faktin se është vetëkrijues i vetvetës dhe duke zbuluar ligjin dialektik të zhvillimit të çdogjëje, ishte, përkundrazi tendencave të tij konservatore, paralajmërues i shtrëngatës« /fq. 241/.

Nga kjo që u tha mund të përfundojmë se Garodi, duke pasur qëndrim kritik të një marksisti, përkujton jo vetëm ma-

dhështinë e mendimit të Hegelit, por edhe lëshimet e të metat e tij. Në këtë studim bëhet fjalë edhe për ndikimin që ushtroi ky »gjeni enciklopedik« në Marksine dhe në filozofinë marksiste, si dhe në filozofinë pas-hegeliane përgjithësisht.

Garodi në këtë vepër, përmes një interpretimi materialist marksist, përmes një analize dialektike, paraqet mendimin kompleks dialektik hegelian, edhe temat më delikate të filozofisë së Hegelit i bën të afërta për lexuesin, ndërsa mendimin e vet bazë e zhvillon në mënyrë të përshtatshme dhe të argumentuar.

Si i tillë, ky libër plotëson një zbrazëti të kahershme që ndihej ndër ne për njohjen e veprës së Hegelit. Mbetet si detyrë e obligim yni përkthimi i veprave origjinale të këtij klasiku gjerman, ndonëse ajo do të jetë një punë delikate dhe e vështirë, meqë kërkon përkushtim të madh dhe njohje të mirë filozofike. Shënimin, për këtë vepër, nuk do ta përfundoja pa theksuar edhe një element shtesë të cilësisë të këtij botimi në gjuhën shqipe, e ky është përkthimi shumë i suksesshëm i Muhamedit Kullashit.

Xhafer Xhaferi

Erih From

»IKJE NGA LIRIA«

Rilindja, Prishtinë, 1981
Përkthyes Eqrem Basha
Autor i parathënies Muhamedin Kullashi

E shkruar para gati gjysmë shekulli, »Ikje nga liria« e Erih Fromit është një vepër, vlera, qartësia dhe thellësia mendore e së cilës i tejkalon suazat e kohës për të cilën ishte shkruar.

I arsimuar në dialogun intelektual me Marks-in dhe Froj-din, Fromi e riaktualizoi vlerën themelore të trashëgimisë filozofike të Marks-it mësimin e tij mbi tjetërsimin si fenomen themelor të parahistorisë njerëzore, duke e »takuar« këtë me psikoanalizën frojdiane. Mirëpo, derisa Frojdi ishte psikoanalitik i patologjisë shpirtërore individuale, e cila, sipas tij, bashkëlind me frustrimet e pavetëdijshme seksuale fëmijënore, Fromi ishte psikoanalitik i traumave kolektive, i patologjisë sociale (si interaksion i shoqërisë së sëmurë dhe i individit të sëmurë), trauma të cilat bashkëlindën me të paraqiturit e protes-tantizmit dhe të një botëkuptimi postmesjetar politiko-sho-

qëror. Një frymë e tillë »diagnostike« — medicinale në të shtruarit e çështjes bazë të kësaj vepre është tejet normale, kur dihet se nocioni strumbullar i rrymimeve mendore të Fromit në debynë e tij është tjetërsimi.

Studimit të problematikës së tjetërsimit Fromi i qaset në mënyrë multidisiplinare, nga aspekti ideologjik, ekonomik dhe psikologjik. Këtu vërehet tentimi i tij që t'u ikin njëanshmërive të shprehura në pikëpamjet e bashkëkohanikëve, të cilët vetëm në faktorin psikologjik, apo vetëm në atë idologjik-ekonomiko-politik (sidomos në raportin mimetik ndërmjet bazës ekonomike dhe superstrukturës juridiko-politike), shihnin shkakun e lëvizjeve aktuale regresive shoqërore. Paraqitja e nazifashizmit në historinë evropiane shkatërroi »optimizmin e vetëkënaqësisë« dhe iluzionin mbi përparimin eskatologjik kah një bashkësi njerëzore

vërtetë demokratike. Racionalen e zëvendësoi iracionalja dhe instiktivja. Shpresën për ekzistencën e lumtur e »mbyti« frika për ekzistencën si të tillë.

Në një dialog intelektual me paqartësitë e kohës, e cila solli »idhuj« të rinj dhe »ideale« të reja, Fromi shkroi »Ikjen nga liria«, ku u mundua t'i ikte shpejtësisë nekrofile të kohës, duke vënë re shkaqet e një krize aq të madhe të ekzistencës evropiane dhe botërore, e cila anonte kah realizimi i profetizimit të Shpenglerit. Në parathënien e veprës »Shoqëria e shëndoshë«, Fromi shkruan: »Në atë libër (»Ikjen nga liria« — vërejtja jonë) jam munduar të tregoj se lëvizjet totalitariste i përgjigjen tendencës së rrënjësuar thellë për të ikur nga liria të cilën njeriu e arriti në botën moderne; ai njeri bashkëkohor i çliuar nga prangat mesjetare, nuk ishte i lirë që të ndërtonte jetë përmbajtësore, të bazuar në arsye dhe dashuri, për ç'shkak kërkoi sigurinë e re duke iu nënshtruar udhëheqësi, rase ose shteti«.¹

Fenomenet e »dihotomive ekzistenciale«, të lirisë dhe të individualizimit të njëmendët Fromi historikisht i ndërlihd me paraqitjet e protestantizmit dhe kapitalizmit. Në Mesjetë mungesa e li-

risë ishte pasojë e urdhëresave religjioze-morale-politike të autoritetit të jashtëm, urdhëresa këto të cilat kishin karakter obligues, ndërsa mosrespektimi i tyre rezultonte me humbjen e entitetit fizik (shkatërrimi truporgjë që vlen sidomos për periudhën e katolicizmit mesjetar-gjegjësisht, formës ekstreme të tij-inkuizicionit), apo të atij shpirtëror-humbja e »parajsës« që shtrihej që nga stërmëkati i Adamit, ndërrit apo e vendit në hierarkinë e shtetit mesjetar feudal. Kalimthi mund t'i rikujtojmë dhjetë urdhërat në religjionin krishter, pesë deri në dhjetë virtytet negative të përcaktuara të sjelljes morale në jetën shoqërore te budizmi, apo ligjet e llojllojshme, esenca e të cilave shprehej me ndalesë të veprimit kundër dispozitave të tyre dhe me sanksionimet eventuale.

Renesanca solli kuptimësinë mbi dallimin ndërmjet »Unë« dhe »Ti« ose »Ata«, arritje kjo e cila në dukje mundëson iniciativën personale si në formë të besimit *subjektiv* religjioz, apo në trajtë të aktivitetit *individual* ekonomikopolitik, fenomene këto të cilat premtinin vetërealizimin e aftësive gjenerike njerëzore. Kufijtë e jashtëm institucionale (kisha katoli-

¹ Erih Fron »Zdravo društvo« IRO »RAD«, Beograd, 1983, faqe 25.

ke, shteti feudal), humbën rolin suprem që kishin, mirëpo Fromi vëren kufizimet e një »pakufijshmërie« të tillë në vlerën e dyshimtë të »initiativës« individuale, në pamundësinë e vetërealizimit të vetë-vetëdijshtëm njerëzor. Kështu, kalvinizmi (si një nga variantat e protestantizmit), predikon *predestinimin* hyjnor në drejtim të veçimit radikal midis atyre që e »meritojnë« parajsën me ditën e lindjes dhe të tjerëve që do ta »fitojnë« ferrin edhe pse nuk kanë bërë mëkate të mëdha. Këtu besimi, iniciativa, aktiviteti nuk çojnë përshë. Çdo gjë është e njohur me lindjen e individit. Mirëpo ai *nuk di për fatin e tij*. Duke vërejtur fatalizmin e një doktrine të tillë, joegalitariste religjioze, kalvinizmi thekson veçoritë të cilat konfirmojnë se individi është i paracaktuar për parajsë. Këto janë: »Thjeshtësia, të përmbajturit, drejtësia në kuptimin që secili t'i jepet ajo që i takon sipas meritës dhe devocioni, i cili e bashkon njeriun me zotin«, e para së gjithash *suksesi* në jetën laike. »Suksesi u bë shenjë e mëshirës së zotit; mossuksesit-shenjë e mallkimt«. (»Ikje nga liria« — faqe 90).

Mirëpo konkurrenca gllabëruese në sferën religjioze, e shumë më tepër në atë ekonomike-laike, lind pasigurinë, shqe-

tësimin, frikën nga çdo ditë e re, madje rikujtohën »kohërat e vjetra dhe të mira«. Individi u bë më i vetmuar, më i izoluar, u bë vegël në duart e forcave të papërbalueshme jashtë tij; u bë »individ«, por i hutuar dhe i pasigurt«. (faqe 112). Mesjeta nuk ofronte lartësi të mëdha marramendëse, mirëpo ajo siguronte së paku një bazë solide, ndërsa koha e re ofron eksperimente prej suksesit të jashtëzakonshëm (i cili është vetëm një përjashtim që e vërteton rregullin), deri te bankrotimi i plotë ekonomikointelektual. »Individi ishte lënë në fatin e vet; gjithçka varej nga përpjekja e tij personale, e jo nga siguria e pozitës së tij tradicionale«. (faqe 62.)

Te luterizmi konformimi i parimit të *lirisë nga kisha* dhe të individualizmit është aksiomë për nënshkrimin individual ndaj zotit, për vetëpërpjekje, vetakuzim, vetëvrasje shpirtërore, subordinim i cili bazohet në pafuqinë e njeriut por edhe në dashurinë eventuale ndaj absolutit. »Ai (individi — vërejtja jonë), gjen një siguri të re dhe delikate me çmimin e flijimit të integritetit të unit të vet personal, sepse nuk e duron dot vetminë. Kështu liria — si liri nga — të çon në një robëri të re«. (faqe 222). Pseudointividualizmi luterian vërehet

edhe në këto fjalë të tij: »Njeriu që i është drejtuar zotit nuk e ka vullnetin e lirë (këtu Luteri polemizon me Skotusin, Billin, Okamin), por është skllav, rob dhe shërbëtor ose i vullnetit të zotit ose i vullnetit të sotonës«. (faqe 76). Kështu Luteri gjeti »zgjedhje« për qenien mëkatore dhe të pafuqishtme në *besimin subjektiv* ndaj zotit, akt i cili mbisundon pavalershmërinë njerëzore, veprim i cili shkatërron *unin personal*.

Një patos të tillë intelektual e përqafojnë edhe »Sokrati danez« Kjerkegoti, i cili esencën e religjionit të krishterë e sheh në besimin subjektiv, në relacionin e drejtpërdrejtë *njeri-zot*, duke përjash-tuar ndërmjetësuesin institucional — kishën dhe priftërinjtë.

Fromi nuk e konteston rëndësinë e Renesancës, e cila vuri në spikamë veçantinë e njeriut në raport ndaj natyrës dhe njerëzve të tjerë. Mirëpo, ky e vëren »anën e errët të hënës« në momentin që sado që në dukje religjioni i tillë dhe politika — ekonomia e re insistuan dhe proklamuan individualitetin e njeriut si themel të ekzistimit të tyre, këta në të vërtetë shterrën frymëmarrjen e in-

dividualitetit dhe shkrinë subjektivitetin në sferën e objektivës imagjinare-zotit, apo të objektivës reale-sistemit ekonomiko-politiko-juridik.

Po ç'solli të re shekulli XX? Çfarë është njeriu i sotëm?

»Sipas mendimit të Fromit njeriu bashkëkohor është bërë sundues i natyrës, por edhe rob i makinave të cilat i ndërtoi me duar të veta«. ² »Njeriu bëhet një dhëmb në rrotën e makinës së madhe ekonomike-i rëndësishëm nëse ka pasur shumë kapital, i parëndësishëm, nëse nuk ka pasur-por gjithnjë dhëmb që duhet t'i shërbejë diçkafes jashtë tij«. (faqe 104).

HOMO FABERI bëhet HOMO CONSUMENS, e ky është »njeriu, qëllimi kryesor i të cilit nuk është që në mënyrë primare t'i posedojë gjërat, por që sa më tepër të konsumojë, në mënyrë që të kompensojë zbrastësinë e vet të brendshme, pasivitetin, vetminë dhe mërzinë«. ³ Në një situatë të tillë hapërojnë mekanizmat e ikjes nga liria: Ato autoritare (sado-mazohiste), destruktive dhe konformiste që rezultojnë me humbjen e *unit personal*.

Humbja e *unit personal* ka të bëjë me të *liruarit*

² Gajo Petroviq »Suvremena filozofija«, »Školska knjiga«, Zagreb, 1979, faqe 348.

³ Socialist humanism, edited by E. Fromm, New York, 1965, page 214. sipas Gajo Petroviqit »Suvremena filozofija«, »Školska knjiga«, Zagreb, 1979, faqe 357.

nga liria-pavarësia për t'u bërë i varur nga autoriteti, për të qenë automat në manufakturën humanoide, pjesëtar i »njerëzimit kibernetik«.

Nëse hiria si fenomen bashkëlind me ekzistencën njerëzore si të tillë, atëherë në situatën e *ikjes nga liria* në të vërtetë kemi të bëjmë me *ikjen e njeriut nga vetëvetja, me vetë-mohimin dhe vetë-shkatërrimin emocional, racional dhe volitiv*. Ikja krijon iluzionim e qetësi, të sigurisë, të besimit se çdo gjë është në rregull. Për këtë njeri liria është barrë, ndërsa varësia »tokë e premtuar« e sigurisë. »Personaliteti« i tillë vëren se *uni personal* është *Mefisto* i jetës së tij, prandaj në stilin *Fausti* i dorëzohet *makinës, përditshmërisë, autoritetit*, bëhet vetëm »një nga ata« duke humbur ekzistencën e njëmendtë. Në qoftë se e tërë tradita e Renesancës së filozofisë evropiane nisej nga të definuarit e njeriut si qenie racionale (*»COGITO ERGO SUM«* i Dekartit), atëherë në mungesën e një aftësie të tillë, mungon edhe dyshimi karteziian, mungon edhe vetë njeriu. Tthjesht: »Unë nuk mendoj, pra nuk jam«.

Fromi vë në dukje edhe fenomenet e *parullomanisë* dhe të *formalizmit verbal*, që shërbejnë për t'i mjegulluar gjërat të cilat në gjendje reale janë të qarta, fenomene këto të cilat, sado që ndryshojnë

në formë, janë të përbashkëta për të dy sistemet shoqërore bashkëkohore. Të komplikuarit dhe të simplifikuarit e fenomeneve, gjegjësisht, shpjegimi i tyre, ndihmon manipulimin me individ. Ky kështu ose nuk kupton gjë nga ajo që thonë »Ata« (A të cilët reprezentojnë Autoritetin), prandaj ndihet i dobët, i nënshtruar, i vogël në këtë bashkësi, komb, shtet, bllok të »madh«, ose është i detyruar të »zgjedhë« nga dy mundësitë e »vetme«, ku njëra është gjithmonë e gabuar, ndërsa tjetra përherë e drejtë dhe e mirë, sepse dihet »ne jemi të tillë« ndërsa »ata janë...«.

»Terrorizmi verbal« në trajtë të propagandës ekonomiko-politiko-kulturore gllabëron çdo lëvizje të padëshirueshme të individit, ndërsa këtij i mbetet ta njohë *Letargjinë* dhe ta përsërisë pa ja ndarë *liturgjinë*: »Bukën, lojën, ëndrrat dhe iluzionet tona të përditshme na jep o zot, e shtet, o Leviatan, o absolut dhe mos u hidhëro në mëkatet tona të vockla«.

»Ithtari« i mekanizmit »kameleon« (atij konformist), i ka kështu të gjitha gjërat të qarta. Ai ndihet fatlum, sepse nuk ka nevojë të mendojë, të ndiejë apo të dëshirojë. Çka i duhet një aktivitet i »rëndë« intelektual-emocionalo-volitiv pranë institucioneve të besimit religjioz, shtypit, RTV,

organizatave politike, reklamës. Ai duhet vetëm ta luajë me zell rolin e vet jetësor, të dëgjoj me vëmendje »regjisorët«, të qeshë dhe të qaj kur »duhet«, të flasë dhe të heshtë kur »duhet«, madje edhe të vdesë në »stil të lartë« kur »duhet«.

Në këtë mënyrë invalidët intelektualë të pashërueshëm i gëzohen jetës, kështu shterret çdo iniciativë e njëmendtë individuale dhe individi *tretet në masën e përhime*.

Realizimi, fitimi i *mundshëm* i lirisë, qëndron në veprimtarinë spontane në trajtë të dashurisë dhe të punës prodhuese op EUP-RAXISË (praksës së mirë). »Me fjalë të tjera, *liria pozitive përbëhet nga aktiviteti spontan i tërë personalitetit të integruar*«, (fq. 229) personalitet që realizonë »veprimtarinë e lirë, universale, krijuese dhe vetëkrijuese me të cilën njeriu krijon (bën, prodhon) dhe ndryshon (formëson), botën e vet historike dhe vetveten«.⁴

Në »Shoqërinë e shëndoshë«, Fromi paraqet tri alternativat e mundshme të qeniesimit njerëzor: *Totalitarizimin, Superkapitalizmin dhe Socializmin*. Ky i pari, i shfaqur në dy variantat si *Nazi-fashizëm* dhe *stalinizëm*, shkatërron çdo mundësi eventuale për vetërealizim

njerëzor dhe glorifikon mekanizmin e sado-mazohizmit. Kështu nacional-socialisti Gebels shkruan: »To jesh socialist, do të thotë konceptin Unë t'ia nënshtrosh konceptit Ti; Socializmi është flijimi i individëve për tërësinë«. (faqe 202).

Superkapitalizmi super-realizon tjetërsimin global dhe krijon një shoqëri të konsumit të arsyes së dirigjuar, të *imbecilë-kulturës*, hyjnizon *infantilizmin intelektual*.

Po Socializmi? »*Socializmi humanist*« është shoqëri e *mundshme*, ai është *perspektivë*. Ideali i Fromit përkon me idealin e Marksit. *Socializmi* është për që të dytë »një bashkësi në të cilën zhvillimi i lirë i secilit është kusht për zhvillimin e lirë të të gjithëve«. Sipas Fromit »minipulimin me njerëz duhet ta zëvendësojmë me bashkëpunim aktiv dhe inteligjent, ndërsa parimin e udhëheqjes së popullit dhe për popull, ta zgjerojmë nga sfera formale politike në sferën ekonomike«. (faqe 235).

Po si të arrihet deri te ky ideal? Si të realizohet ky dhe të bëhet njëmendësi e përditshme apo përsitshmëri e njëmendtë. Fromi nuk e tregon këtë. Ndoshta për arsye se ishte i bindur thellë se koha e »formulave« alkimike

⁴ »Theoria« — Časopis Filozofskog Društva Srbije, 1—2, Beograd, 1985 Nga pjesa: Filozofski rečnik, Gajo Petrović — »PRAKSA«, faqe 175.

universale e të gjithëvlefshme të paraqitura në përkun e urdhëresave-doktrinave religjiozo-moralopolitike, e të cilat premtinin »parajsë« tokësore a qiellore, ka përënduar. Ndoshta, pse mendonte që zgjedhja eventuale duhet të vetë-gjendet nga çdo njeri veç e veç. Pohimin tonë të fundit e verifikon ky fragment i shkëputur nga vepra e Fromit »Njeriu për vete«: »Vendimi varet nga njeriu. Ai varet nga aftësia e tij që ta kuptojë veten, jetën e tij dhe fatin seriozisht; nga gatishmëria e tij që të ballafaqohet me problemin e vet moral dhe të shoqërisë. Ai varet nga guximi i tij që të jetë ai vetë dhe të jetë për vetë«. ⁵

Fromi nuk është pesimist edhe pse shkruan:

Në shekullin XIX ishte problem se zoti kishte vdekur; në shekullin XX problemi është se njeriu ka vdekur«. ⁶ Ky vëren qartë dy rreziqet më të mëdha të cilat i kanosen qeniesimit bashkëkohor. Atë të holokuastit nuklear dhe atë të robotizimit të »njerrëzimit kibernetik«. Fromi proklamon edhe alternativën e vetme: Socializmin humanist, gjegjësisht, »humanizmin e aplikuar në shoqërinë industriale«, i cili do ta mundësojë RILINDJEN E NJERRIUT.

Erih Fromi shpresoi se ai që e lexon »Ikjen nga liria« apo »Shoqërinë e shëndoshë«, së paku do të dyshojë dhe do të përpiqet të shpresojë, sepse: *Jeton vetëm ai, i cili, duke jetuar, përpiqet ta ndryshojë jetën.* ⁷

Blerim Shala

⁵ Sipas Gajo Petroviqit »Suvremena filozofija«, »Školska knjiga«, Zagreb, 1979, faqe 357. Nga Erih From »Čovjek za sebe«, »Naprijed«, Zagreb, 1977, faqe 178.

⁶ Erih From »Zdravo društvo«, IRO »RAD«, Beograd, 1983, faqe 339.

⁷ Parafrazim i thënies së njohur të shkrimtarit antik Menandrit: »Jeton vetëm ai, i cili, duke jetuar, i gëzohet jetës«.

NDREQJE GABIMESH

Në eseun e Gjergj Llucaçit »Metafizika e tragjedisë«, të botuar në »Thema« (nr. 1—2/85) kanë shpëtuar edhe këto gabime:

1) në faqen 132, rreshti i 19-të nga lart (NL) në vend të »e njehta udhëhiqet« duhet të jetë »e njehta drejtojnë«, 2) në fq. 138, rreshti i 22-të (NL) në vend të »fjala e plotë« duhet të jetë »falja e plotë«, 3) në f. 143, rreshti i 36 (NL) në vend të »mbarin« duhet të jetë »fund« dhe 4) në f. 148, rreshti i 11-të (NL) në vend të »vdekurit kumbojnë« duhet të jetë »vdektarit kumbojnë«.

Përkthyesi

ISPRAVAK

U br. 3/1985 tehničkom greškom ispalo je ime prevodioca stihova Lazgusha Poradecija. Izvinjavamo se prevodiocu — Mensuru Raifiju i čitaocima.

Redakcija



THEMA

*Revistë e Shoqatës së Filozofëve dhe Sociologëve të KSA Kosovës
Çasopis Društva Filozofa i Sociologa SAP Kosova*

Numër 5—6 1986
Broj

Redaksia — Redakcija

Fehmi Agani
Murteza Luzha
Milenko Karan
Gani Bobi
Ramush Mavriqi
Dragoljub Zivković, zëvendës kryeredaktori — zamenik glavnog urednika
Muhamedin Kullashi, kryeredaktor — glavni urednik
Isuf Berisha, sekretar

Këshilli botues — Izdavački Savet

Rexhai Surroi
Milan Šešlia
Hajredin Hoxha
Nehar Shishko
Milovan Marković
Muslim Mulliqi
Muhamedin Kullashi
Nait Vranezi, zëvendës i kryetarit — zamenik predsednika
Ali Dida, kryetar — predsednik

Adresa e redaksisë — Adresa redakcije

Fakulteti Filozofik, Instituti për filozofi e sociologji, 38000
Prishtinë (për revistën »Thema«)

Filozofski Fakultet, Institut za filozofiju i sociologiju, 38000
Pristina (za časopis »Thema«)

Llogaria rrjedhëse 68400-678-4062 Shoqata e Filozofëve dhe So-
Ziro račun cilogëve të Kosovës (për revistën »Thema«).
Društvo Filozofa i Sociologa SAP Kosova
(Za časopis »Thema«)

Çmimi për një numër 150 din.

Cena pojednog broja

Parapagimi për një vit

Godišnja pretplata 500 din.

Për botën e jashtme: dyfish

Za inostranstvo: dvostruko

Dorëshkrimet nuk kthehen

Rukopisi se ne vraćaju

Redaksia pranon të mërkureve 10—12

Redakcija prima sredom

Dizajni Nexhat Krasniqi Nekra
Dizajn

Lektor: Sylë Osmanaj

Korrektor Beqir Sadiku

Korektor

Redaktor teknik Jusuf Jusufi

Tehnički urednik

Shtyp: OP për veprimtari grafike »Progres — S. Gjorgjeviq«
Mitrović e Titos

Stampa: RO za grafičku delatnost »Progres — S. Đorđević«
Titova Mitrovica

